



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

RAPORT VJETOR I PUNËS

Janar—Dhjetor 2017

Gjilan

05 Janar 2018

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive

Fjala Hyrëse e Kryetarit të Komunës, z. Lutfi Haziri

I. AKTIVITETET E DREJTORIVE

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
5. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
6. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim
7. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
8. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
10. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

II. AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE

1. Njësia e Kuvendit
2. Njësia për Personel
3. Njësia për të Drejtat e Njeriut
4. Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm
6. Zyra Ligjore
7. Zyra për Informim

8. Zyra për Integrime Evropiane
9. Departamenti i Prokurimit
10. Zyra për Komunitete dhe Kthim
11. Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

Fjala Hyrëse e Kryetarit të Komunës, z. Lutfi Haziri
5 Janar 2018

E nderuar znj. Kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Të nderuar drejtorë dhe përfaqësues së Institucioneve të Komunës, shoqërisë civile dhe mediave

Kam nderin që sot të paraqes para juve Raportin vjetor të Punës për periudhën Janar-dhjetor 2017. Fjalën time hyrëse e bazoj në Përmbledhjen Ekzekutive të Raportit, kurse për detajet dhe punët specifike sipas drejtorive, Njësive dhe zyreve, ju lus t'i referoheni raportit të plotë.

Viti 2017, ka qene viti i fundit i mandatit katër vjeçar. Gjithashtu vit zgjedhor që krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të Gjilanit, të gjithë bashkërisht kemi qenë edhe pjesë e zgjedhjeve nacionale dhe lokale. Mirëpo, sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera. Besoj se suktesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i sfidave e barrierave në favor të qytetarit Gjilanas.

Me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arritë që në këtë vitit që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Gjilanit.

Raporti që po e prezantojmë sot përfshinë detaje nga këto të arritura dhe sukseste të qeverisjes sonë. Prandaj, në vijim do të përmendi vetëm disa nga pikat kyçe të punës sonë në vitin 2017.

Administratë - Në aspektin e ofrimit të shërbimeve administrative për qytetarët, Komuna e Gjilanit është bërë kampion i efikasitetit në Kosovë dhe shembull në rajon përmes funksionalizimit dhe përdorimit të një sërë programesh dhe shërbimeve që Gjilani e bëjnë Komunë model në nivel vendi dhe rajoni. Në linjë me qëllimet dhe premtimet tona, ne kemi ulur ne vazhdimësi shpenzimet komunale – p.sh. shpenzimet për derivate janë ulur në krahasim me vitin paraprak, kurse të hyrat nga administrata e përgjithshme janë rritur vazhdimisht në krahasim me vitin paraprak. Në këtë vit është përmbyllur edhe projekti i hapësirës së re Arshivës Komunale.

Shëndetësi - Në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi vazhduar me investime kapitale. Edhe në aspektin humanitar, Gjilani vazhdon të jetë shembull i bamirësisë. Kemi përfunduar mbi 50 shtëpi për familjet nevojtare, janë rinovuar një numër i konsiderueshëm dhe po paguhen qira mujore për dhjetëra familje të tjera pa kulm mbi kokë. Gjithashtu kemi subvencionuar në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të nevojtarëve për barëra e përkujdesje mjekësore (rreth një mijë familje), si dhe kemi vazhduar me përkrahje të pa rezervë, por brenda mundësive tona, për shoqatat e ndryshme humanitare që ofrojnë përkujdesje për qytetarët tanë me nevoja të veçanta (të paktën tetë shoqata të tilla). Gjithashtu në fund të vitit që kemi lënë pas është organizuar Gala mbrëmja humanitare “Pak nga Ne, Shumë për Ata!”, që është në format tjetër nga mbrëmja e parë e organizuar. Kjo ka synim mbështetjen e kategorive me nevoja të veçanta, konkretisht mbështetjen për HANDIKOS, LIRIA DHE PEMA. Në shëndetësinë primare janë

dhënë shërbime të shumta shëndetësore në QKMF dhe në QMF për një numër jashtëzakonisht të madh të pacientëve. Me kohë është dhënë edhe vaksina kundër gripit mbi 6000 vaksina për të rritur dhe 50 për fëmijë. Është duke u punuar edhe në sistemin elektronik E-Shëndeti.com për të krijuar data bazën elektronike. Gjithashtu sa i përket ujit të pijes dhe inspektimeve sanitare, del se Komuna e Gjilanit ka kushte të mira nga monitorimi dhe analizat e vazhdueshme që bëhen. Nuk ka rrezik nga ndotja apo ndonjë element negativ që do të ishte shqetësues për qytetarët.

Arsimi – Në fushën e arsimit në përgjithësi ka ngritje të cilësisë dhe kushteve më të mira për nxënës dhe personel. Gjilani tashmë prej kohësh është nga Komunitat e vetme në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore. Garat komunale dhe ato mbarëkombëtare por edhe angazhime dhe matje të tjera të dijes, na japin rezultate pozitive. Në investimet kapitale në arsim jemi gjithashtu duke punuar me dinamikë të lartë në krijim të hapësirave adekuate dhe profesionale si për mësim, po ashtu edhe për punën praktike dhe për dhe konkretizimin e njohurive të marra në teori. Komuna e Gjilanit tashmë ka të krijuar Fondin e Ekselencës, për mbështetje të nxënësve dhe studentëve që kanë të arritura kulminante në fusha të caktuara shkollore dhe akademike. Bashkëpunimi me organizatat e ndryshme ndërkombëtare është i vazhdueshëm dhe falë donatorëve dhe përkushtimit të institucioneve lokale në gjatë vitit që lamë pas kemi bërë përrurimin e Institucionit Parashkollor në lagjen “Dardania”, pastaj hapësira moderne për kulturën fizike nëpër disa shkolla dhe jemi të përkushtuar të vazhdojmë tutje me punë për kushte më të mira dhe suksese gjithashtu.

Kadastër, Gjeodezi, Pronë – Kjo drejtori ka pranuar 6547 lëndë - kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, hipoteka, masa të përkohshme, barra tatimore, oferta, vlerësime, kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat dhe ka bërë caktimin e pikave për projekte të ndryshme me interes të përgjithshëm të Komunitat së Gjilanit dhe qytetarëve të saj. Efikasiteti në këtë drejtori është gjithnjë në parametra pozitiv kur bëhen krahasimet me vitin paraprak ose vitet tjera. Ka rritje të të hyrave dhe gjithashtu ulje të shpenzimeve. Janë lëshuar 14056 Certifikata të pronësisë, 2104 Certifikata të gjendjes ekonomike, 2131 kopje të planit. Si drejtori kanë bërë përgatitjen e vendimeve dhe listës së shpronësimeve sipas prioriteteve dhe nevojave me interes të përgjithshëm.

Mbrojtje dhe Shpëtim - janë realizuar aktivitete konform planit dhe kushteve atmosferike apo nevojave emergjente për intervenim në bashkëpunim edhe me institucionet e emergjencës në Komunitat e Gjilanit duke përfshirë koordinimin e plotë me policinë, shëndetësinë, FSK-në, zjarrfikësit dhe institucione të tjerë të reagimit emergjent. Gjithashtu ne si drejtori, në vazhdimësi vlerësojmë mundësit e rreziqeve nga faktorët e tjerë, nga ku popullata e komunitat tonë dhe prona mund të rrezikohen në mënyrë masive, është bërë vlerësimin për gjendjen e sigurisë fizike të objekteve të komunitat dhe propozimin për kapacitetet e nevojshme të ruajtjes, Nga buxheti i komunitat, njësia zjarrfikësit janë pajisur me mjete për intervenim në aksidente të komunikacionit. Janë identifikuar objektet e braktitura nëpër lagjet e qytetit që paraqesin rrezik për qytetarët dhe pronën e tyre. Nga inspektorët janë bërë të gjitha inspektimet për shkollat dhe objektet publike, Në preventivën kundër përhapjes së zjarreve fushore dhe malore, janë shpërndarë pastër dhe është bërë fushatë mediatike, Në kuadër të bashkëpunimit me Asgjësinë e Pyjeve dhe Drejtorinë për Bujqësi, është koordinuar aktiviteti i integritetit të punëtoreve sezonal. Gjatë reshjeve të muajit dhjetorë që përfshinë pjesën më të madhe të vendeve të Gadishullit Ballkanik, e të cilat shkaktuan vërshime masive, në komunitat tonë kjo dukuri kaloi pa shkaktuar dalje të lumenjve dhe përrrenjve

nga shtrati. Gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur kjo dukuri, DMSH ka qenë e mobilizuar për të përballuar dhe menaxhuar çdo fatkeqësi eventuale.

Urbanizmi – Kjo drejtori ka realizuar detyrat e saj sipas ligjit dhe njëkohësisht ka ndërmarr edhe aktivitete të tjera si: Përpilimi i detyrave projektuese për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme në zonën urbane si dhe procedimi i tyre për nxjerrjen e vendimeve nga K.K. Gjilan për fillim të procesit për hartim,

-Përpilimi i detyrës projektuese,

- hartimin e PZHK-së për territorin e Komunës si dhe procedimi i tij për nxjerrjen e vendimeve nga K.K. Gjilan për fillim të procesit për hartim

-Hartimi i hartës zonale

-Parku te Baja

-Parku i Pages

-Hartimi i projekteve kryesore për vendosjen e shtatores së Idriz Seferit dhe busteve

-Fillimi i procesit të planifikimit të PZHK-se

-Incizimi i objekteve për nevoja të kërkesave në drejtori

-Vazhdimi i procesit për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme Qendra 2, Qendra 3 si dhe lagjja e spitalit ku është përfunduar shqyrtimi publik.

-Mbajtja e disa dëgjimeve publike sa i përket këtyre zonave

-Përgatitja e planit të veprimit për Hartën zonale të Komunës

-Sistemimi i planeve rregulluese të miratuara në sistemin GIS

-Digjitalizimi dhe krijimi i data bazës për objektet e pajisura me leje ndërtimore në GIS për vitet 2011, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe publikimi i tyre në Web Gis,

- Mbikëqyrja e punëve të projekteve kapitale në kuadër të Komunës etj.

-Gjithashtu edhe te zona Zabeli 1 është përfunduar profile dhe analiza e gjendjes dhe po vazhdohet me tutje me procesin

-Kemi mbajtur disa dëgjime publike lidhur me hapjen e trasesë së rrugëve në zonat Fidanishte 1 Kampi Monteith si dhe Livadhet e Arapit.

-Përgatitja dhe përmbyllja e fazës së parë në projektin ARIS-sistemi i adresave

-Janë kryer, inspektime nga ana e zyrtares së ambientit për lejet mjedisore

-Janë mbajtur ligjërata me temën “Mjedisi dhe rëndësia e mbrojtjes së tij ” në 8 shkolla fillore të Komunës së Gjilanit.

Gjithashtu sipas statistikave në drejtorinë e Urbanizmit kemi:

- Parcelime të truallit 403,

- Kushte tëndërtimit112,

- Leje tëndërtimit153,

- Leje përdorimi 08,

- Lajmërimi18,

- Informata 35,

- Leje rrënimi22 ,

- Njoftime 11,

- Leje mjedisore 24,

dhe refuzim të kërkesave 21.

Të hyrat nga lejet e ndërtimit 1 050 195.70 € apo 287229.0 m2, Nga legalizimi i objekteve pa leje 5668.60 €, Nga lejet mjedisore 91165.00 €, Taksat nga kërkesat 5533.00 €, Nga gjrobat e

inspeksionit 5400.00 €, që në total të kësaj që u tha del një vlerë prej afro 1 milion e 160 mijë euro.

Infrastrukturë dhe shërbime publike - Gjilani tashmë është shndërruar në një qendër të investimeve të mëdha në infrastrukturë publike në përgjithësi. Pas hyrje-daljes në drejtim të Bujanocit, gjatë vitit 2017 është punuar në investimin e hyrje-daljes në drejtim të Ferizajt dhe më pas edhe në drejtim të Prishtinës, që aktualisht është duke u punuar në trajtimin e kërkesave të qytetarëve lidhur me detajet teknike të rrugës. Po ashtu është Autostrada që pothuajse është në fillim të ndërtimit dhe gjithnjë në koordinim edhe me komunat tjera, kemi tejkaluar të gjitha barrierat dhe presim që në afatin optimal. Problemet sa i përket mungesës së infrastrukturës kemi vazhdimisht dhe ato do të ketë gjithmonë, sepse Gjilani për zgjerohet përditë e më shumë dhe karshi planifikimit në po bëjmë edhe zgjerimin e infrastrukturës për një jetë më të lehtë kudo që jetojnë qytetarët në hapësirën e Komunës. Ndriçimi Publik, shenjëzimi, mirëmbajtja e qytetit, parqeve dhe fshatrave është proces që vazhdon çdo ditë.

Bujqësia – Në sektorin e bujqësisë Gjilani ka dhënë maksimumin e përkrahjes – qoftë përmes subvencioneve vetanake nga buxheti komunal, qoftë përmes bashkëpunimeve të shumta me organizata ndërkombëtare dhe me organet tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës – duke shpërndarë pajisje e makineri bujqësore. Projekti i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore i mbështetur nga Komuna e Gjilanit ku kanë përfituar afro 1200 fermer, projekti për mbjelljen e 50 hektarëve me vishnje në bashkëpunim me USAID, projekti i mekanizimit bujqësor, përgatitja dhe mbështetja e fermerëve për aplikim për grante dhe subvencione në MBPZHR, projekti i serrave, organizimi i panairit të prodhimeve bujqësore. Krahas kësaj kemi edhe dëme nga reshjet e shiut dhe të breshëritë që janë bërë të gjitha vlerësimet nga komisioni profesional. Gjithashtu për këtë vit planifikohet rritja e përkrahjes nga Komuna e Gjilanit që tashmë edhe është e hapur afati për aplikim në disa fusha në sektorin e bujqësisë.

Zhvillimi Ekonomik – Gjatë vitit 2017 kjo drejtori ka Hartuar Strategjinë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal 2017-2021 dhe Strategjinë për Gratë Ndërmarrëse 2017-2021. Gjithashtu kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, duke përkrahur biznese të vogla e të mesme për mundësitë e aplikimit për grante në qeveri. Është punuar për themelimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes publike “Tregu”. Pastaj përmes Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V, projekti që është financuar nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, Komuna e Gjilanit. Projekti ofron "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë". Në projektet madhore jemi duke punuar përmes programit Soft Loan. Në vitin 2017 janë organizuar edhe shumë panaiere që nga prodhimet vendore, panairi për muajin e diasporës, Auto Show etj. Në regjistrimin e bizneseve kemi rreth 500 biznese të reja me afro 1000 të punësuar.

Buxhet dhe Financa – Kjo drejtori ka përgatitur me kohë Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe Buxhetin për vitin e ardhshëm kalendarik, i cili është votuar në Kuvendin e Komunës dhe i njëjti është dorëzuar në afatin ligjor edhe në Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës. Planifikimi buxhetor është përcjellur edhe me dëgjime buxhetore në lokalitetet më të mëdha të Komunës së Gjilanit dhe kërkesat e qytetarëve janë inkorporuar në planifikimin vjetor për investime kapitale. Gjatë këtij viti është arritur rritje e inkasimit të tatimit në prone, që sipas raportit të Drejtorisë për Buxhet e Financa, ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak. Edhe

në sektorin e lejeve të ndërtimit, ka rritje në të hyra. Kjo rritje e efikasitet të punës në këto dikastere, është përcjellë edhe me faljen e borxheve sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike.

Prokurimi Publik - Në aspektin e prokurimit publik, në periudhën janar-dhjetor 2017 janë udhëhequr 77 aktivitete të prokurimit, të cilat edhe janë publikuar në web faqe e – prokurimit si dhe të KRPP: prej tyre Procedurë e hapur 46, Konkurs projektimi 4, Ftesa për kuotim 10, Vlera minimale 13, Ankande publike 3. Për herë të parë këtë vit në Komunën e Gjilanit Investimet kapitale tejkalojnë vlerat e buxhetit të përgjithshëm dhe lirisht mund të thuhet se ky është viti i investimeve më të mëdha për Gjilanin. Gjatë kësaj janë kryer aktivitetet e prokurimit dhe janë duke u investuar në qytet dhe gati të gjitha fshatrat e Komunës së Gjilanit në infrastrukturën rrugore ujësjellës, kanalizim si në Bresalc, Cërnicë, Dobërzan, Muhaxhirët e Dobërzanit, Përlepnicë, Shillovë, Trotuari Arbëri –Velekinçë, Capar, Malishevë e Epërme, Malisheva e Ulët, Pogradjë, Lagja Arbëri, Lagja e Vishnjeve, Përlepnicë, Velekinçë, Llashticë, Livoqi Ulët, Kmetocë, Lladovë, Zhegër, Pidiç, Selishtë, Çelik dhe disa rrugë të qytetit. Vlen të ceket projekti me PPP Kampusi i shkollave të mesme një projekt kapital ku është kryer faza e parë e investimeve priten të realizohen edhe dy fazat tjera, po ashtu Projekti QKMF vlera e projektit 1.195438.67€. Ndërtimi i Palestrës sportive po ashtu edhe ky projekt kap vlerën mbi 1.108.857,74 € Si dhe ndërtimi i stadiumit të qytetit 3.121.346.07.

Gjilani ka shënuar suksese edhe në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit në vitin 2017. Kishim vitin e Idriz Seferit në vitin që lamë pas duke e bërë Gjilanin qendër të tubimit të madh të gjithë krerëve shqiptarë në nderim dhe respekt të festës së Flamurit Kombëtar. Ne kemi qenë nikoqir të Panairit të Sportit në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe kemi vazhduar me subvencionim të klubeve dhe aktiviteteve sportive në Komunë si dhe kemi realizuar me sukses edhe manifestimin tradicional, të Flakës së Janarit, duke e kthyer Gjilanin në një kryeqendër të kulturës e artit tone kombëtar. Po ashtu, në linjë me këto aktivitete dhe për të rritur mundësinë e organizimit dhe veprimtarisë për rininë, ne kemi promovuar edhe objektin e ri të Qendrës Rinore të Gjilanit dhe gjithashtu edhe funksionalizimin e Bibliotekës moderne që u jepet hapësirë e mjaftueshme të rinjve për të marrë dije.

Për shkak të pozitës gjeografike dhe lidhjeve natyrore e familjare me shqiptarët në Luginën e Preshevës, ne jemi të lumtur edhe me punën dhe angazhimin e Zyrës për Preshevë, Bujanoc Medvegjë pranë Komunës sonë. Kjo zyrë po vazhdon të kryej misionin e vet dhe të ofrojë shërbimet e veta për qytetarët e Luginës që jetojnë në Komunën tone, duke ju ndihmuar edhe në pajisjen me dokumente personale.

Ne vazhdojmë të jemi lider në aspektin e bashkëpunimit komunal me organizata dhe investitorë të huaj – duke qenë partner dhe nikoqir i shumë projekteve investuese dhe granteve përkrahëse nga USAID, BE, KfW, UNDP, si dhe Ambasadat e Qeveritë e vendeve mike si Austria, SHBA, Gjermania, Turqia, Zvicra, etj. Falë solidaritetit dhe përkrahjes edhe të mërgimtarëve tanë, Gjilani po vazhdon të jetë atraktiv edhe për investitorë potencialë private që po vijnë për të shikuar mundësitë e investimeve dhe kushtet e të bërit biznes në komunën tonë.

Përveç këtyre që u thane më lartë, ky Raport përfshinë edhe aktivitetet kyçe të zyrave dhe njësive tjera pranë Zyrës së Kryetarit, si dhe elaborim më të detajuar të punëve të secilës drejtori. Për të

mos ju lodhur më shumë, unë ndava me ju vetëm disa nga pikat kyçe të punës së përbashkët, duke ju lënë mundësinë që Raportin në fjalë ta lexoni e ta shqyrtoni sipas nevojave tuaja.

Si gjithëherë, ju falënderoj të gjithëve për punën, angazhimin dhe kontributin tuaj në të mirë të Komunës sonë dhe qytetarëve tanë. Për çfarëdo pyetje shtesë që mund të keni, ju lutem t'i adresoni ato tek ne dhe drejtoritë përkatëse për përgjigje ose shpjegime shtesë.

Ju faleminderit,

Lutfi Haziri
Kryetar i Komunës së Gjilanit

Raportet e Drejtorive

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raporti vjetor i Administratës paraqet arritjen e të gjitha objektivave të parapara me planin e veprimtimit për periudhën kohore janar-dhjetor 2017, duke përmbyllur të gjitha projektet e planifikuara për krijimin e një administrate moderne përmes platformave dhe avantazheve të teknologjisë informative të aplikuara në të gjithë sektorët e administratës, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe ofrimin e tyre në kohën e duhur, vendin e duhur dhe aty ku ka nevojë qytetari.

Vitin 2017 e përmbyllim me Implementimin e projektit për Arkiven dixhitale apo arkiven e Integruar të Administratës Komunale si projekti i vetëm në Republikën e Kosovës krahas shumë projekteve tjera të cilat kanë qenë model në nivel vendi por edhe rajon. Gjithashtu kemi arritur efikas shpenzimesh, sidomos në shfrytëzimin e veturave zyrtare.

Në vazhdim po paraqesim në formë tabelare shërbimet e ofruara sipas raportit të nxjerrë nga intraneti nëpër sektor të caktuar.

Qendra për Shërbimin me Qytetar

Shkurtesa	Përshkrimi	Pra nuar	Ne Proces	Miraturar	Ref uzu ar	Hed hur Posh të	Pez ullu ar	proc edu ar	An ulu ar	Për fun dua r	Totali
		0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	584	584	104,389	148	1	0	0	19	0	105,725
DA	Drejtoria për Arsim	87	1,290	948	0	0	0	0	0	0	2,325
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	229	349	5,860	51	1	0	0	32	0	6,522
DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave	10	46	109	24	0	0	0	1	0	190

DMSH	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	6	7	104	0	3	0	0	1	0	121
DUMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	33	393	899	3	4	0	0	1	0	1,333
DSHPIB	Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim	2	114	1,235	3	0	0	0	3	0	1,357
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	8	206	917	290	0	0	0	64	0	1,485
DBP	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	49	704	1,954	111	0	0	0	2	0	2,820
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	9	94	195	1	0	0	0	1	0	300
KK	Kuvendi i Komunës	13	652	141	0	0	0	0	1	0	807

Autoparku

Në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është Shërbimi i Autoparkut i cili kujdeset për automjetet zyrtare të komunës.

Pjesë e këtij shërbimi janë zyrtarët (voztësit), Fadil Kosumi (DAP), Qahil Halili (ZK), Milazim Hoxha (DUAMM), Nazif Bunjaku (DGJKP) dhe Ibrahim Berisha (ZK)

Gjithashtu kemi dy vozitës Selman Kqiku dhe Zoran Kovaqeviq (DKA) që bartin nxënësit, njëri në relacionin Cërrnicë-Partesh dhe Stanishor-Gjilan, ndërsa tjetri brenda qytetit dhe fshatrave (nxënësit me aftësi të kufizuara) në SHMU “Thimi Mitko”.

Janë edhe dy vozitës me kategori “D” të angazhuar me dy minibusë për ta ndihmuar sportin, pronë të komunës të cilët transportojnë klubet sportive.

Ky shërbim ka detyra dhe obligime permanente të cilat veç dihen, por edhe procedurat për shfrytëzimin e automjeteve të komunës janë te njohura.

- Të gjitha automjetet janë shfrytëzuar gjatë orarit të punës nga 08:00-16:00, ndërsa përjashtim nga kjo janë:
Kujdestaritë, komisionet e ndryshme, pamundësia e arritjes me kohë nëse zyrtari gjendet jashtë komunës, rastet emergjente, servisimet e automjeteve etj, por kjo bëhet vetëm pasi me parë njoftohet shërbimi.
- Kërkesat për shfrytëzim javor të automjeteve bëhen nga drejtoritë ku përfshihet transporti lokal dhe fshatrat e komunës, kjo kërkesë nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë apo i autorizuari i tij/saj, ndërsa kërkesat për shfrytëzim të automjeteve jashtë komunës , aprovohen nga kryetari i komunës.
- Tek të gjitha automjetet plotësohet urdhëresat e udhëtimit çdo herë kur automjetet shfrytëzohen, përjashtim nga kjo janë ato të zyrës së kryetarit, ku nuk mbajnë evidencë, kështu që unë marr kilometrat e kaluara çdo fund muaj dhe të njëjtat i paraqes në një urdhëresë, vetëm për të mbajtur evidencë mujore.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Bazuar në nevojat dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga ana e DSHMS, QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, respektivisht QPS-së si dhe partnerëve tanë siç janë OJQ-të të cilat veprojnë në komunën tonë, komuna jonë në vazhdimësi ka ofruar dhe subvencionuar një sërë shërbimesh sociale dhe shëndetësore.

Sa i përket banimit social, Drejtoria ka përgatitur ‘Planin Tre vjeçar të Banimit Social’ dhe njëjti ka kaluar në Kuvend dhe është dorëzuar në MAPL dhe MMPL për verifikim dhe aprovim.

Nga fondi humanitar ‘Pak nga Ne, shumë për Ata’ kemi arritur të ndërtojmë mbi 50 shtëpi dhe nga buxheti i subvencioneve kemi paguar 45 qira mujore për familje në nevojë, të përzgjedhura nga Komisioni ad-hoc dhe të rekomanduara nga ZMS.

Duke e parë nevojën për një bashkërendim më të mirë ndërinstitutional, ne si DSHMS kemi monitoruar në vazhdimësi lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara, buxhetimin dhe koston financiare në kornizat buxhetore si dhe monitorimin e këtyre shërbimeve.

Pra DSHMS përveç shërbimeve sociale të ofruara, një pjesë të shërbimeve i ka blerë nëpërmjet subvencionimit të OJQ-ve siç janë: HANDIKOS, SH.V, SHMM-Gjilan, PEMA, Strehimorja-‘LIRIA’ dhe shoqata të tjera.

Përderisa kërkesat dhe nevojat gjithnjë vijnë duke u rritur, kapaciteti buxhetor gjithmonë është i limituar dhe në të njëjtën kohë edhe është shtruar nevoja për një koordinim dhe mbikëqyrje më rigorozë lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara por edhe sfidat me të cilat përballen këto

kategori të shoqërisë sonë.

Në njërën anë shtrohet nevoja e një informate më të saktë lidhur me shërbimet e ofruara, në anën tjetër ne mëtojmë që t'i zgjerojmë kapacitetet dhe gamën e shërbimeve të kategorive të rrezikuara dhe personave me nevoja të veçanta.

Duke e ditur koston e lartë të shërbimeve, e sidomos atyre rezidenciale Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me komunat ka filluar të bëjë decentralizimin e disa shërbimeve.

Zyra Financiare dhe Mirëqenie Sociale në periudhën: **01.01- 20.12.2017** në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka punuar në zbutjen e gjendjes së rëndë sociale me të cilën po ballafaqohet pjesa më e madhe e popullatës si në Kosovë në përgjithësi dhe në komunën tonë në veçanti.

Ndihmat në sferën sociale

Pagesat për Familjet e Dëshmoreve dhe të Invalidëve të Luftës sipas Rregullores Komunale me numër 01-3378/09 datë:30.03.2009

Familjet	Periudhat	Shuma mujore	Gjithsej	Data
15	Dhjetor 2016	130€	1950 €	28.02.2017
15	Janar 2017	130€	1950 €	09.03.2017
15	Shkurt 2017	130€	1950 €	12.04.2017
15	Mars 2017	130€	1950 €	08.05.2017
15	Prill 2017	130€	1950 €	08.06.2017
15	Maj 2017	130€	1950 €	14.06.2017
15	Qershor 2017	130€	1950 €	14.06.2017
14	Korrik	130€	1820 €	11.08.2017
14	Gusht	130€	1820 €	14.09.2017

Gjatë kësaj

periudhe për Familjet e Dëshmorët dhe Invalidët Luftës pagesat janë kryer për muaj që kapin shumën prej 17.390 €

Pagesat e qirasë për familjet me gjendje të rëndë Sociale të rekomanduara nga Komisioni ad- hoc.

Familjet	Periudhat	Shuma mujore	Gjithsej	Data
44	Janar 2017	52 € -100 €	3567 €	
47	Shkurt 2017	52 € -100 €	3867 €	
47	Mars 2017	52 € -100 €	3867 €	
47	Prill 2017	52 € -100 €	3867 €	
44	Maj 2017	52 € -100 €	3467 €	
43	Qershor 2017	52 € -100 €	3387 €	
43	Korrik 2017	52 € -100 €	3387 €	

42	Gusht 2017	52 € -100 €	3287 €	
40	Shtator 2017	52 € -100 €	3097 €	
49	Tetor 2017	52 € -100 €	3037 €	
1	Nëntor 2017	52 € -100 €	100 €	

Gjithsej pagesa për qira për periudhën janar- nëntor 2017 31.893 €

EMRI I OJQ-së	Data e Vendimit	Shuma	Data e ekzekutimit
HANDIKOS	06.03.2017	2.745.76 €	06.03.2017
SHOQATA E TË BURGOSURVE P.	11.04.2017	2.000 €	11.04.2017
SHOQATA E INVALIDVE TË UÇK	11.04.2017	2.000 €	11.04.2017
HANDIKOS	10.05.2017	1.000 €	10.05.2017
HANDIKOS	10.05.2017	1.000 €	10.05.2017
SHOQATA E TË VERBËRVE	22.05.2017	800 €	22.05.2017
HANDIKOS	07.06.2017	1.600 €	08.06.2017
SHOQATA E FAM.DËSH. TË UÇK	07.08.2017	2.000 €	07.08.2017
HANDIKOS		1.400 €	11.08.2017
SHOQATA E TË VERBËRVE		700 €	08.06.2017
	GJITHSEJ	15.245.76 €	

GJITHSEJ MJETE TË SHPENZUAR PËR KATEGORITË E LARTCEKURA PËR VITIN 2017 JANË: 64.528.76 €

ZYRA PËR SHËRBIME SHËNDETËSORE

Me këtë raport do të përmendim disa nga punët dhe aktivitetet me të cilat është marrë ZSHSH-gjatë vitit 2017, sipas detyrës dhe obligimit zyrtar.

Edhe me këtë rast më duhet të theksoj se angazhimi kryesor si në kuptimin kohor ashtu edhe në pikëpamje të vëllimit të punës ishte në përgatitjen dhe udhëheqjen e pagesave për kërkesat e drejtuar nga palët ndaj DSHMS-fondit të subvencionimit në skemën „Ndihmë për barëra dhe trajtim shëndetësor”.

Këtë vit aprovimet–pagesat kanë filluar në muajin mars për shkak të vonesës gjatë alokimit të mjeteve në fondin për shfrytëzim. **Kjo ka ndikuar që 109 kërkesa të periudhës dhjetor 2016 - janar 2017 të refuzohen që të gjitha! Ndhmë në këtë kategori kërkesash nuk është arritur të sigurohet për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, rrjedhimisht ndihma janë akorduar vetëm gjatë tetë muajve brenda vitit kalendarik 2017.**

Gjatë marsit 2017 janë procesuar aprovimet e para për këtë vit dhe këto ishin kërkesat e arritura gjatë muajit paraprak (shkurt 2017).

Paraqitje periodike për pagesat e realizuara nga fondi i subvencionit gjatë vitit 2017.

Tab:1

	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
Aprovuar	65	66	37	34	21	14	32	46
Shpenzim	6576	6490	3180	3440	1910	1350	3480	3770

Nga fondi i subvencionit që është planifikuar për DSHMS-në për vitin 2017 (më duhet të theksojë se është i pamjaftueshëm në raport me nevojat reale të kategorive të cilave iu dedikohet), shfrytëzohen mjetet edhe për pagesa të subjekteve dhe kategorive tjera (për veç personave me sëmundje dhe me pozitë të rëndë ekonomike) kështu mundësitë për t’iu ndihmuar personave të sëmurë ishin të zvogëluara.

Paraqitja tabelare e numrit të kërkesave të rekomanduara dhe aprovuara për ndihmë nga **komisioni intern** dhe shpenzimi i bërë në emër të tyre(viti 2017)

Tab:2

Viti	Kërkesa të aprovuara	Shpenzimi në euro.
2017	309	26.496

Gjatë vitit 2017 ndihmë për mjekim, me vendim të **Zyrës së Kryetarit** është akorduar për gjashtë(6) raste në vlerë totale prej 3700€.(**paraqitja në Tab: Nr:3**)

Tab:3

Viti	Kërkesa të ap. për mjekim nga ZK.	Shpenzimi në euro.
2017	6	3700

Edhe këto vendime janë procesuar përmes DSHMS-së (ZSHSH) prandaj subvencionimi për mjekim si shumë e përmbledhur për vitin 2017 është 30.196€ dhe numri i kërkesave të aprovuara të kësaj natyre është 315.

Tabelë krahasuese mbi kërkesat e aprovuara dhe shpenzimin e bërë në emër të tyre për tre vitet e fundit krahasuar me vitin 2017.

Tab:4

Viti	Kërkesa të aprovuara	Shpenzimi në euro
2017	315	30.196

2016	497	51.910
2015	476	47.970
2014	427	50.838

1. Përgatitje e pagesave për **315** lëndë, përcjellja dhe evidentimi i tyre.
2. Kompletimi i dokumenteve dhe përgatitja e lëndëve për **ID-furnitorit në 77** raste..
3. Njoftim me shkrim për palët në **109** raste- për kërkesat e dhjetorit 2016 dhe Janarit 2017. (Refuzime për shkak të mungesës së mjeteve në fonde në këtë periudhë).
3. Gjatë janarit angazhim në çështje të inventarizimit në drejtori dhe komision komunal
4. Pjesëmarrje në seanca të komisionit komunal të ri integritetit në nëntë (9) takime komisionare.
5. Koordinimi dhe ndihma reciproke me kolegët-zyrtar të DSHMS-së për kryerjen e punëve dhe zëvendësimet reciproke gjatë pushimeve të ndërsjella.

Zyra për Shëndet Publik

Zyra e shëndetit publik që vepron në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale veprimtarinë e vet e kryen duke u bazuar në planin e punës, objektivi i së cilës është përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës, promovimi dhe edukimi shëndetësor, ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës, kontrolli dhe monitorimi i sëmundjeve ngjitëse, marrja e masave kundër epidemive si dhe parandalimit të sëmundjeve, çrregullimeve dhe të lëndimeve, duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat kompetente në të gjitha nivelet.

Aktivitetet të tilla në sferën e propagimit të shëndetësisë, monitorimit të sëmundjeve janë zhvilluar si në viset rurale po ashtu edhe në zonat urbane të komunës sonë.

Monitorimi i sëmundjeve ngjitëse është bërë të banorët e fshatrave Livoq i Poshtëm, Pogradë, Zhegër, Nasalë, Miresh, Shurdhan, ku po ashtu janë vizituar qendrat dhe punktet e mjekësisë familjare dhe janë bërë konsultimet me stafin mjekësor.

Për ditën botërore të ujit është vizituar penda Përlepnicsë ku për së afërmi jemi njoftuar lidhur me gjendjen e ujit të pijshëm si dhe analizat kimike-bakteriologjike. Po ashtu janë shpërndarë broshura nxënësve dhe popullatës që për temë ka pasur ruajtjen e ujit të pijshëm si resurs natyror.

Me organizatën joqeveritare të Komunës sonë Handikos janë mbajtur takime pune lidhur me mbrojtjen e shëndetit të personave me nevoja të veçanta si dhe te drejtat ligjore në fushën e shëndetësisë.

Në kuadër të punës është bërë vizita e ekipeve mjekësore të caktuara për kontrollë sistematike të nxënësve nëpër shkollat e Komunës sonë si dhe për të monitoruar mbarëvajtjen e punës.

Së bashku me komisionin e formuar nga kryetari i Komunës për raste emergjente është zhvilluar aktivitet tregues lidhur me hartimin e draft projektit për ofrimin e ndihmave në raste emergjente.

Po ashtu janë bërë vizita të shtëpitë për banim social për t'u parë kushtet e higjienës në këto ndërtesa që janë të banuara kryesisht me familje të varfra ekonomikisht.

Me Kryqin e Kuq të Gjilanit është mbajtur seminar lidhur me dukuritë negative dhe preventiva nga abuzimi me substance narkotike të rinjtë.

Gjatë muajve qershor, korrik, gusht është bërë dezinfektimi hapësinor i Komunës si masë mbrojtëse nga mushkonjat si vektor bartës të sëmundjeve ngjitëse e cila është zhvilluar në 4 etapa.

Gjithashtu gjatë muajit gusht dhe fillimi shtatorit është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës sonë.

Me organizatën Internacionale - Save the Children në kuadër të projektit ''Përmirësimi i Qasjes dhe Cilësisë në kujdesin dhe Zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë'' është mbajtur seminar pune, qëllimi i së cilës ishte shkëmbimi i përvojave dhe njoftimi nga afër me modelin e bazuar në komunitet.

Janë vizituar familje me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale dhe mundësia e ndihmës shëndetësore.

Janë shqyrtuar 560 kërkesa për barëra dhe mjete ndihmëse shëndetësore, të aprovuara 309, të refuzuara 242, të proceduara më tutje në Drejtoritë përkatëse dhe komisionin ad-hoc 9.

Në kuadër të zyrës për shëndet publik po ashtu janë udhëzuar për Ministrinë e Shëndetësisë në bazë të rekomandimit të mjekëve konziliarë të QKU-së 97 raste për trajtim jashtë vendit edhe atë me sa vijon:

Nr.	Lloji i sëmundjes	Numri i kërkesave	Të rekomanduara në Ministrinë e Shëndetësisë
1	Sëmundje kardiovaskulare	40	40
2	Sëmundje oftalmologjike	16	16
3	Sëmundje onkologjike	13	13
4	Sëmundje ortopedike	14	14
5	Sëmundje neurologjike	6	6
6	Sëmundje hematologjike	5	5
7	Sëmundje të Veshkave	1	1
8	Sëmundje të ORL-së	2	
	Gjithsejtë	97	97

Inspeksioni Sanitar

Gjatë këtij viti janë Inspektuar :

- Subjektet tregtare ushqimore
- Subjektet hoteliere
- institucionet private shëndetësore dhe barnatoret

Institucionet private shëndetësore janë Inspektuar në bazë të kërkesave të palëve për lëshimin e Aktvendimit për pëlqim sanitar, si parakusht për licencimin e ordinancave dhe barnatoreve nga Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë këtij viti janë ndërmarrë seri e aksioneve në asistencë të P.K (Policisë së Kosovës në bashkëveprim të Inspektorëve Sanitar të Agjencisë së Ushqimit, në zbatim të Ligjit për kontrollin e duhanit.

-Aksione të përbashkëta me Inspektorët e Tregtisë, Inspektorëve të ATK-së, Inspektorëve të Punës dhe Policisë së Kosovës për Inspektimin e lokaleve të natës për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Monitorimi i procesit të dezinfektimit hapësinor të qytetit të Gjilanit i cili është kryer në katër faza. Si dhe angazhime të tjera në interes të Institucioneve Komunale.

Në vazhdim po i japim në formë tabelare Inspektimet tona:

Natyrë e punës	Numri	Vërejtje
Kontrollime-Inspekte	120	
Procesverbale	65	
Pëlqime Sanitare	38	
Asistencë –pjesëmarrje me insp e AUV-it dhe asistime tjera për zbatim të Ligjit të duhanit	25	

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
“Dr Nagip Rexhepi

Tabela nr.1. Shërbimet shëndetësore

Nr	Shërbimet	Totali	Referimet
1	Vizita në mjekësinë familjare	168249	24591/ 14.61%
2	Vizitat në Emergjencë	37098	4802 12.94%
3	Vizitat shtëpiake shërbimi Urgjent	2821	
4	Vizita Stomatologjike	23740	
5	Shërbime laboratorike	25774	
6	Kujdesi Paliativ	1739	
7	Qendra e diabetit	3857	81 2.10%
8	Participimi i përgjithshëm	45701	19.11%
9	Vizita Psikologjike	1535	
10	Evidentimi i fletëzave kompjuterike nga SESSH -i	57239	
11	Certifikata mjekësore të lëshuara	1522	
12	Pushime Mjekësore	1321	
13	Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë	1187	
14	Totali i vizitave	239039	
15	Shërbimet tjera shëndetësore	274568	
16	Totali i ofrimit të shërbimeve nga QKMF për qytetarët e K. Gjilanit	513607	

Aktivitetet

- Janë mbajtur takime të rregullta javore të Këshillit Profesional të QKMF-së
- Është bërë monitorimi i vijueshmërisë dhe disiplinës së punëtorëve në QKMF, QMF dhe AMF.
- Konform nevojave në mënyrë kontinuele janë marrë masa në drejtim të sigurimit të aparaturës dhe materialit të nevojshëm për punë.
- Është bërë konsolidimi i shërbimeve në QKMF, QMF dhe AMF me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit të të gjitha moshave si në objektin e saj kryesor me shërbimet brenda saj, gjithashtu edhe në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare të shtrira në tërë territorin e Komunës së Gjilanit .

Stomatologjia

- Shërbimi i stomatologjisë i cili ofron shërbime shëndetësore me gjashtë ordianca brenda objektit kryesor QKMF , gjithashtu ka rrjetin e saj të karrigeve stomatologjike edhe nëpër qendrat e tjera si në qytet gjithashtu edhe nëpër fshatra. Shërbimet të cilat ofrohen janë :

- Preventivë
- Ortodonci
- Protetikë
- Kirurgji orale
- Sëmundje të dhëmbit

Të gjitha këto ofrojnë shërbime shëndetësore për të gjitha moshat e qytetarëve të Komunës së Gjilanit .

Rregullisht jemi të furnizuar me material të nevojshëm për punë në bazë të tenderit Komunal për furnizim .

Urgjenca

- Ofron shërbime shëndetësore 24 orë në ditë /7 ditë në javë .
- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës, vikendeve dhe festave , ku puna është duke shkuar mirë dhe pa probleme.

- Që nga fillimi i këtij viti kemi shtuar edhe një ekip në kuadër të kujdestarisë së natës dhe tani ka rrjedhe më të mirë të pacientëve dhe ofrim të shërbimeve shëndetësore më të shpejta dhe me cilësore .
- Është monitoruar në vazhdimësi autoambulanca në drejtim të funksionimit dhe furnizimi i saj me pajisje dhe mjete të nevojshme për punë në terren, rregullisht ka qenë e furnizuar me barëra dhe material tjetër harxhues për intervenime të shpejta në terren për të gjitha thirrjet nga ana e qytetarëve .

Laboratori

- Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të Laboratorit.
- Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët janë paraqit në sportelet e Laboratorit.
- Gjithashtu në mënyrë të rregullt jemi duke punuar edhe në laboratorin e QMF-së Dardania me dy ndërrime. Është krijuar infrastruktura dhe hapësira e nevojshme për të filluar me punë të Laboratorit edhe në QMF Arbëri dhe jemi në fazën përfundimtare të furnizimit me pajisje dhe mjete të nevojshme për punë që shpresojmë se me fillimin e vitit të Ri do të startojmë edhe me një shërbim shtesë në QMF Arbëria .

Vaksinimi

- Në bazë të planit vjetor të punës shërbimi i vaksinimit ka realizuar plan programin e paraparë sipas kalendarit .
- Është bërë furnizimi i rregullt me vaksina në bazë të planifikimit vjetor.
- Është bërë vaksinimi sipas planifikimit të fëmijëve parashkollor dhe atyre shkollor.
- Sikurse viteve tjera edhe në këtë vit në sezonin e vjeshtës nga IKPSH jemi furnizuar me vaksina kundër gripit sezonal edhe atë me 6000 doza për të rritur dhe 50 doza për fëmijë. Të gjitha këto vaksina janë aplikuar nga të gjitha qendrat e mjekësisë familjare, por kryesisht puna më e madhe në aplikimin e tyre tek ata të cilët kanë pas nevojë është bërë në QKMF dhe në QMF Dardani shërbimin e vaksinimit. Më këtë vaksinë janë vaksinua në:
 - QKMF 2400 pacient
 - Shërbimi i vaksinimit 2250 pacient
 - QMF Arbëri 300 pacient

- QMF Ramiz Cërrnicë 100 pacient
- QMF Dheu i Bardhë 150 pacient
- QMF Zhegër 300 pacient
- QMF Bresalc 100 pacient
- QMF Cërrnicë 200 pacient
- QMF Pogragjë 50 pacient
- QMF Përlepnice 50 pacient
- Dializë 100 pacient

- Përpos vaksinimit të rregullt dhe atij kundër gripit sezonal gjatë këtij viti janë paraqitur raste të reja me fruth dhe ne si QKMF-shërbimi i vaksinimit kemi kryer edhe vaksinim plotësues kundër fruthit në Komunë e Gjilanit për muajt shtator dhe tetor 2017. Gjithsej të vaksinuar me MMR janë 5036 duke llogaritur nga mosha nënë 1 vjeç e deri tek fëmijët shkollor të pa vaksinuar. Gjithashtu janë vaksinuar edhe 40 fëmijë të komunitet RAE, ku shihen në tabelën në vijim .

Qendra për Diabet

- Kanë vazhduar vizitat e rregullta në baza ditore për pacientët me DM tip I dhe II.
- Është bërë Edukimi shëndetësor i grupeve të pacientëve me diabet për ngritjen e nivelit të njohurive për sëmundjen.
- Në mënyrë të rregullt jemi furnizuar me të gjitha llojet e Insulinave për pacientet e diagnostikuar me sëmundje të sheqerit, ku mbahet evidencë e rregullt dhe distribuim strikt me të gjitha llojet për çdo pacient .
- Gjithashtu gjatë punës ditore në Qendrën e Diabetit thuajse çdo pacienti i punohet glikemia dhe në mënyrë të rregullt kemi qenë të furnizuar me aparate për matje të sheqerit dhe me shirita përkatës.
- Gjatë punës tonë në këtë Qendër kemi edhe raste të reja të cilat diagnostifikohen me këtë sëmundje dhe në mënyrë të rregullt bëhen kërkesa për furnizim me numër më të shtuar të insulinave varësisht nga paraqitja e rasteve të tilla.
- Përpos insulinave qendra është e furnizuar edhe me material tjetër të nevojshëm për intervenime sipas rasteve.

Barnatorja

- Janë bërë kërkesa të rregullta mujore për furnizim me barna dhe material tjetër harxhues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Përpos furnizimit sipas kërkesave tona nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë nëpërmjet listës esenciale ne si QKMF kemi intervenu me buxhetin tonë dhe jemi furnizua edhe me barëra dhe material tjetër harxhues për të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare me theks të veçantë për shërbimin e Urgjencës.
- Janë mbajtur evidencat e rregullta dhe është bërë udhëheqja e protokollove për hyrje-daljet e barnave dhe materialit tjetër medicinal.
- Është kryer furnizimi dhe distribuimi insulinave tek pacientët me diabet.
- Është bërë planifikimi për gjashtë mujorin e dytë për furnizim me barëra dhe material tjetër harxhues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Gjithashtu gjatë muajit dhjetor është bërë planifikimi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018–të për furnizim me barna dhe material tjetër harxhues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë sikurse edhe për furnizim me insulina për të gjithë pacientet me diabet.
- Nga Ministria e Shëndetësisë na është kërkuar që të bëhet një planifikim në bazë të buxhetit të caktuar nga ana e tyre i cili buxhet nuk i mbulon as për së afërmi nevojat e kërkesave që kanë pacientët, dhe ne si institucion përpos këtij planifikimi kemi bërë edhe planifikimin sipas nevojave vjetore për të gjithë pacientët të cilët marrin shërbime në qendrat tona.

Shërbimi i Sistemit informativ shëndetësor

- Janë furnizuar me sasi të nevojshme të fletëzave kompjuterike.
- Është bërë përmirësimi në raportim dhe informim të shërbimeve shëndetësore në të gjitha QMF-të dhe AMF-të.
- Është duke u përcjellë gjendja e pacientëve me sëmundje kronike, masovike jo ngjitëse dhe me sëmundje malinje përmes formularëve adekuat për evidentim e këtyre sëmundjeve, gjithashtu është duke u përcjellë edhe pjesa epidemiologjike e sëmundjeve ngjitëse .
- Në muajin tetor ka filluar pilot projekti i regjistrimit të kartelave elektronike për pacientët në QKMF duke i përfshirë të gjitha shërbimet të cilat ndodhen brenda objektivit të

saj siç janë: Mjekësia Familjare, Stomatologjia, Laboratori etj. Është duke vazhduar implementimi i këtij projekti dhe deri më tani kemi arritur të fusim në sistem një numër prej 2745 pacientëve.

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Janë mbajtur takime të rregullta të Komitetit për cilësi.
- Është bërë monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore nga ana e Koordinatorit për cilësi,
- Është realizuar një rishqyrtim kolegjial.
- Është realizuar edhe një Auditim mbi kohën e pritjes për pacient në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Qendra e trajnimit të Mjekësisë Familjare

- Janë mbajtur sesionet klinike për specialistët e Mjekësisë Familjare nga Komuna jonë Vitia dhe Kamenica prej trajnerëve të Mjekësisë Familjare.
- Ka vazhduar bashkëpunimi me Spitalin Përgjithshëm të Gjilanit dhe IKSHP në Gjilan me qëllim që specialistët tanë një pjesë të stazhit të tyre specialistik të kryejnë në këto institucione.
- Mbahen trajnime për infermiere në të gjitha Qendrat dhe është duke u zgjeruar programi për vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë, dhe në bazë të raporteve mujore ne po paraqesim në mënyrë tabelare punën tonë një vjeçare në terren .

Indikatori	Numri
Numri i vizitave shtëpiake për fëmijë	963
Numri i vizitave shtëpiake për shtatzëna	224
Nr. total i vizitave shtëpiake të kryera (gjatë një muaji)	1187

Nr. i fëmijëve vajza të cilat kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë) 471

Nr. i fëmijëve djem të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë) 455

Nr. Total i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë) 926

Nr. i shtatzënave që kanë pranuar 1 vizitë gjatë shtatzënisë (Janë vizituar për herë të parë) 203

Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes 90

Numri i familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që kanë pranuar të paktën një vizitë shtëpiake 23

Numri i fëmijëve të referuar tek specialistet mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare 27

Numri i infermiereve që janë duke i zbatuar vizitat në shtëpi 210

Edukimi i vazhdueshëm profesional

- Në baza të rregullta javore janë mbajtur ligjërata të Edukimit të vazhdueshëm profesional si për mjek gjithashtu edhe për infermieret e të gjitha Qendrave të Mjekësisë Familjare, ku gjatë këtij viti janë realizuar gjithsej 17 ligjërata nga mjekët dhe 26 ligjërata nga infermieret, ku janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Edukimi shëndetësor i popullatës

- Janë organizuar takime në komunitet me grupe të ndryshme pacientësh në bazë të nevojave të tyre.
- Janë realizuar takime të rregullta me grupin për edukimin shëndetësor
- **“Projektit për kontrollat sistematike për nxënësit”** (e klasave të para, të pesta dhe nënta), nga ana e ekipeve të Mjekësisë Familjare dhe të atyre të Stomatologjisë në terren në të gjitha Shkollat Filllore të Komunës së Gjilanit i cili kishte filluar në muajin shkurt ka përfunduar në muajin qershor .

- Është përfunduar raporti i të dhënëve mbi kontrollimet sistematike dhe jemi në përfundim të organizmit të prezantimit para organeve kompetente si të: K. Komunal, drejtorive përkatëse dhe drejtorëve të shkollave të Komunës së Gjilanit .

Infrastruktura dhe pajisjet.

- Është bërë mirëmbajtja dhe funksionimi optimal i objekteve ekzistuese.
- Nëpërmjet tenderit të siguruar nga ana e Komunës për furnizim me barëra dhe material tjetër harxhues jemi furnizuar me pajisje dhe mjete të nevojshme për punë për të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe në të gjitha Qendrat i kemi montua (pajisje set) Otoskop, Oftalmoskop, dritë për ekzaminim të fytit dhe pasje tjera të nevojshme.
- Është monitoruar funksionimi i pajisjeve ekzistuese.
- Është pranuar si donacion një Autoambulancë nga një bashkatdhetar i fshatit Përlepnice me qëndrim në Finlandë nga z. Nexhat Shemsiu.

Investimet kapitale

- Kemi përfunduar pothuajse të gjitha investimeve në infrastrukturë nëpër të gjitha Qendrat në Qytet në drejtim të rregullimit të sporteleve dhe krijimit të këndeve të informatave në formë të hapur edhe atë:
- **QMF Dardania**
- **QMF Arbëria**
- **QMF Ramiz Cërnica**
- **QMF Dheu i Bardh**
- **QMF 28 Nëntorit**
- Kemi renovu Qendrën e Mjekësisë Familjare në Cërrnicë, është bërë gëlqerosja e objektit komplet nga brenda dhe jashtë , është përmirësuar komplet infrastruktura e kësaj qendre dhe janë krijuar kushtet më të mira për punë .
- Siç dihet është duke vazhduar puna në ndërtimin e QKMF-së së re .
- Në të gjitha Qendrat e mjekësisë familjare kemi bërë zëvendësimin e dritave të zakonshme me ato më pak harxhuese.

- Për të gjithë punëtorët shëndetësor është blerë uniformë edhe atë (mantila, pantallona dhe kllompe), kurse për punëtorët ndihmës është sigurua uniformë adekuate .

Qendra për Punë Sociale në Gjilan

Në Periudhën janar-dhjetor janë dhënë gjithsej 343 vërtetime palëve

202 vërtetime- se nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale

68 vërtetime -që janë shfrytëzues të ndihmës sociale,

29 vërtetime për botën e jashtme,

16 vërtetime për KEK dhe

7 vërtetime destinime tjera, për student janë dhënë 3 vërtetime për strehim në konvikt si dhe janë dhënë për student për lirim nga regjistrimi i semestrit 18 vërtetime.

Janë pranuar 141 ankesa të palëve, në shkallën e parë kanë qenë 111 ankesa

36 ankesa janë aprovuar,

51 ankesa janë refuzuar

24 ankesa kanë mbetur në procedurë

Për shkallën e dytë kanë qenë 30 ankesa:

6 ankesa janë aprovuar,

15 janë refuzuar,

9 ankesa janë në procedurë.

Në Periudhën janar-dhjetor në komision mjekësor janë shqyrtuar 1203 lëndë:

janë aprovuar 1164 lëndë

28 lëndë janë refuzuar ,

11 lëndë kanë mbetur në procedurë plotësim të dokumenteve.

Në periudhën janar-dhjetor janë verifikuar dhe ri verifikuar 1615 familje prej tyre janë:

aprovuar 1054 lëndë,

558 lëndë janë ndërprerë ose refuzuar .

3 kërkesa kanë mbetur në procedurë,

Në muajin shkurt ka qenë kontrolla nga DMS ku janë kontrolluar 227 lëndë. Janë verifikuar 63 lëndë në terren dhe mendojmë se vlerësimi i komisionit duhet të jetë më i mire.

Janë shpërndarë 20 pako ushqimore rasteve më të rënda sociale, ku donator ka qenë një prift Gjerman. Për festën e Bajramit janë shpërndarë 250 pako ushqimore familjeve me gjendje më të rëndë ekonomike dhe sociale ku donator kanë qenë vëllezërit e drejtorit z.Mursel Zymerit.

Në muajin Gusht janë shpërndarë 150 familjeve nga 5kg mish ku donator ka qenë Ambasada e Emirateve Arabe.

Qendra për Punë Sociale në Gjilan

Shërbimi Social

Raport statistikor 01.01.2017 deri me 15.12.2017

1.Fëmijët të braktisur të porsalindur-----	4
2.Fëmijët me sjellje asociale-----	22
3.Fëmijët e keqtrajtuar jashtë familje-----	3
4.Kërkesat për adoptim-----	7
5.Viktimat potenciale të trafikimit-----	2
6.Viktimat e dhunës në familje-----	71
7.Problemet bashkëshortore-----	24
8.Të rritur me nevoja të veçanta-----	7
9.FFAK-Femijë-----	32
10.Fëmijë të përfshirë në punë-----	1
11.Delikuent-----	95
12.Klient tjerë-----	540
13.Të moshuarit e vendosur në SHP Prishtinë-----	03
14.Fëmijë pa përkujdesje prindërore-----	06
15.Totali-----	827

Shërbimet shtesë

1.Prezentime në seanca gjyqësore-----	100
2.Prezentime në polici-----	99
3.Konsultime me palë-----	2635
4.Vizita familjare-----	656
5.Vizita institucionale-----	21
6.Bashkëpunime me shkollat-DKA-----	26

7.Bashkëpunime me DPSF-Prishtinë-----	89
8.Bashkëpunime me QSHM Gjilan-----	9
9.Bashkëpunime me familjet strehuese -----	47
10.Bashkëpunim me Strehimoren Liria-----	12
11.Bashkëpunime me QPS-të-----	73
12.Bashkëpunime me strehimoren MVPT-----	5
13.Bashkëpunim me SOS Fshatin Prishtinë-----	14
14.Takime vlerësuese DKA-----	16
15.Furnizim i familjes me ushqim-----	31
16.Komisione Mjekësore FFAK-----	3
17.Mbajtja e TMR-----	2
18.Mbajtja e trajnimeve, tryezave, grupeve punuese-----	7

Shërbimet e ofruara dhe rasteve të bartura nga viti paraprak

1.Të moshuar në Shtëpinë e Pleqve Prishtinë-----	7
2.Fëmijët nën kujdestari -----	33
3.Fëmijët në strehim familjar të të afërmit-----	22
4.Fëmijët e vendosur në familje strehuese alternative-----	4
5.Personat e vendosur në SHI-Kamenicë-----	4
6.Personat madhor me aftësi të kufizuara në IS-Shtime-----	1
7.FFAK fëmijë të kompensuar materialisht -----	158

DREJTORIA E ARSIMIT

Struktura organizative e drejtorisë komunale të Arsimit

Drejtorja komunale e Arsimit funksionon në tre sektorë:

- 1.Sektori i Arsimit
- 2.Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike dhe Personel në Arsim
- 3.Sektori i financave

Gjendja e përgjithshme në arsim

Në Komunën e Gjilanit mësimi zhvillohet në gjuhët: shqipe, serbe, turke dhe rome në këto nivele: parashkollor(0-5) vjeç., parapërgatitor (5-6) vjeç, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i

lartë. Në kuadër të dy SHFMU – ve funksionojnë edhe klasat e bashkangjitura të nxënësve me nevoja të veçanta.

I. Sektori i Arsimit

Synimi i përgjithshëm i DKA –së në të gjitha Institucionet Edukativo Arsimore të Komunës së Gjiilanit, ka qenë dhe mbetet, ngritja e cilësisë në procesin edukativo – arsimore, përmirësimi i infrastrukturës së IEA –ve, ngritja profesionale e personelit profesional, zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve, pedagogjike, administrative, juridike dhe financiare.

Sektori i arsimit funksionon në bazë të niveleve në pajtim me ligjin për arsimin para universitar, parashkollor (0-6) vjeç, fillor, i mesëm i ulët dhe niveli i mesëm i lartë. Në kuadër të këtyre niveleve kryhen aktivitete të shumta nga ana e zyrtarëve përkatës. Në këtë periudhë janë realizuar detyra të rëndësishme:

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Inspektimet në institucionet edukativo arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve të DKA-së.
- Përgatitjet për mbajtjen e testeve të semimaturës dhe maturës shtetërore -2017.
- Përgatitjet për zbatimin e kurrikulës së re kombëtare që ka filluar së zbatuari nga shtatori 2017. Janë trajnuar të gjithë mësimdhënësit e

klasave : para fillore, klasa e I, VI dhe X-ta.

- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re (klasa I-rë, VI-të dhe X-të).
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet parashkollore, në klasat e para dhe të dhjeta.
- Është bërë shpërndarja e teksteve shkollore falas nga MASHT për nxënës, për dallim nga vitet tjera në këtë vit, librat janë shpërndarë për nivelin fillor (I – V) – ta.
- Përpunimi, analiza e rezultateve të suksesit për nxënës në vitin akademik 2016/17 për nivelin fillor, niveli i mesëm i ulët; niveli i mesëm i lartë. (raportin e suksesit, bashkangjitur).
- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, përfshirë infrastrukturën shkollore dhe buxhetin në sistemin EMIS.
- Analiza dhe raportimi i statistikave në afatet janar- tetor.
- Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Arsimin Para universitar
- Organizimi i garave të njohurive dhe shkathtësive.
- Pilotimi i projektit “Matura Digjitalë” me nxënësit e kl.XI-ta të Gjinnazeve.
- Grumbullimi dhe kontrollimi i planeve të punës për vitin shkollor 2017/2018
- Grumbullimi dhe vlerësimi i planeve zhvillimore të rishikuar
- Realizimi i Kontrollit Sistematik shëndetësor për nxënësit e klasave të I – V –IX në bashkëpunim me Qendrën e Kryesore të Mjekësisë Familjare.

- Trajnimi i ekipeve /përfaqësuesve të 13 SHFMU (26 pjesëmarrës drejtorët dhe koordinatorët e cilësisë) për vlerësim të brendshëm të performancës së Shkollës, në kuadër të përpjekjeve për Sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me autorizim të MASHT-it dhe me mbështetje financiare nga UNICEF.
- Pilotimi i projektit “Matura Digjitale” me nxënësit e kl.XI-ta të Gjinnazeve.
- Planifikimi i normave dhe vendeve të punës për nevojat e shkollave për kompletimin e (stafit menaxherial, personeli profesional dhe stafin përkrahës teknik).
- Vlerësimi i Dosjeve të mësimdhënësve të klasave: parapërgatitore, të para, të gjashta dhe të dhjeta.
- Trajnimi i stafit menaxherial dhe stafit mësimdhënës në shkolla.
- Mbajtja e konferencave me gazetar për arsimin komunal, takime të rregullta në MASHT, takime konsultative me stafin e DKA-së, mbledhje të rregullta me komitetin për arsim, raportimi për punët e DKA-së dhe shkollat, takime me OJQ vendore dhe ndërkombëtare, mbajtja e mbledhjeve të rregullta dy javore me menaxherët e IEA-ve etj.
- Pilotimi i projektit “Matura Digjitale” me nxënësit e kl.XI-ta të Gjinnazeve.

II. Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike dhe Personel në Arsim

Në sektorin për punë të përgjithshme juridike dhe personel në arsim janë kryer këto aktivitete si vijon:

Aktivitetet e kryera	Gjithsejtë
Hartimi i shkresave të ndryshme, vendime për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ri caktime, pushime të lehonisë, pa pagesë, vendime ad- hoc etj	475
Seanca disiplinore të përfunduara	0
Seanca disiplinore në procedurë të shqyrtimit	0
Seanca të komisionit të ankesave të përfunduara	13
Intervistat e mbajtura (vendet e punës) për pozitat: drejtor dhe zv.drejtor	19
Intervista e mbajtura (vendet e punës) për mësimdhënës	42
Hartimi i kontratave të punës	576
Arkivi, lëndët e pranuar, regjistruara dhe protokolluara	1155
TOTALI I AKTIVITETEVE	2280

III. Sektori i Financave

Pasqyra e shpenzimeve buxhetore

RAPORTI dymbëdhjetë mujor i shpenzimeve, deri me datën (31.12.2017)

Nj	Kategoria	Shuma e shpenzimit	E shprehur në %
a)	Pagat	10.406.516.53	98%
b)	Shërbimet dhe mallrat	1.303.140.00	98.%
c)	Komunalitë	177.678.00	82%
d)	Subvencione	26.000.00	47%

q)	Kapitale	395.177.00	98%
	Totali	12.308.512.00	97.70%

Deri më tani në programin e kontabilitetit janë regjistruar 1314 lëndë të IEA-vë të paguara. Është futur në sistemin BDMS buxheti i IEA-ve për vitin 2018. Janë skanuar 187 lëndë të ndryshme dhe përcjellë tek personat kompetent.

IV. Infrastruktura, Renovimet dhe Furnizimi i IEAA-së

- **Kampusi i shkollave** të mesme - është realizuar faza e parë e kampusit të shkollave të mesme ku përfshihen rreth 4.850 nxënës dhe 330 mësimdhënës duke vlerësuar fillimin e fazës së dytë. Realizimi i fazës së dytë të punimeve do të përfshijë rrugën, sistemin e ndriçimit, sistemin e mirëmbajtjes përfshirë edhe ujitjen dhe terrenet sportive. Kantina e re e cila do të vendoset dhe dedikohet për shkollën e mesme teknike ‘Mehmet Isai, investim ky i Komunës me participim - participim publiko privat (PPP).
- Është përfunduar ndërtimi i çerdhes në lagjen “Dardania” me donacion të USAID-it dhe participim të komunës (programi Qeveri për Qeveri)
- Është filluar ndërtimi i sallës së ed. Fizike për shkollën fillore “Rexhep Elmazi” dhe shkolla do të mund të fitoj nga aneksi i ri edhe 2 klasa për mësim të nxënësve para fillor.
- Është iniciuar kërkesa për procedura të fillimit të ndërtimit të IP - së së re në Lagjen Arbëria, në bashkë koordinim me MASHT dhe EU si donatorë.
- Po punohet drejt përfundimit të sallës së edukatës fizike të shkollës fillore “Liria” në Pogradje, investim i MAPL-së.
- Është përfunduar aneksi i shkollës fillore në fshatin Ponesh, donacion i USAID-it me participim të komunës.
- Përcjellja e punimeve të ndërtimit të shkollës së mesme të muzikës dhe arteve duke adresuar vonesat tek donatori, përkatësisht MASHT.
- Është filluar me punimet për ndërtimin e shkollës fillore në fsh. Haxhaj.

Renovimet:

SHML “Marin Barleti”- janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme
- Montimi i dyerve të reja në klasa
- Shtrimi i dysheve të klasave me linolium.

Gjimnazi “Zenel Hajdini”- janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme

- Punimi gjeneral i nyjeve sanitare dhe instalimi e

Vendosja e pllakave ne korridore dhe shkallë. **SHFMU “ Thimi Mitko”- janë përfunduar këto punë;**

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme
- Shtrimi i dysHEMEVE të klasave me linoleum dhe laminat.
- Punimi i grilave nga çeliku për dritare në bodrum.
- Shtruarja me laminat e hapësirave të zyrave.

Riparimi i tualeteve.

SHFMU “Musa Zajm” – janë përfunduar këto punë;

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme
- Montimi i dyerve të reja në tualete.
- Veshja e shkallëve të jashtme me pllaka.
- Punimi i rampës së qasjes për FNV.
- Shtruarja me pllaka qeramike dysHemetë dhe nivelizimet në tualete.

Veshja e amfiteatrit në ambientet e jashtme me pllaka.

SHFMU “Sadullah Brestovci” - janë përfunduar këto punë;

Ngjyrosja e hapësirave të brendshme

- Riparimi i nyjeve sanitare me pllaka qeramikë

SHFMU “ Afërdita “ - janë përfunduar këto punë;

- Ndërimi i dyerve dhe dritareve nëpër klasë (Gadish).

SHFMU “Fetah Qerimi”- janë përfunduar këto punë;

- Ndërimi i dyerve dhe dritareve nëpër klasë (Zhegoc)

SHFMU “Dëshmorët e Kombit “ - janë përfunduar këto punë;

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme
- Montimi i derës së hyrjes PVC.

SHFMU “Agim Ramadani” - janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar.

- Ngjyrosja e hapësirave të brendshme

SHFMU “Liria” - janë përfunduar këto punë;

- Shtrimi i dysHEMEVE të klasave me linoleum (Pogragjë).

SHFMU “Nazmi Hoxha”- janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar.

- Ngjyrosja e klasës për parashkollor.

SHFMU “Ramiz Cërrnica”, Kravaricë: janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar.

- Ngjyrosja e hyrjes së jashtme dhe e brendshme e shkollës
- Vendosja e disa dyerve të klasave.

Gjimnazi “Xhavit Ahmeti ”- janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar.

- Ngjyrosja e sallës së ed. Fizike dhe hapësirave përcjellëse me ngjyrën yndyore.
- Vendosja e grilave tek kolektorët.

SHMT “Mehmet Isai” - janë përfunduar të gjitha punët e planifikuara në renovimin e shkollës sipas dinamikës së planifikuar

- Hapja e kanaleve të kanalizimit dhe vendosja e gypave.

Furnizimet e IEA-së:

Furnizimi me inventarë: banka, karrige etj:

Janë furnizuar katër shkolla me banka, karrige dhe tabela shkrimi në vlerë prej 4108.90 €
Janë furnizuar me inventar për zyre si: ormanë për dokumente, vitrina për dokumente, tavolina pune, karrtka statike, karrtka lëvizëse dhe perde shiritore tetë shkolla dhe DKA. në vlerë prej 8236.00 €.

DKA +18 furnizime në Shkollat e minoritetit serb dhe rome në vlerë prej **2703.91 €**.

DKA+18 furnizime të shkollave të minoritetit serb DKA +b dhe rom prej 2933.80 €

DKA+21 furnizime të shkollave të minoritetit serb dhe romë prej 4334.77 €

Tetë shkolla të minoritetit serb dhe rom në vlerë prej 11,867.47 €.

Transporti / Bartja e nxënësve – relacionet

Është vazhduar transporti për nxënësit të cilët udhëtojnë mbi 4 km në relacionin shtëpi – shkollë. Transporti nxënësve bëhet në 15 relacione me 661 nxënës , duke përfshirë edhe rastet e Fëmijëve me nevoja të veçanta (16 nxënësve me N/V/ të shkollave në qytet kanë transport të organizuar),dhe në dy raste dy nx.me /N.V/ dhe një rast për tre nxënës me ndihma sociale, raste ku DKA i paguan shpenzimet e udhëtimit.

Donacionet :

Karitasi Zviceran, pajisë klasat parapërgatitore me pako të materialeve didaktik dhe inventar, për 15 dhoma klasa edukative.

Komuna e Bursës së Turqisë donacion 456 projektor, 50 perde për projektor dhe 4 tabela të mençura.

GIZ- Gjerman:

Trajnime për mësimdhënës të Shkollave fillore dhe të mesme të ulëta

Vlerësimi i planeve zhvillimore për të gjitha IEA

Pajisja e plotë e kabinetit për **profilin MEKATRONIKE** duke përcjellë me trajnimin gjatë montimit të pajisjeve për mësimdhënësit përgjegjës dhe përdorimin e pajisjeve si pako e veçantë e trajnimit për mësimdhënësit e shkollës së mesme teknike Mehmet Isai, nga ekspert të përzgjedhur nga Qeveria Austriake

Banka Gjermane për Zhvillim KFË - HO, ka iniciuar procedurat për rizgjedhjen e kompanisë për të filluar ndërtimin, përkatësisht renovimin e plotë të tre shkollave përfituese (Skënderbeu, Ibrahim Uruqi, Dëshmorët e Kombit) në realizim të projektit për Eficiencë të energjisë.

Bashkimi Evropian, Shkolla Filllore e Mesme e Ulët, “Vatra e Diturisë” – Livoc i Epërm, nga BE-ka fituar kabinet modern të teknologjisë informative.

V. Kontakte bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe organizata qeveritare dhe joqeveritare

Drejtori i drejtorisë komunale të Arsimit gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtruar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim.

1. Save the Children,
2. Kolegjin “ Mehmet Akif”-Lipjan, z. Alush Ergin dhe profesorët e Kolegjit
3. Përfaqësuesit e GIZ-it (Deutch Gesellscaft International Zumammenarbeit)
4. Caritasi Zviceran.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, gjatë këtij viti kemi kryer këto aktivitetet si në vijim:

Pasqyrat vjetore 2016 për MF

Raportin financiar 2016 për Kuvend

Raportet financiar tremujore 2017 për Kuvend

Informata financiare mujore

Pasqyrat nëntëmujore 2017 për MF

Rrjedhën e parasë (plani i keshit) për të gjitha njësit buxhetore dhe gjitha kategoritë ekonomike dhe atë në fillim të vitit dhe transferve të ndryshme.

Qarkoret interne buxhetore.

Përgatitja e KAB për vitin 2018-2020

Planifikimi i buxhetit për vitin 2018 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2018-2020 prej fazës fillestare deri te aprovimi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Shpërndarja e mjeteve të bartura nga viti 2016

Analiza për rishikim për të gjitha njësit buxhetore dhe kategoritë të shpenzimeve

Analiza për transfere për të gjitha njësit buxhetore dhe kategoritë të shpenzimeve

Formimi i dokumentacioni për kode të projekteve dhe alokimin e tyre nga MF

Analiza e alokimeve buxhetore si p.sh raporti i alokimeve për Paga&Meditje,Mallra&Sherbime, Komunal, Investime Kapitale dhe Subvencione.

Analiza e Paga&Meditje për të gjitha programet buxhetore.

Formimin e dokumentacionit nga participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe alokimin e mjeteve.

Bashkëpunimi i ngushtë me auditorët e jashtëm dhe të brendëshëm për të gjitha drejtoritë

Pranojmë të gjitha raportet e të hyrave nga BQK

Përpunojmë të gjitha të hyrat sipas kodeve dhe drejtorive.

Regjistrojmë të gjitha të hyrat në akses.

Regjistrojmë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet në SIMFK.

Përgatisim për të gjitha drejtorit raporte të të hyrave javore (52 raporte), mujore (12 raporte) dhe vjetore .

Bëjmë barazime ditore me BQK dhe bankat komerciale.

Barazime mujore me MF-thesar

Barazime mujore me drejtoritë

Barazime tre mujore me MF, zyrën e alokimeve.

Përgatisim në baza ditore raporte për të hyrat për secilën drejtori(248 raporte).

Përgatisim UNIREF-at për të gjitha faturat e drejtorive

Mbajmë evidencë analitike për çdo lloj të hyre .

Mbajmë evidencë analitike për të gjitha shpenzimet.

Shtypim listat e pagave të dërguara nga Menaxheri i zyrës Personelit i dërgojmë për verifikim nga drejtorët përgjegjës dhe nënshkrim nga shërbyesit civil me përjashtim Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i kryejnë vet.

Në arkiv janë protokolluar 27619 lëndë

Kemi bërë shtypjen dhe shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë (32000 fatura)

Gjatë punës vjetore bëjmë shtypjen e faturave të Tatimit në Pronë me kërkesë të tatimpaguesve dhe lëshojmë vërtetime të ndryshme (27243 vërtetime ku një vërtetimi i bashkëngjiten 1-3 fatura).

Kemi kryer verifikimin e 1/3 së objekteve të paraparë me ligj(1629).

Kemi shqyrtuar ankesat së bashku me Bordin për shqyrtimin e ankesave (110 ankesa nga të cilat 91 janë aprovuar kurse 19 janë refuzuar).

Kemi bërë regjistrimin e objekteve të reja (1186 objekte)

Kemi bërë modifikimin e tatimpaguesve (12486 dhe atë: Nr.ID, emrat e prindërve, emërtimi i rrugëve dhe numrave të shtëpive si dhe ndërrimet në bazë të kontratave të shitblerjes.)

T'i procesoj thesari nga gabimet të cilat i kanë lëshuar bankat komerciale)

Kemi parashtruar kërkesa për kryerjen e borxheve AKP-së lidhur me ndërmarrjet e privatizuara që janë në shitje dhe në procesin e likuidimit

Gjatë këtij viti buxhetor janë zotuar (5900 lëndë), regjistruar si shpenzim, certifikuar, fotokopjuar dhe arkivuar në arkivin e thesarit komunal (5445 lëndë)

Regjistrimi i pasurive në SIMFK (195 Lëndë)

Përcjellim regjistrimin dhe transferet e inventarit

Nga Tatimi në Pronë janë inkasuar 1.299,929.02€ ose 87.22% e planifikimit.

Raportimi i obligimeve në MF çdo muaj(12Raporte)

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, DUPMM ka kryer detyrat dhe përgjegjësit bazuar në përshkrimin e punëve dhe detyrave punuese të secilit punëtor duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si dhe rregulloret komunale.

Duhet potencuar se gatishmëria e qytetareve ka qenë më e madhe se asnjëherë më parë në zyrtarizmin e ndërtimeve të reja duke u pajisur me leje ndërtimi pra qytetarët e Gjilanit janë vetëdijesuar në aspektin e ndërtimit sepse paraprakisht ju drejtohen zyrtarëve të drejtorisë për të shikuar se çfarë është planifikuar në parcelat e tyre dhe më pas ju nënshtrohen procedurave për të u pajisur me leje të ndërtimit e që kjo po ndikon në të hyrat e drejtorisë, por edhe në ruajtjen e hapësirave të planifikuara.

Gjithashtu edhe shqyrtimi i lëndëve të cilat drejtohen në këtë drejtori bëhet konform ligjit dhe me efikasitet të plotë.

Pra në DUPMM punohet me përkushtim të vazhdueshëm

DUPMM-ja është në vazhden e planifikimit të zonave të reja , implementimin e planeve rregulluese në teren, monitorimin e ndërtimeve si dhe angazhim konkret në legalizimin e objekteve pa leje

Aktivitetet e ndërmarrura gjatë kësaj periudhe kohore

-Përpilimi i detyrave projektuese për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme në zonën urbane si dhe procedimi i tyre për nxjerrjen e vendimeve nga K.K.Gjilan për fillim të procesit për hartim

-Përpilimi i detyrës projektuese

- hartimin e PZHK-së për territorin e Komunës si dhe procedimi i tij për nxjerrjen e vendimeve nga K.K.Gjilan për fillim të procesit për hartim

-Hartimi i hartës zonale

-Parku Baja

-Parku i Pages

-Hartimi i projekteve kryesore për vendosjen e shtatores së Idriz Seferit dhe busteve

-Fillimi i procesit të planifikimit të PZHK-se

- Incizimi i objekteve për nevoja të kërkesave në drejtori
 - Vazhdimi i procesit për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme Qendra 2, Qendra 3 si dhe lagjja e spitalit. Është përfunduar shqyrtimi publik.
 - Mbajtja e disa dëgjimeve publike sa i përket këtyre zonave
 - Përgatitja e planit të veprimit për Hartën zonale të Komunës
 - Sistemimi i planeve rregulluese të miratuara në sistemin GIS
 - Digjitalizimi dhe krijimi i data bazës për objektet e pajisura me leje ndërtimore në GIS për vitet 2011,2014,2015,2016,2017 dhe publikimi i tyre ne Web Gis,
 - Mbikëqyrja e punëve te projekteve kapitale në kuadër të Komunës etj.
 - Gjithashtu edhe te zona Zabeli 1 është përfunduar profile dhe analiza e gjendjes dhe po vazhdohet me tutje me procesin ...
 - Kemi mbajtur disa dëgjime publike lidhur me hapjen e trasesë së rrugëve në zonat Fidanishte 1 Kampi Monteith si dhe Livadhet e Arapit.
 - Takime të ndryshme zyrtare me MMPH
 - Përgatitja dhe përmbyllja e fazës së parë në projektin ARIS-sistemi i adresave
 - Janë kryer, inspektime nga ana e zyrtares së ambientit për lejet mjedisore
 - Janë mbajtur ligjërata me temën “Mjedisi dhe rëndësia e mbrojtjes së tij ‘ ’ në 8 shkolla fillore të Komunës së Gjilanit.
- Gjate kësaj periudhe kemi pasur **805** kërkesa ku nga to janë shqyrtuar **763** dhe janë në shqyrtim **42**
- Nga këto janë shqyrtuar:
- parcelime të truallit **403**,
 - kushte të ndërtimit **112**,
 - leje të ndërtimit **153**,
 - leje përdorimi **08**,
 - lajmërimë **18**,
 - Informata **35**,

- leje rrërimi **22** ,

-Njoftime **11**,

- leje mjedisore **24**,

dhe refuzim të kërkesave **21**.

➤ **Të hyrat nga lejet e ndërtimit**

Nga lejet e ndërtimit **1 050 195.70 €** apo **287229.0 m2**

Nga legalizimi i objekteve pa leje **5668.60 €**

Nga lejet mjedisore **91165.00 €**

Taksat nga kërkesat **5533.00 €**

Nga gjobat e inspeksionit **5400.00 €**

E që në total të hyrat në DUPMM janë **1 157 963 .30 €** apo është realizuar **100%** e planifikimit për **2017**, kurse vetëm nga lejet e ndërtimit është realizuar **112%** e planifikimit për **2017**.

Pra kjo na jep sinjalin e qytetarisë së përgjegjshme ndaj ligjit, planifikimit dhe përgjegjësisë duke i garantuar të gjithë që t'i drejtohen DUPMM-se ngase shërbimet do të jepen me shpejtësinë më të madhe të mundshme e te cilat do të ju kthehen në shërbim përsëri të qytetarit.

Në sektorin e inspeksionit ka pasur një vllug të madh të punëve, është bërë inspektimi i rasteve në proces të ndërtimit ku janë hartuar procesverbale për konstatimin e gjendjes, janë nxjerr vendime për ndërprerje të punimeve, vendim për rrenim, gjoba mandatore inicim i procedurave në gjykatë si dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetareve, te filluara pa leje si dhe atyre që kanë tejkaluar lejen e ndërtimit..

Siç edhe jeni informuar gjate kësaj periudhe kemi pasur edhe aksion për rrënimin e objekteve

Janë rrënuar **4** objekte ku dy nga këto kanë qenë objekte të banimit kolektiv njëra ka pasur destinim të një depoje si dhe një ka pasur destinim motel .

Ashtu edhe siç kemi deklaruar ne do të vazhdojmë prapë me aksionin për rrënim në të gjitha rastet ku tentohet të fillohet apo edhe të tejkalohet leja e lëshuar nga DUPMM-ja

Nga puna e këtij sektori del se kemi pasur mbi **300** inspektime, ku janë hartuar :

79 procesverbale nga këto :

71 vendime për ndërprerje të punimeve,

8 vendime për rrenim ,

18 inspektive në objektet e banimit kolektiv me kërkesë të investitorëve gjatë betonimit të shtyllave dhe pllakave

19 inicime për procedure kundërvajtëse,

8 kallëzime penale

9 gjoba mandatore të shqiptuara në vend punishte si dhe

5 ankesa nga qytetaret.

Gjithashtu ka vazhduar procesi i legalizimit për të gjitha ato objekte të cilat kanë qenë në procedurë, pasi që tani ka ndryshuar ligji dhe se jemi duke pritur vetëm miratimin e tij në kuvend dhe të vazhdojmë me legalizim sepse interesimi i qytetareve është çdo ditë e më i madh.

Gjate kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe miratuar 22 kërkesa të cilat kanë qenë në proces apo 6794.64 m² ose 5668.60€

Gjithashtu duhet njoftuar se kemi përgatitur programin zhvillimi dhe implementimi i platformës Web Gis për Komunën e Gjilanit e që jemi komuna e parë në nivel vendi që do të hyjë në sistem nga fillimi i muajit Korrik.

Pra Web Gis është një platforme online e cila i mundëson përdoruesve profesionist, por edhe publikut të kërkojnë, shikojnë dhe të kenë qasje në mënyrë shumë të thjeshtë e të shpejtë në të dhënat gjeohapësinore që kanë të bëjnë me Urbanizmin, Kadastrin, Sh.Publike , Bujqësinë etj pra me të gjithë sektorët ...

Raporti financiar

Investimet kapitale

Nr.	Investimet kapitale		Planifikimi 2017	Realizimi 2017	3;2
	1	2	3	4	
1	hartimi, mbikq. dhe pran.teknik 41457		80000.00	74582.64	93%
2	Implementimi I planeve regullative 41458		80000.00	72521.47	93%
3	Hartimi I planeve hapësinore		360000.00	106357.03	30%
	Gjithsejtë:(1+3)		520000.00	253461.14	49%

Raporti i shpenzimeve komunale

Nr.ren.	Përshkrimi	Realizimi 2016	Planifikimi 2017	Realizimi 2017	indexi(4:2)	indexi(4:3)
	1	2	3	4		
1	Rryma	7402.82	8,000.00	7042.79	95%	88%
2	Uji	170.47	300.00	250.10	147%	83%
3	Mbeturinat	154.32	300.00	154.32	100%	51%
4	Telefoni fix.	818.78	400.00	256.35	31%	64%

gjithsejtë:

(1+4)

8546.39

9000.00

7703.56

90%

86%

Të hyrat nga lejet mjedisore

Nr.	Muaji	Realizimi 2016	Planifikimi 2017	Realizimi 2017	4:02	4;3
1	Janar	11107.40	2000.00			
2	Shkurt	1700.00	3000.00			
3	Mars		3000.00			
4	Prill		4000.00	24353.00		609%
5	Maj		6000.00			
6	Qershor		5000.00			
7	Korrik		8000.00	12841.00		161%
8	Gusht		10000.00	13050.00		130%
9	Shtator		10000.00	5042.00		50%
10	Tetor		5000.00	14600.00		292%
11	Nëntor		5000.00	177.00		3.54%
12	Dhjetor		3000.00	21102.00		703%
		12807.40	64000.00	91165.00	712%	142%

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve komunale

Nr.	Përshkrimi	Realizimi 2016	Planifikimi 2017	Realizimi 2017	Index(4x2)	Index(4:3)
A	TE HYRAT	2	3	4		
1	Te Hyrat nga Lejet Ndërtimore	794165.14	940000.00	1050196.70	132%	112%
2	Te Hyrat nga Taksat-Kërkesat	5087.00	6000.00	5533.00	120%	79%
3	Te hyrat nga Gjobat	6600.00	10000.00	5400.00	22%	10%
4	Te Hyrat nga Lejet mjedisore	12807.40	64000.00	91165.00	712%	142%
5	Te hyrat nga Legalizimi	68305.96	140000.00	5668.60	9%	4%
	Gjithsejtë: (1+5)	886965.50	1160000.00	1157963.30	130%	100%
B	SHPENZIMET					
1	Mallra dhe Shërbime	29800.00	38000.00	35363.80	119%	93%
2	Komunalit	8546.39	9000.00	7703.56	90%	86%
	gjithsejtë: (1+2)	38346.39	47000.00	43067.36	112%	92%

Objektivat e DUPMM-së

Gjithsesi objektivat e drejtorisë janë të shumta por vëmendje të veçantë në vazhdimësi i kushtohet :

-shqyrtimit të drejtë dhe efikas të kërkesave të ndryshme të qytetareve,

- hartimit të elaboratit të shpronësimeve-interesave publike brenda PRRH të aprovuara, implementimin sa më efikas në terren të PRRH-ve të miratuara,

-hapjen e korridoreve të reja-rrugëve lidhëse dhe përmbledhëse dhe hapësirave tjera publike ne kuadër të PRRH-ve. etj

Riorganizimi i drejtorisë sipas ndryshimeve statutare por edhe pjesëmarrje aktive konform kërkesave

Planifikimi i DUPMM-së për periudhën janar-dhjetor 2018

1. Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK):

Është Plan Strategjik që përcakton caqet afatgjatë të zhvillimit ekonomik social dhe hapësinor për tërë territorin e komunës për një periudhë së paku tetë(8) vjeçare .

- Është iniciuar për shpallje në tender nga një kompani për Përkrahje profesionale dhe Hartimin e tij . Procesi i tij do të zgjatë disa muaj deri në fund të aprovimit në Kuvend Komunal .

2. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës (HZK) :

Është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

- **Inicimi i procedurës për shpallje në tender nga një kompani përfituese për Përkrahje profesionale dhe hartim të Hartës Zonale .**

3. Miratimi i Planit Rregullues të Hollësishëm : Qendra 2 , Qendra 3, Lagja e Spitalit

Është në proces të përfundimit të dokumentit. Janë mbajtur tri takime publike me qytetarët (Pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë dukshëm e vogël edhe pse nga Kompania janë shpërndarë nëpër shtëpi e lokale në tre rastet nga rreth 3000 thirrje .

Gjatë takimeve publike është prezantuar :

- Profili dhe Analiza e Gjendjes ekzistuese
- Konceptet e zgjidhjeve të Skenarëve të mundshëm
- Përcaktimi i Skenarit përfundimtar

Është mbajtur edhe shqyrtimi publik

Në muajin e ardhshëm Planifikohet të përmbyllet procesi si dhe të aprovohet dokumenti nga Kuvendi Komunal.

4. Hartimi i Planit Rregullues: Zabeli 1

Përfundimi i dokumentit të Planit si dhe Aprovimi nga Kuvendi Komunal në fund të muajit shtator.

5. Përgatitja e detyrave Projektuese rreth propozim zgjidhjeve për zonat MIKROURBANE Komunale.**6. Detyrat Permanente:**

- Shqyrtimi i lëndëve të kërkesave dhe ankesave .
- Parcelimet dhe riparcelimet nga Planet dhe rregulloret Komunale
- Vlerësimet e tenderëve
- Mbikëqyrjet dhe Pranimet teknike të projekteve kapitale të KK Gjilan

7. Hapja e trasesë së rrugëve ne zonat tek të cilat janë me Plane rregulluese të Hollësishme. Janë përfunduar elaboratet e shpronësimit për profilin e rrugëve në tri zonat:

- Fidanishte 1,
- Kampi Monteith,
- Livadhet e Arapit

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme të cilat i përkasin fushëveprimtarisë së vet - Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim konform buxhetit të projektuar-planifikuar, objektiv të vetin ka pasur arritjen e këtyre objektivave:

- Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore-akteve normative nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;
- Mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike-infrastrukturën;
- Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme;
- Krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

I. Statusi i lëndëve në procedurë Administrative

Drejtorja për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave dhe atë konform LPA dhe sistemit unik të përcaktuar nga MAPL për administratën komunale brenda afatit ligjor janë trajtuar këto lëndë si në tabelë:

Të arritura	1869
Në proces	69
Të miratuara	1800

1.1 Transporti rrugor i udhëtarëve - transporti në linjat urbane - periferike

Drejtorja për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj duke përfshirë edhe transportin e rregullt të udhëtarëve me taksì dhe me autobus.

Me vendim sipas Ligjit mbi Transportin Rrugor është bërë vazhdimi/vërtetimi i rendit të udhëtimit në linjat urbane-periferike në territorin e Komunës së Gjilanit në vitin 2017 për 17 operator nga 28.02.2015 deri 28.02.2018 për tri vite, taks e cila duhet të paguhet për çdo vit.

II. PROJEKTET KAPITALE –(Kompanitë e mirëmbajtëse përshkrim i shkurtër i punimeve me vlera)

- 2.1 Projekti - Mirëmbajta Dimërore e rrugëve të Komunës së Gjilanit 2016/2017 kontraktues ka qenë kompania “ TALI “ Sh.p.k ku kontrata ka filluar nga data 25.11.2016 deri me 25.03.2017 ku gjatë kësaj kohe ka pasur reshje të mëdha të bores dhe bllokim të fshatrave dhe rrugëve nëpër qytet, por me një angazhim të stafit të DSHPIB së dhe Kompanisë së kontraktuar, ja kemi dalë që me sukses të deblokojmë dhe pastrojmë të gjitha rrugët e qytetit si dhe në zonat e thella të fshatrave të komunës tonë. Kontrata ka qenë me vlerë 68.333.80€
- 2.2 Për projektin “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet dhe fshatra të Komunës së Gjilanit” kontrata është nënshkruar në muajin prill dhe menjëherë kanë filluar punimet në sanimin e rrugëve, mbushjen e gropave, si dhe në disa rrugë të qytetit janë shtruar shtresa të reja të asfaltit.
Punimet janë kryer me kohë dhe ju është dhënë prioritet rrugëve të qytetit në mënyrë që të ju shmangemi punimeve në sezonin e verës. Vlera e kontratës ka qenë rreth 115.000.00euro
- 2.3 Projekti “Pastrimi i rrugëve mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara”, tash së fundi me vendim nga OSHP është anuluar si aktivitet dhe është kërkuar që të rishpallet tenderi që nga fillimi. Ndërsa punët dhe shërbimet janë duke u kryer në bazë të një aneks kontrate në mes të Komunës dhe Ecohigjienës.
- 2.4 Drejtoria e SHPIB e ka realizuar projektin “Sinjalizimi vertikal – horizontal, numërimi i objekteve” projekti i cili është kontratë kornizë 3 vjeçare. Gjithashtu janë kryer të gjitha shpenzimet horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit përveç në ato rrugë ku mendohet me u punua dhe janë të kontraktuar siç është rasti me rrugën kryesore në qytet nga semaforët në drejtim të rrugës së Livoqit të Ultë.
- 2.5 Projekti “Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e Komunës së Gjilanit. Kontraktues “Viva Print” nga Gjilani. Ndriçimi publik në të gjitha fshatrat është duke vazhduar me sukses mirëmbajta nga Kontraktori. Pasi që kjo kontratë është përmbushur financiarisht, në ndërkohë është iniciuar procedura dhe ka përfundua me nënshkrimin e kontratës së re në mes të Komunës dhe Kompanisë “Toni “ nga Gjilani.
- 2.6 Drejtoria e SHPIB e gjithashtu me projektin “Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin e Gjilanit, është duke realizuar mirëmbajtjen dhe shtrimin e rrjetit të ri sipas kërkesës së qytetarëve.
Tani ne kemi filluar përgatitjet për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit.
- 2.6 Drejtoria e SHPIB e ka dorëzuar projektin “ Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i deponive të egra dhe i lumenjve”- është në departamentin e Prokurimit dhe së fundmi është në OSHP në ankimim dhe për këtë vit si duket nuk do të mund të kemi një kontratë të qëndrueshme për këtë aktivitet.
- 2.7** Projekti « Ofrimi i Shërbimit të varrimit në Komunën e Gjilanit », është kompania N.SH.T »Bereqeti » vlera e punëve për këta tre muaj ka vlerën 138,811.00€
- 2.8 Gjithashtu kemi dorëzuar projektin me titull "Projekte të vogla" dhe kontrata është nënshkruar ku me këtë rast kemi rregulluar një segment të kanalizimit në rr M.Idrizi, një të tillë në lagjen e Zabelit, pastaj kanalizimi në fshatin Ponesh, si dhe do të vazhdojmë me projekte të tilla m' varësisht prej nevojave më urgjente që kanë qytetarët.

2.9 Me Projektin “Rregullimi i trotuareve dhe rrugicave me kubëza betoni”, është realizuar rregullimi i një pjese të trotuarit të qytetit në drejtim të fshatit Livoq i Epërm, pastaj Sheshi i Ilegales i cili ka përfunduar. Si dhe disa rrugica në lagjen Dheu i bardhë.

2.10 Ka përfunduar rregullimi i hapësirës para ekzekutivit si dhe bazamenti për vendosjen e shtatores së heronjve Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha me ç ‘rast është bërë zhvendosja e shtatores si dhe është bërë përrurimi i sajë për nderë të ditës së çlirimit të qytetit.

2.11 Ka përfunduar me sukses projekti i vendosjes se shtatores se kolosit të Karadakut heroit të kombit Idriz Seferi, si dhe i 5 busteve të tjera nëpër vende të ndryshme të qytetit tonë.

2.12 Projekti “Bartja e automjeteve me merimangë” - Kontraktues “Auto Buli” Gjilan. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës.

2.13

III. Raporti detal i inspektorëve të komunikacionit dhe shërbimeve publike

Nr.	Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre	
1.	Numri i inspektimeve	347
2.	Numri i procesverbaleve	215
3.	Numri i kundërvajtjeve	21
4.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara	12
5.	Numri i automjeteve të përjashtuara nga komunikacioni	6
6.	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	3
7.	Numri i shenjave për parkim të konfiskuara	2
8.	Numri i kërkesave të pranuar	60
9.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	57
10.	Numri i kërkesave të cilat janë në shqyrtim	03
11.		

IV. Lista e të hyrave Për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim për Janar – Qershor .

Të hyrat nga Drejtoria e Shërbimeve Publike prej 01/01/2017 deri më 30/11/2017	
Të hyrat nga regjistrimi automjeteve	175,370.00
Të hyrat nga tërheqja automjeteve	18,804.00

Të hyrat nga shfry.proq. kërkesa	48,961.38
Të hyrat nga infrastruktura rrugore	1,557.50
Të hyrat nga gjobat mandatare	500.00
Të hyrat nga qiraja	86,083.27
Gjithsejtë	331,276.15

- V. Duke u bazuar në planin e punës, gjendjen në teren dhe ankesat e qytetarëve, DSHPIB në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka iniciuar kërkesën për iniciimin e procedurave të prokurimit për:

1	Kanalizimi në fshatin Llashticë ka filluar dhe ka përfunduar sipas planit dinamik .
2	Kanalizimi Lladovë –Zhegër faza e dytë është kryer në dy segmentet e tij , dhe ka mbetur edhe segmenti i tretë të përfundoj.
3	Trotuari në Zhegër është kryer me sukses dhe sipas dinamikës së paraparë.
4	Rrugët në lagjen “Femi Agani” është kontraktuar dhe kane filluar punimet
5	Rrugët në Lagjen e dytë kanë mbet me u shpalle aktiviteti i prokurimit.
6	Rrugët në lagjen e 8 kanë kontraktuar dhe kane filluar punimet në disa rrugë të kësaj lagjeje
7	Rrugët në lagjen e Zabelit kanë përfunduar në masën 80%
8	Varrezat e martirëve në fshatin Llashticë kanë përfunduar me sukses dhe sipas planit dinamik.
9	Rregullimi i ujësjellësit për burgun e ri në Pasjak (ka përfunduar)
10	Rregullimi urave mbi Zhegër janë kontraktuar dhe punimet janë duke u zhvilluar.

VI. Lista e iniciimi te detyrave projektuese

1	Rrugët ne fshatrat Selishtë, Çelik, Pidiq
2	Rregullimi i platos mbi lumin Mirusha
3	Rregullimi i trotuareve në lagjen Dardania është në proces të ankimimit dhe lënda është në rivlerësim

4	Rregullimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen Porodin është kryer projekti, dhe në radhë është shpallja e aktiviteteve të prokurimit për këtë projekt.
5	Ndërtimi i një muri mbrojtës në lagjen e Porodinit është kryer projekti.

VII. Aktivitete tjera të takimeve dhe bashkëpunimeve

- 7.1 DSHPIB – stafi ka bërë grumbullimin e shënimeve të performancës komunale për ofrimin e shërbimeve publike për vitin 2016 dhe i kemi dorëzuar MAPL-së.
- 7.2 Me KRU “Hidromorava” kemi vazhduar bashkëpunimin për intervenime në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 7.3 Përgatitjen e të dhënave mbi qiranë e pronës komunale për lokale afariste.
- 7.4 Kemi zhvilluar aktivitete për zbatimin e ligjit për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, për formimin e shoqatave të pronarëve lidhur me administrimin e ndërtesave kolektive
- 7.5 Marrja pjesë në komisione të ndryshme komunale për zgjedhjen e lëndëve për banim social të caktuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari
- 7.6 Kemi përgatitur dhe kompletuar tërë dokumentacionin e ndërtesave të banimit të partneritetit publiko privat për ndërtesat të ish kadastrit dhe përball Drejtorisë së Urbanizmit dhe komisioni ka shpallur ankandin publik për dhënien me qira të banesave dhe lokaleve pronë e Komunës. Disa nga lokalet dhe banesat janë dhënë me qira sipas procedurave, ndërsa pjesa tjetër të cilët janë tërheqë nga qiraja, do të rishpallen vitin që vjen.

VIII. SFIDAT E DREJTORISË PËR VITIN 2017

- a. Mungesa e stafit të suspenduar dhe zëvendësimi i tyre.
- b. Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja vijave ujore dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre mbetet prioritet;
- c. Caktimi i lokacionit të ri të varrezave të qytetit, ju ka dërguar kërkesë urgjente (DUMM)
- d. Ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet dhe fshatra duke përfshi edhe impiantin për trajtim të ujerave të zeza;
- e. Numri i madh i taksive me leje e posaçërisht i atyre pa leje;
- f. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të kafshëve,
- g. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të druve dhe rërës;
- h. Ndërtimi i autoparkut- për vendosjen e makinave të aksidentuara dhe tjerat që tërhiqen për shkak të parkingut të gabuar, veprave penale
- i. Për realizimin e kërkesave të qytetarëve, ngritjen e shkallës së ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe realizimin e gjitha projekteve që ka planifikuar DSHPIB-ja kërkojmë rekrutime të stafit të ri për zëvendësimin e stafit të suspenduar , si dhe buxhet shtesë për këtë drejtori.

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

Sipas planifikimeve, nga fillimi i muajit janar i gjithë stafi i drejtorisë është angazhuar në kompletimin e projekteve të parapara në programin e bujqësisë për vitin 2017. Gjithashtu, kemi përgatitur programin për revitalizimin e zonës së Karadakut me të cilin program kemi aplikuar te Caritas Kosova dhe me dy programe tjera kemi aplikuar te Tika Turke.

Gjatë muajit shkurt, fermerët janë njoftuar për skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR. Katër zyrtar të DBP të trajnuar për digjitalizim të parcelave, kanë punuar në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim të fermerëve për subvencionet, proces ky që ka përfunduar më datën 10.04.2017. Për subvencionet të MBPZHR, këtë vit kanë aplikuar **979** fermerë dhe ky është numri më i madh i aplikuesve i arritur ndonjëherë, gjë që tregon se kemi rritje në të gjithë nënsektorët e bujqësisë.

Aplikacionet për subvencione në MBPZHR - 2017			
Nr.	Lloji i kulturës dhe kafshëve	Nr. i aplikuesve	Sipërfaqja në Ha – krerë kafshë
1	Grurë	320	1301
2	Misër	129	262
3	Elb	3	8.74
4	Pemë	64	208.5
5	Material fidanor	1	24600
6	Perime	21	18.38
7	Lopë qumështore	294	2799
8	Dele	39	3632
9	Dhi	14	688
10	Derra	10	37
11	Bletë	69	3736
12	Pula vojse	1	10000
13	Qumësht	14	116802
Gjithsejtë		979	

Në bashkëpunim me USAID-in (programi AGRO) dhe SHPK CALABRIA, këtë vit kemi ngritur 50 ha me vishnje, varietete Hungareze **Botermo** dhe **Jubileum** të cilësisë ekstra.

Në këtë partneritet USAID-i ka siguruar fidanët, komuna ka marr përsipër sistemin e ujitjes, ndërsa Calabria ka kontraktuar me fermerë grumbullimin e prodhimit për 15 vitet e ardhshme. Kanë përfituar 31 fermerë dhe vlera investive e këtij projekti është **120,000.00 €**.

Edhe këtë vit kemi subvencionuar mbjelljet pranverore me farë misri FAO 400 dhe FAO 500 të Institutit të Osjekut, farë me potencial të lartë gjenetikë, ku kemi shpërndarë 600 thasë dhe kanë përfituar 394 fermerë të cilët nuk i kanë arritur kriteret për subvencione të MBPZHR. Projekti është realizuar me 14.04.2017 dhe kap vlerën prej **12,540.00 €**.

Me datën 05.06.2017 kemi implementuar projektin e folisë plastike. Në fokus i kemi pasur rastet me gjendje sociale më të rëndë dhe serrat familjare. Janë shpërndarë 5500 kg ose 4471.5 m foli, me trashësi 150 µ dhe me garancion dy vjeçar. Kanë përfituar 325 fermerë dhe vlera e këtij projekti është **10,395.00 €**.

Në bashkëpunim me DZHE dhe GIZ-in kemi ndërtuar 15 shtande mobile të cilat janë vendosur në disa pika të qytetit dhe prodhuesit vendor i kanë shfrytëzuar ato gjatë gjithë kohës, varësisht nga sezona e prodhimeve. Me këto shtande jemi dakorduar që të menaxhoj ndërmarrja tregu, ndërsa drejtoria e bujqësisë do të ndihmoj në përzgjedhjen e prodhuesve që do t'i shfrytëzojnë ato.

Vlerësimi i dëmeve nga temperaturat e ulëta me datat: 20, 21 dhe 22 prill në kulturat pemëtare. Si drejtori kemi ngritur një komision profesional për vlerësimin e dëmeve i cili komision ka vlerësuar të gjitha kërkesat e fermerëve dhe dëmet arrin vlerën **539,135.95 €**. Raporti final i vlerësimit të dëmeve i është dërguar MBPZHR, me kërkesë për kompensim të dëmeve.

Pas reshjeve të përcjella me breshër të datës 14.06.2017, kemi vlerësuar dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore. Dëmet janë kryesisht në kulturat perimore, në fshatrat: Velekincë, Llashticë dhe Livoq. Kemi pranuar 26 kërkesa për vlerësim dhe dëmi është vlerësuar në vlerë **29,453.00 €**. Pas përfundimit të vlerësimit raporti final i është dorëzuar Ministrisë së Bujqësisë për kompensim të dëmeve.

Gjithashtu, breshër kemi pasur edhe me datën 26.06.2017 në fshatin Stublinë. Komisioni i njëjtë ka vlerësuar dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore dhe dëmi është vlerësuar në vlerë **16,435.65 €**. Pas përfundimit të vlerësimit raporti final i është dorëzuar Ministrisë së Bujqësisë me kërkesë për kompensim të dëmeve.

Zhvillimi i sigurimeve bujqësore, është duke u zhvilluar nga MBPZHR me përkrahjen e korporatës financiare ndërkombëtare IFC (anëtare e bankës botërore). Takimi informues me fermerë është mbajtur me datën 27.06.2017 dhe kanë marr pjesë fermerët e interesuar për sigurimet bujqësore.

Me datën 20.06.2017 me vendim të kryetarit të komunës është emëruar komisioni komunal për korrje-shirje dhe fillimisht janë vizituar të gjithë kombajnerët për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike dhe dhënien e rekomandimeve për masat servisuere dhe pajisjeve të domosdoshme. Me datë 03.07.2017 jemi takuar me kombajnerët ku jemi dakorduar për çmimin dhe kushtet e korrjes. Pas përgatitjeve dhe vlerësimit se gruri e ka arritur pjekjen teknologjike, zyrtarisht është hapur fushata e korrje shirjeve me datë 10 korrik nga Kryetari i komunës, z. Lutfi Haziri bashkë me Komisionin komunal për korrje-shirje.

Nga kjo ditë komisioni ka vazhduar punën në terren dhe ka monitoruar nga afër fushatën e korrjeve.

Për shkak të kushteve klimatike të pa favorshme, duke filluar nga dimri shumë i ashpër dhe duke vazhduar me mungesë të reshjeve në fazat kritike të bimës, edhe përkundër farërave cilësore dhe aplikimit të masave agro teknike Rendimenti ishte mesatar.

Fushata është zhvilluar normalisht, është respektuar në plotni çmimi i korrjes dhe janë respektuar të gjitha kushtet e korrjes. Me datën 02.08.2017 është korrur ngastra e fundit në fshatin Gadish të fermerit Adem Sejdiu, me çka komisioni e shpall të mbyllur fushatën e korrje-shirjeve.

Me datë 08.08.2017, kultivuesit e vishnjës të mbjellura në fillim të vitit nga partneriteti me programin Agro – USAID dhe CALABRIEN, janë pajisur me sistemin e ujitjes për 50 Ha nga Komuna e Gjilanit. Përfitues janë 31 fermerë dhe vlera e projektit është **17,500.00 €**.

Drejtorja e Bujqësisë dhe Pylltarisë, me datën 13.10.2017, ka subvencionuar mbjelljet vjeshtore duke furnizuar fermerët me 200.000 kg farë gruri për 797 fermerë. Kjo sasi e farës është e mjaftueshme për mbjelljen e 833 Ha dhe janë shpërndarë varietete të shkurta dhe të gjata, të institutit të Novi Sadit. Vlera e këtij projekti kapë shumën rreth **62,000.00 €**

Me datën 18.10.2017, në bletishtën e Sabedin Sadikut në Malishevë, kemi organizuar shpërndarjen e 35 Centrifugave elektrike për bletarë. Me këtë është përmbyllur pajisja e të gjithë bletarve me centrifuga, që kultivojnë mbi 30 shoqri bletësh. Vlera e këtij investimi **12,000.00 €**.

Trajtimi i qenve endacak – Gjatë këtij viti kemi larguar nga rruga mbi 300 qenë endacak të cilët janë dërguar për trajtim në strehimoren AMIKA në Verbicë të Zhegocit. Kjo është sfida kryesore e Drejtorisë, ngase trajtimi nga komunat fqinje mungon dhe qentë lëvizin nga një komunë në tjetrën. Po presim që me vendimin e ri të Qeverisë riorganizimi të bëhet në qendra regjionale, ku klinikat veterinare të licencuara përkujdesen për shtimin e kontrolluar të qenve.

Darka e Lamës – Festa tradicionale e faleminderimeve këtë vit është shënuar me datën 27.11.2017, në vigjilje të festës së Flamurit dhe musafir të shumtë kanë shijuar bereqetet e këtij viti.

Inagurimi i fermës së dhive në Bresalc – Në komunën e Gjilanit operojnë 396 ferma të lopëve qumështore, 130 ferma të gjedheve për mish, 44 ferma të deleve dhe me datën 15.12.2017 është inaguruar edhe ferma e 12 dhive në fshatin Bresalc.

Kjo fermë ka kapacitete prej 160 korrësive, me sistem të mbyllur të mjeljes dhe me standarde evropiane.

Mekanizmi bujqësor – edhe pse janë kryer të gjitha procedurat, operatori ekonomik nuk ka arritur të sigurojë këto paisje (për shkak të sasisë) dhe detyrohemi që këtë projekt ta realizojmë gjatë muajit janar.

Sektor i Pylltarisë

Në këtë sektor veprojmë me kompetenca të kufizuara dhe fokusi ynë kryesor është ndalja e prerjeve ilegale të pyjeve. Po bashkëpunojmë ngushtë me Drejtorin e Sigurisë dhe Emergjencave, Policinë e Kosovës dhe Gjykatën komunale, me qëllim të parandalimit të zjarreve dhe prerësve ilegal.

Gjatë kësaj periudhe janë ngritur 537 fletëparaqitje, prej të cilave për kundërvajtje janë 361 fletëparaqitje, transport 58 fletëparaqitje, penale 118 fletëparaqitje, dhe kemi pasur 49 konfiskime në sasi prej 88.72 m³.

Në bazë të planifikimeve vjetore të shfrytëzimit – prerjes së masës së druve për vitin 2017 nga ana e Agjencionit Pyjor të Kosovës, kemi publikuar tenderin për prerjen e masës së druve në zonën kadastrale Zhegoc, ngastra nr.34 në vëllim prej 1.667 m³ masë drusore, e realizuar 1603.80 m³ dhe brezi i sigurisë kundër zjarrit, në zonën kadastrale Ponesh, nr.7 me vëllim të masës drusore 88 m³, e realizuar 72 m³.

Edhe këtë vit në bashkëpunim me agjencionin e pyjeve janë mbjellë mbi 20 ha me pishë.

Spektori i Inspektionit për Bujqësi dhe Veterinari

Janë bërë Inspektime të vazhdueshme të subjekteve afariste si: Thertoret, mishtoret, qumështoret, marketet, restorantet, qebaptoret etj. Gjatë kësaj periudhe kohore nga taksa për therje janë grumbulluar 3845 € dhe janë kryer këto vizita inspektuese:

Lloji i kontrollit	Numri
Kontrollime	270
Procesverbale	123
Therje të kafshëve	769
Transport të kafshëve të gjalla	128
Përgjigje kërkesave të qytetarëve	6
Asistencë – pjesëmarrje me Inspektionin e AUV	67
Pëlqime sanitare	38

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë Vitit **2017** në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete tjera si në vijim:

1. Janë pranuar : 6547 lëndë- kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, hipoteka, masa të përkohshme, barra tatimore, oferta, vlerësime, kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat etj.

-Në Vitin 2016 janë pranuar gjithsej 6903 kërkesa të ndryshme çka krahasuar me këtë vit, numri i kërkesave të pranuar është më i vogël prej 356 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – 31 Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Kërkesa të pranuar në DGJKP	6903 kërkesa	6547 kërkesa

2. Janë kryer: 6500 lëndë.

-Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë kryer gjithsej 6455 kërkesa të ndryshme çka krahasuar me këtë vit, numri i kërkesave të kryera është më i madh për 45 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – 31 Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Kërkesa të kryera në DGJKP	6455 kërkesa	6500 kërkesa

3. Në procedurë janë : 47 lëndë.

-Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak në procedurë ishin gjithsej 448 kërkesa të ndryshme çka krahasuar me këtë vit, numri i kërkesave të cilat janë në procedurë është më i vogël për 401 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – 31 Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Kërkesa në procedurë në DGJKP	448 kërkesa	47 kërkesa

4. Vendimet në pritje për azhurnim janë: 69 lëndë.

-Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak në pritje për azhurnim tekstual ishin gjithsej 300 kërkesa të ndryshme çka krahasuar me këtë vit, numri i kërkesave të cilat janë në pritje për azhurnim tekstual është më i vogël për 231 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – 31 Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Kërkesa në pritje për azhurnim tekstual	300 kërkesa	69 kërkesa

Përveç kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare :

- Janë lëshuar : **14056** Certifikata të pronësisë.

Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë lëshuar 12122 certifikata të pronësisë çka krahasuar me këtë vit, numri i certifikatave të lëshuara është më i madh për 1934 sosh.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Certifikata të pronës	12122	14056

- Janë lëshuar: 2104 Certifikata të gjendjes ekonomike. Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë lëshuar 2289 certifikata të gjendjes ekonomike çka krahasuar me këtë vit, numri i certifikatave të gjendjes ekonomike të lëshuara është më i vogël për 185 sosh.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Certifikata te gjendjes ekonomike	2289	2104

- Janë lëshuar: 2131 kopje të planit. Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë lëshuar 2495 kopje të planit çka krahasuar me këtë vit, numri i kopjeve të planit të lëshuara është më i vogël për 364 sosh.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar – Dhjetor 2016	Janar – 15 Dhjetor 2017
1.	Kopje të planit	2495	2131

Përpos aktiviteteve të paraqitura si më lartë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer edhe punë tjera të përditshme dhe periodike sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesave të subjekteve të ndryshme, komunale, të nivelit qendror etj. Janë kryer këto punë dhe aktivitete :

- Përcaktimi i kufijve të rrugës për trotuarin në fsh.Zhegër
- Vendimet Përfundimtare për Shpronësim shkollë fillore dhe çerdhe të fëmijëve sipas PRRU “Dheu i Bardh-1” . Vlera e pronave të shpronësuara : **861,830.00 €**
- Kërkesa për Vlerësimin e pronave për shpronësim sipas PRRU “ Qarku-1”. Vendimi Përfundimtar për Shpronësim, rruga sipas PRRU “Qarku-1”. Vlera e pronave të shpronësuara: **148,438.50 €.**
- Vendimet përfundimtare për shpronësim 29 Vendime me sipërfaqe prej 6 ha – projekti “PARKU” sipas PRRU “ Livadhet e Arapit”. Vlera e pronave të shpronësuara : **6,062,151.00 €**
- Vendimet Preliminare për Shpronësim – Projekti “ Rrugët “ sipas PRRU “ Livadhet e Arapit”. Me këtë vendim janë përfshirë **823** ngastra kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej **21.61.93 ha** , pritet vlerësimi i tyre.
- Vendimet preliminare për shpronësim – projekti “ Rrugët” sipas PRRU “ Glama-1” , pritet vlerësimi i tyre.
- Gjatë vitit 2017 në emër të kompensimit të pronave të shpronësuara janë paguar **500,000.00 €.**
- Regjistrimi i pronës të shpronësuar për pikën kufitare ne Stanqiçë (Kërkesa e Qeverisë së Kosovës)
- Dorëzimi i 33 dosjeve të vitit 1974, në Ministrinë e Infrastrukturës për nevoja të shpronësimit të pronave Rruga Gjilan - Prishtinë (zgjerimi me 4 korsi, ZK Koretishtë).
- Furnizimi me Certifikata të pronave dhe të dhënave grafike Ministrisë së Infrastrukturës për nevoja të Autostradës Prishtinë – Gjilan, për ZK Zhegovc, ZK Ponesh, ZK Bresalc, ZK Gjilan, ZK Përlepnice dhe ZK Kmetoc.
- Formimi i ekipit profesional prej 3 zyrtarëve nga DGJKP-ja për ofrimin e ndihmës profesionale Komunës së Novobërdës lidhur me azhurnimin dhe regjistrimin e pronave të shpronësuar sipas Elaboratit të vitit 1974 për nevoja të rrugës magjistrale Gjilan-Prishtinë.
- Gjatë vitit 2017 janë identifikuar 12 raste të uzurpimeve të pronës komunale për të cilat janë nxjerrë edhe Vendimet për lirimin e pronave të uzurpuara. Në procedurë të identifikimit janë edhe 10 raste tjera për të cilat ekzistojnë bazat e dyshimit për uzurpim.

Është me rëndësi të theksohet se në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës, gjatë muajit Qershor-Korrik 2017, është realizuar Projekti “ Skanimi Masiv”, skanimi dhe digjitalizimi i materialit arkivor kadastral nga viti 1999 e deri në vitin 2013, në të cilin projekt kanë qenë të angazhuar 12 persona – skanues, për të cilin projekt Komuna e Gjilanit nuk ka shpenzuar kurrfarë mjete financiare. Lidhur me këtë DGJKP-ja ka bërë kërkesë edhe për digjitalizimin e materialit arkivor kadastral të matjeve të para gjeodezike nga viti 1955 e deri në vitin 1974, material ky të cilin e disponon drejtoria në arkivat e veta.

Për fund, vlen të theksohet se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë dhe zyrat tjera komunale, me institucionet dhe agjencitë qeveritare: MAPL-në, Ministrinë e Financave, Agjencionin Kadastral të Kosovës, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencionin Kosovar të Pronave, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Arkivin ndërkomunal, Gjykatat e rangut të ndryshëm, etj. si dhe me Organizatat Ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë: OSCE, USAID, KFOR etj.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe raportuese, ka zhvilluar aktivitete në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat i referohen fushë veprimtarisë të kësaj drejtorie.

Aktivitetet e drejtorisë janë kohezive dhe vazhdojnë sipas intensitetit që përcaktohen nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar aktivitete, të cilat i përkasin fushë-veprimtarisë të DMSH-së, e ku përfshihen veprimtaritë të cilat në radhë të parë synojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në drejtorinë tonë që kanë të bëjnë me aftësimin e zyrtarëve të DMSH-ës, SHZSH si dhe Inspektoratit të Preventivës duke u bazuar në planin e aftësimit profesional të përpiluar nga AME (Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave),

Natyra e veprimtarisë së DMSH-ës është e tillë që imponon koordinim me subjektet të tjera publike të cilat zhvillojnë aktivitet në komunën tonë duke përfshirë drejtoritë komunale, Policinë e Kosovës, FSK-në Hidromoravën, etj. Natyrisht, në kemi një bashkëpunim të mirë me këto institucione të cilat pa hezitim i përgjigjen kërkesave tona sa herë është e nevojshme.

Në vazhdim po paraqesim disa nga aktivitetet tona të cilat përbëjnë thelbin e veprimtarive gjatë kësaj periudhe raportuese:

Bashkëpunimi me Drejtorinë për Shërbime Publike karakterizohet në aksione të përbashkëta në përballje me fatkeqësitë që goditën komunën tonë nga reshjet e borës, ku janë koordinuar aktiviteti për pastrimin e rrugëve në zonat e thella të Malësisë së Zhegocit si dhe të Malësisë së Karadakut. Me këtë drejtori është koordinuar aktiviteti në intervenime të përbashkëta në ndihmë qytetarëve për të shmangur izolimin e tyre nga sasia e borës e cila ka vështirësuar qarkullimin.

Vlen të përmendet se nga ky angazhim është bërë e mundur që të gjitha rrugët e fshatrave të komunës tonë të pastrohen nga bora dhe të jenë të kalueshme.

Gjithashtu pjesë e punëve dhe aktiviteteve tona të përditshme në këtë periudhë raportuese kanë qenë edhe këto aktivitete:

1. Angazhimi në identifikimin e familjeve në nevojë për banim social;
2. Gjithashtu ne si drejtori, në vazhdimësi vlerësojmë mundësitë e rreziqeve nga faktorët e tjerë, nga ku popullata e komunës tonë dhe prona mund të rrezikohen në mënyrë masive;
3. Kemi bërë vlerësimin për gjendjen e sigurisë fizike të objekteve të komunës dhe propozimin për kapacitetet e nevojshme të ruajtjes;

4. Nga buxheti i komunës, njësia SHZSH është pajisur me mjete për intervenim në aksidente të komunikacionit. Ky furnizim si dhe furnizimi me uniforma për SHZSH, rumbullakosën në mënyrë të kënaqshme nevojat teknike të shërbimit për efikasitet në punë.
5. Janë identifikuar objektet e braktisura nëpër lagjet e qytetit që paraqesin rrezik për qytetarët dhe pronën e tyre.
6. Nga inspektorët janë bërë të gjitha inspektimet për shkollat dhe objektet publike, me këtë rast janë rekomanduar për marrjen e masave për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera.
7. Në preventivën kundër përhapjes së zjarreve fushore dhe malore, janë shpërndarë poster dhe është bërë fushatë mediatike;
8. Në kuadër të bashkëpunimit me Asgjësinë e Pyjeve dhe Drejtorinë për Bujqësi, është koordinuar aktiviteti i integritetit të punëtoreve sezonal në kuadër të SHZSH-së, të citët nga 15.07 deri me 15.10.2017 janë angazhuar si përforsim gjatë intervenimeve në zjarret fushore dhe malore.
9. Në kuadër të masave për parandalimin e zjarreve fushore dhe malor nga DMSH është zhvilluar inspektim dhe vëzhgim permanent i territorit të cënueshëm nga kjo dukuri
10. Gjatë periudhës së korre-shirjeve në kuadër të komisionit të formuar nga kryetari i komunës është përfshirë edhe zyrtari përkatës nga DMSH, përmes të cilit është koordinuar aktiviteti për parandalimin e zjarreve gjatë kësaj fushate.
11. Gjatë reshjeve të muajit dhjetorë që përfshinë pjesën më të madhe të vendeve të Gadishullit Ballkanik, e të cilat shkaktuan vërshime masive, në komunën tonë kjo dukuri kaloi pa shkaktuar dalje të lumenjve dhe përronjëve nga shtrati. Gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur kjo dukuri, në përputhje me udhëzimet e kryetarit të komunës Lutfi Hazirit për ngritje të gatishmërisë, DMSH ka qenë e mobilizuar për të përballuar dhe menaxhuar çdo fatkeqësi eventuale.

Aktiviteti dhe disiplina në këtë drejtori është në rritje dhe përgjegjësia e kryerjes së detyrave është gjithnjë më e mirë.

Si pjesë e këtij raporti janë edhe raporti i SHZSH-së dhe sektorit të preventivës ku pasqyrohen aktivitetet konkrete në dhënien e shërbimeve me qëllim të ruajtjes së jetës dhe pronës së qytetarëve sidomos gjatë vërshimeve që goditën komunën tonë.

Në kuadër të këtij partneriteti me UNDP kemi bërë dhe rishikimin e Planit Operativ Emergjent në tremujorin e dytë të këtij viti, i cili plan me plotësimet e rishikimit ka kaluar Komitetin për Shërbime Publike, Banim dhe Mbrojtje dhe Shpëtim dhe pritët që të miratohet edhe në Kuvend.

Pasqyrimi tabelor i aktiviteteve të SHZSH-së

	Lloji Intervenimeve	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Gjithsej
1	Zjarre	30	34	81	45	20	10	73	185	115	25	18		643
2	Intervenime teknike	4	2	2	9	4	4	8	5	8	4	5		61

3	Shërbimet	1	1	/	1	/	/	4	/	/	1	1		12
4	Lajm. i rrejshëm	1	1	2	2	/	/	1	7	3	/	/		18
5	Vërshime	/	/	/	/	/	2	/	/	/	/	/		2
6	Eksplodime /Gatishmëri	/	/	/	/	/	/	/	/	/	1	1		0
7	Ushtrime	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/		0
	Gjithsej	36	38	85	57	44	14	86	197	130	31	25		743

Pasqyrimi tabelor i aktiviteteve të inspektorëve të preventivës

Në periudhën raportuese janë kryer kryesisht inspektime të rregullta, të jashtëzakonshme dhe vend-shikime në vendin e ngjarjes gjatë dhe pas zjarreve të shkaktuara me ç ‘rast janë hartuar raportet mbi zjarrin dhe sipas kërkesave të palëve atyre i’u janë lëshuar edhe vërtetime mbi zjarrin, po ashtu në këtë periudhë janë shqyrtuar edhe njëzetetë (28)projekte të ndërtimit me ç ‘rast janë lëshuar edhe po aq pëlqime në dokumentacione investivo-teknike. Në vijim do ta keni pasqyrën tabelare të punëve të kryera gjatë periudhës në fjalë.

Inspektimet	Sektori i Pasurisë	Numri i objekteve të inspektuara sipas kategorisë	Nr. i masave të propozuara	Nr.i aktvendimeve të marura	Nr.i masave të urdhëruara	Nr.i pëlqimeve në dok. Investivo-teknike	Nr.i vendshiqimeve të zjarrit	Nr. i raporteve mbi zjarrin	Nr. i vërtetimeve mbi zjarrin
-------------	--------------------	---	----------------------------	-----------------------------	---------------------------	--	-------------------------------	-----------------------------	-------------------------------

Rregullta	Jashtzakon.	Shoqërore	Privat		I	II	III	IV	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë
187	22	100	145		73	75	97	34	279	789	49	158	28	5	28	4

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Përshkrim i Shkurtër i Punës / Kompetencave / Detyrave të Drejtorisë / Zyrës

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të Komunës së Gjilanit ka për qëllim të ndërmarrë aktivitete të cilat ndikojnë në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal, në kuadër të Komunës, duke pasur mision përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Prandaj, zhvillimi ekonomik lokal është edhe një prej prioriteteve të Partnerit të koalicionit dhe Kryetarit të Komunës për të përmirësuar mirëqenien e të gjithë qytetarëve që jetojnë në Komunën e Gjilanit.

Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në vete ka edhe zyrat:

- Zyra për Promovimin e Investimeve
- Zyra për Energji dhe Efiçencë
- Qendrën e Inkubatorit të Bizneseve
- Inspektorët e Tregut
- Zyra e Taksës Komunale
- Zyra për Financa
- Qendra për Përkrahjen e Bizneseve
- Info-Qendra

Në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës dhe Institucionet tjera Komunale, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik kryen këto punë:

- Hartimin e strategjisë zhvillimore lokale në përputhje me strategjinë regjionale dhe atë qendrore, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë, si në aspektin afatshkurtër edhe në afatgjatë.
- Hartimin e politikave zhvillimore dhe marrjen e masave të përshtatshme për të nxitur më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës.
- Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme me qëllim të realizimit të projekteve komunale.
- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare.
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorëve të veçantë.
- Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave për bizneset lidhur me mundësitë për të investuar kapitalin e tyre në veprimtarit prodhuese dhe ku janë mundësit më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve të tyre.
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve.
- Hartimin e planit komunal për energji dhe efikasitet (PKEE) dhe përshtatja me nivelin lokal në përputhje me politikat kombëtare AKEE si dhe direktivat e BE-së.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat.
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe resorëve tjerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth mundësive dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal.
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal.
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset e Komunës lidhur me përmirësimin e kushteve për biznes përmes mbështetjes së njëra tjetrës.
- Koordinimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projekteve – bashkëfinancimi i projekteve nga Donatorët, Qeveria dhe Komuniteti - Zotimet ndaj marrëveshjeve.
- Përcjellja dhe zbatimi i politikave dhe programeve zhvillimore, planeve vjetore dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe regjional - duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkufitarë.
- Organizimin e konferencave të ndryshme për mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Komunës dhe regjionit.
- Organizimin e panairove për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve.
- Komunikimin e vazhdueshëm me diasporën që të jenë të informuar lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët e mundshëm.

- Promovimin e turizmit në aspektin ekonomik lokal dhe
- Fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me diasporën (Mërgatën) dhe promovimin e bizneseve nga diaspora dhe mundësitë e investimeve në komunë për bizneset e diasporës.

AKTIVITETET E REALIZUARA PËR VITIN 2017

Gjatë vitit 2017 Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik e kanë karakterizuar hartimi i dy dokumenteve bazike të cilat përcaktojnë zhvillimin ekonomik të Komunës së Gjilanit: Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal 2017-2021 dhe Hartimi i Strategjisë për Gratë Ndërmarrëse 2017-2021.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë vitit 2017 ka vazhduar me aktivitete të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, duke përkrahur biznese të vogla e të mesme duke i këshilluar dhe duke i informuar për mundësitë e aplikimit për grante.

- **Strategjia për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal 2017-2021** – strategjia e Zhvillimit Socio Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit do të jetë një udhërrëfyes për 5 vitet e ardhshme duke planifikuar objektiva të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin socio-ekonomik në përgjithësi. Prioritetet e Strategjisë për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal (SZHSEL) të Komunës së Gjilanit janë në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH) që është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj strategjie janë paraparë gjithsej 90 projekte që të realizohen për 5 vitet e ardhshme.
 - Është krijuar rrjeti i grave joformale që kanë për qëllim avokimin për problemet e grave në biznes.
 - Trajnimi i grave nga KCBS, ku janë realizuar dy trajnime dhe kanë përfituar rreth 100 gra duke marrë njohuri të reja.
- **Strategjia për gratë ndërmarrëse** - strategjia për Gratë Ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për Periudhën 2017–2021 është produkt i projektit “Fuqizimi Socio-Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqërisë Kosovare” në kuadër të programit “Skemat e Granteve për OJQ-të me bazë në komunitet”, i financuar nga Zyra Bashkimit Evropian, mbikëqyrur nga Fondacioni për Shoqëri Civile – KCSF dhe implementuar nga Kosovo Center for Bussiness Support – KCBS. Strategjia e zhvillimit të ndërmarrësisë së grave ka për qëllim krijimin e kushteve dhe ambientit të përshtatshëm për hapjen e bizneseve të reja dhe rritjen e zhvillimin e atyre ekzistuese, që gjithsesi do të kontribuonte në zvogëlimin e papunësisë në këtë komunë. Kjo strategji është aprovuar me datë 29.06.2017 nga KK Gjilan.

- **NPL “TREGU”** – pas aprovimit me vendim nga Qeveria e Kosovës dhe zhvillimi i të gjitha procedurave konform ligjeve në fuqi për krijimin e ndërmarrjeve të reja lokale publike, kemi arritur që këtë kompani ta funksionalizojmë fillimisht me emërimin e Komisionit të Aksionarëve nga ana e Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës, dhe më pas edhe emërimin e Bordit të përkohshëm dhe regjistrimit të kompanisë në ARBK.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka filluar me monitorimin e programit të Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V, projekti që është financuar nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, Komuna e Gjilanit. Projekti ofron "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë". Nëpërmjet këtij projekti, janë shpërndarë 47 grande, (për Komunën e Gjilanit) duke ofruar pajisje në mënyrë që përfituesit të mund të fillojnë apo rrisin biznesin e tyre. Vlera totale mesatare e një grandi, për një përfitues, do të jetë 2,000.00 €, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 15%. Krahas pajisjeve, përfituesve tani do t'u ofrohen edhe trajnime profesionale dhe mbështetje teknike.
- **Inkubatori i biznesit** tani është rinovuar dhe po krijohen kushte më të mira për aktivitet të cilat lidhen me nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve të vogla. Në kuadër të organizatës “Gilan” janë duke u organizuar kurse për rrobaqepëse, ku pas përfundimit do të jenë të afta për tregun e punës në industrinë e tekstilit apo të krijojnë biznese të vogla me veprimtari të artizanateve në mënyrë që të vetëpunësohen. Vlen të përmendet që janë trajnuar rreth 150 gra.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - është duke bashkëpunuar ngushtë me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, për fazën e dytë të Pilot Projekti “Gjilani Riciklon” ku përfshihet trajnimi i mbeturinave në shkollat fillore, bizneset dhe administratën publike.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik - është duke koordinuar aktivitet edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, e cila po implementon projektin “Promovimi dhe konkurrentshmëria e sektorit privat në zonat rurale - COSiRA” të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik –BMZ, në këtë projekt është i përfshirë regjioni Anamoravës dhe AnaDrini. Projekti i GIZ - COSiRA gjatë muajit maj - qershor ka angazhuar dy OJQ lokale të cilat do të implementojnë një pjesë të aktiviteteve të promovimit-marketingut të produkteve bujqësore:
 - a) Grupi Lokal i Veprimit (GLV) në Viti – do të bëjë promovimin e produkteve lokale dhe kualitetin e tyre si dhe

b) Në Gjilan do të krijohet Tregu i prodhuesve vendorë për produktet e Anamoravës në qendër të qytetit ku prodhuesit do të ofrojnë produktet e tyre të freskëta..

- **Soft Loan Project** - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në sajë të bashkëpunimit ka fuqizuar marrëdhëniet me Ministrinë e Financave të Kosovës dhe Ministrinë e Financave të Austrisë, për realizimin e programin (Soft Loan Project) i cili program i dedikohet projekteve madhore që përfshin infrastrukturën publike me fokus të veçanët rrjete të kanalizimit dhe trajtim të ujërave të zeza. Programi i kredisë së butë “Soft Loan” të Qeverisë Austriake është thelbësor për qytetin në përgjithësi dhe shpëtim nga se qytetarët prej vitesh përballen me problem të shumta që vjen nga këta lumenj dhe nga problemet me ujërat e zeza.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – ka pas një bashkëpunim të mirë dhe ka koordinuar aktivitetet e saja edhe me Komitetin për Zhvillim Ekonomik, si dhe partitë politike ku të gjitha kërkesat e adresuara nga partitë politike kanë marrë përgjigjen në kohë të caktuar.
- Po ashtu kemi pas një bashkëpunim edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Departamentin Turizmit me temën kapacitete humane në Regjionin e Gjilanit, pasi turizmi rural shihet si një e ardhur e mirë e zhvillimit ekonomik lokal.
- Panairi i makinave “**Auto Show**”- ky panair tashmë tradicional në komunën tonë, është shndërruar në një vendtakim për adhuruesit e makinave, sidomos ata që vijnë nga mërgata. Edhe vitin 2017 organizimi i tij ka qenë i shkëlqyeshëm, ku janë parë makina unike, me ç’rast pjesëmarrësit janë ndarë shumë të kënaqur.
- Panairi “**Ditët e Diasporës**”- në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, kemi organizuar panairin gjatë muajit Korrik me synim promovimin dhe mbështetjen e bizneseve prodhuese dhe artizanateve në Komunën e Gjilanit, ku ka pasur një numër të konsiderueshëm të vizitorëve.
Bizneset pjesëmarrëse janë ndarë mjaftë të kënaqur me organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij panairi, i cili për çdo vit po dëshmohej si i qëlluar.

QENDRA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE

Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjilan gjatë periudhës janar – dhjetor 2017 ka kryer aktivitetet e saja (tabela 1) sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të biznesit.

Bazuar në të dhënat nga Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) kemi pasur një rënie nga viti i kaluar për 87 biznese më pak të regjistruara.

Tabela:1

Nr	Aktivitetet	Numri
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	497
2	Ndryshime në biznes (Certifikatë të biznesit)	357
3	Shuarje të biznesit	72
4	Certifikata të reja (ndërrime nga certifikata e UNMIKut)	66
5	Informata	212
6	Vërtetime për mos posedim të biznesit	6
7	Punëtor të deklaruar në regjistrimin e bizneseve të reja	795
8	Bizneset e regjistruara femra	75

Tabela1. Tabela e aktiviteteve nga qendra e regjistrimit të bizneseve

QENDRA PËR PËRKRAHJEN E BIZNESEVE DHE INFO-QENDRA

Qendra për përkrahjen e bizneseve gjatë vitit 2017 ka marrë pjesë në takime të ndryshme me fokus përkrahjen e bizneseve, sfidat e të bërit biznes dhe problemet me punësimin, veçanërisht të rinisë.

- Pjesëmarrja në tryezën diskutuese në lidhje me temën – “Projekt Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, të organizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) në Hotel “Kristal” Gjilan.
- Pjesëmarrja në Sesionin informues me temën – “Fuqizimi i Institucioneve të Kosovës në Menaxhimin efektiv të Migrimit”, të organizuar nga GIZ, të mbajtur në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan.
- Pjesëmarrja në tryezën e rumbullakët të organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me temën – “Koordinimi i Projekteve në fushën e Turizmit” të mbajtur në Hotel “Sirius” Prishtinë.

- Asistimi i Drejtorisë së Bujqësisë rreth përgatitjeve të Darkës së Lamës e cila organizohet nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe është mbajtur në Hotel “Kristal” Gjilan.
- Pjesëmarrja në tryezën diskutuese “Strategjia për gratë ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit” për periudhën 2017-2021 të mbajtur në Restorantin Bujana.
- Zyra e Info-Qendrës e formuar në pjesën e dytë të vitit, kryesisht është marrë me procesin e identifikimit dhe gjetjes së pikave kyç e turistike në komunën tonë, me ç ‘rast edhe është përpiluar një raport ku specifikohen këto të gjetura.

ZYRA PËR TAKSA KOMUNALE

Së bashku me analistët e bizneseve janë koordinuar punët që kanë të bëjnë me taksa ndaj bizneseve, me të cilët janë mbajtur edhe takime sipas nevojës. Analistët e bizneseve kanë hartuar gjithsej 168 procesverbale për biznese, të cilat janë ngarkuar sipas rregullores për taksa të vitit 2017.

Janë hartuar 156 vendime ndaj bizneseve të cilat duhet të ngarkohen me taksë komunale për vitin 2017, ku vlera e përgjithshme është 82,770€.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2017 nga taksa komunale e bizneseve 140,000.00€, ndërsa janë realizuar 34,47% apo 48,267.37€.

Sipas ligjit për faljen e borxheve Nr.05/L-043, gjatë vitit 2017 ndaj bizneseve janë falur 8,299.11€.

INSPEKSIONI I TREGUT

Raporti 01.01.2017-20.12.2017

Kontrollime	480
Procesverbale të hartuara	410
Kërkesa të qytetarëve	22
Ndalim i përkohshëm i aktivitetit	2
Aktvendime	119

Pranime teknike	119
Mjete të grumbulluara nga kërkesat e qytetarëve për t'u pajisur me vendim për pranim teknik	10130€
Asistim Policisë së Kosovës	10

Gjatë vitit 2017 kryesisht jemi fokusuar gjatë aktivitetit zyrtarë në identifikimin e bizneseve të reja, të pa pajisura me certifikatë mbi regjistrimin e biznesit.

Njëherësh palët janë udhëzuar që të njëjtat të futen në regjistrin e bizneseve përmes QRB-së, duke u dhënë afat të caktuar për regjistrim, kryesisht 8 ditë, pastaj jemi fokusuar në subjekte të cilat nuk janë të pajisura me aktvendim nga DZHE, ku kemi bërë edhe grumbullimin e mjeteve të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e komunës.

Përveç këtyre aktiviteteve kemi punuar edhe me operatorët tregtarë në lidhje me pajisjen e artikujve me deklaracionin e prodhuesve në gjuhë zyrtare të vendit tonë, gjithashtu është bërë edhe identifikimi i artikujve ushqimor rreth skadimit së tyre që produktet të jenë brenda afatit për konsumim të qytetarëve për shkak të temperaturave të ngritura.

Në vazhdimësi kemi punuar edhe për mbrojtjen e konsumatorëve ku kemi pasur ankesa të qytetarëve rreth çmimeve të cilat nuk përputhen me çmimet në raft me arkën fiskale, ku nuk guxon të lejohet kurrfarë ndryshimi nga çmimi që paguhet në arkën fiskale.

Gjithashtu jemi përgjigjur çdo ankesë apo kërkesë të qytetarëve të cilët kanë hasur në probleme me subjekte, ku për secilin rast kemi hartuar edhe procesverbale, dhe kemi bërë përgjigjen përmes vijës zyrtare.

EFIÇIENCA E ENERGJISË DHE KfW-ja

Marrëveshja e financimit ndërmjet KfW-së, Frankfurt am Main ("KfW") dhe Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave ("Marrësi") për 2,500,000.00 € për programin:

"Masat për efikasitet energjetik në ndërtesat publike në nivel komunal, Kosovë". Fondi Rajonal për energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë: (BMZ 2007 65 941 / 2007 70 222). Pjesë e projekti të lartshënuar janë komunat: Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe KfW (Banka Gjermane për Zhvillim) kanë nënshkruar me 22 janar 2016 Marrëveshjen për masat e Eficiencës në Energji për nivelin Komunal. Kjo marrëveshje vije në sajë të bashkëpunimi të shkëlqyeshëm me shtetin Gjerman dhe BE-në.

Marrëveshja për këtë projekt kap vlerën prej 7.5 milion euro, ku 5 milion euro janë grant, 2.5mil nga Qeveria Gjermane dhe 2.5mil nga WBIF. Pjesa e kredisë përfshin vlerën prej 2.5 milion euro nga KfW-ja me një grejs periudhe 3 vjeçare dhe me afat amortizimi deri në vitin 2028, me këste që paguhen dy herë brenda vitit. Me këtë marrëveshje Komuna e Gjilanit përfiton mbi 1 milion euro, që do të investohen në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Gjilanit, pasi që nga ky projekt direkt do të përfitojnë institucionet më të rëndësishme, siç janë shkollat fillore dhe të mesme dhe shëndetësia primare. Projekti ka pasur ngecje procedurale por tani është në fazën përfundimtare të përzgjedhjes së një kompanie konsulente për dizajnimin e shkollave dhe realizimin e auditimeve energjetike për shkollat e përzgjedhura nga komunat në kuadër të këtij projekti, dhe shpresojmë që rezultatet të shihen së shpejti.

Projekti “Masat për Efikasitet Energjetik në Ndërtesat Publike në nivel komunal, Kosovë”. Fondi Rajonal për Energji të Ripërtërishme dhe Eficiencë të Energjisë: (BMZ 2007 65 941 / 2007 70 222). Pjesë e projekti të lartshënuar janë komunat: Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë.

Tani është në fazën përfundimtare të përzgjedhjes së një kompanie konsulente për dizajnimin e shkollave dhe realizimin e auditimeve energjetike për shkollat e përzgjedhura nga komunat në kuadër të këtij projekti.

Gjithashtu në kuadër të Eficiencës së Energjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Agjensionin për Eficiencë të Energjisë kemi identifikuar shkollën fillore “Thimi Mitko” për të implementuar disa nga masat e eficiencës së energjisë, financim nga MZHE.

Në vazhdimësinë e projekteve në kuadër të Zyrës për Eficiencë të Energjisë, vlen të ceket fillimi i projektit të mbështetur nga zyra e BE-së, për Hartimin e Planeve Komunale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, në Komunat e Republikës së Kosovës. Ky projekt është bashkëpunim i Agjesnionit Kosovar për Eficiencë të Energjisë, Zyrës së BE-së dhe GIZ-it, dhe implementohet nga GFA Consulting Group GmbH.

Zyra për Eficiencë të Energjisë, për këtë projekt ka bërë mbledhjen e të dhënave të caktuara që janë kërkuar nga përgjegjësit e projektit lidhur me: situatën e konsumit të energjisë për ndërtesat komunale në Komunën e Gjilanit, konsumin e energjisë për sektorin e ndriçimit publik, ndërmarrjet publike regjionale si dhe shpenzimet e automjeteve në pronësi të komunës. Të gjitha këto të dhëna u janë dërguar përfaqësuesve të GFA Consulting Group GmbH dhe janë në përpunim e sipër.

Qëllimi i projektit është që në vazhdimësi të monitorohet situata lidhur me shpenzimin e energjisë elektrike, duke synuar gjithmonë në zvogëlimin e këtyre shpenzimeve përmes aplikimit të masave adekuate të eficiencës së energjisë, me qëllimin primar zvogëlimin e emetimit të CO₂, krahas direktivave të BE-së për mbrojtjen e ambientit.

TREGU I GJELBËR

Themelimi i NPL “TREGU” është një e arritur tjetër ku DZHE ka kontribuar dhe ka punuar në themelimin e kësaj ndërmarrje lokale publike, duke krijuar kushte tanimë për t’i futur nën menaxhim të gjitha tregjet që operojnë në kuadër të Komunës së Gjilanit. Pas aprovimit me vendim nga Qeveria e Kosovës dhe zhvillimi i të gjitha procedurave konform ligjeve në fuqi për krijimin e ndërmarrjeve të reja lokale publike, kemi arritur që këtë kompani ta funksionalizojmë fillimisht me emërimin e Komisionit të Aksionarëve nga ana e Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës dhe më pas edhe emërimin e Bordit të Përkohshëm dhe regjistrimit të kompanisë në ARBK.

KAMPUSI I SHKOLLAVE TË MESME

Komuna e Gjilanit ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit, duke vlerësuar se lloji i investimeve përmes Partneritetit Publiko Privat, është në radhë të parë interes i qytetarëve të Gjilanit dhe i perspektivës së tyre.

Kur jemi te Partneriteti Publiko Privat tani veçse kemi implementuar projektin “**Kompleksi i Shkollave të Mesme**” dhe jemi në fazën e mbikëqyrjes së projektit, i cili po ecën shumë mirë. Me anë të këtij kampusi, Komuna e Gjilanit në partneritet me biznesin privat “**Adea Fast Food**”, kanë krijuar kushte më të mira për nxënësit, ku ka ngritje në cilësinë e arsimit dhe disiplinës, por edhe janë krijuar vende të reja të punës përmes investimeve të cilat janë kryer në këtë kompleks.

Sfidat

Sfidat kryesore të DZHE-së mbeten edhe më tutje:

- Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme me qëllim të realizimit të projekteve komunale,
- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare,
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave për bizneset lidhur me mundësitë për të investuar kapitalin e tyre në veprimtarit prodhuese dhe ku janë mundësit më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve të tyre,
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat.

Të tjera veprime dhe masa që duhet ndërmerren janë:

- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal,
- Përcjellja dhe zbatimi i politikave dhe programeve zhvillimore, planeve vjetore dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe regjional - duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkufitarë dhe ndërkomunal,
- Organizimin e konferencave të ndryshme për mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Komunës dhe regjionit,
- Organizimin e panairove për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve,
- Promovimin e turizmit në aspektin ekonomik lokal dhe
- Fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me Diasporën (Mërgatën) dhe promovimin e bizneseve nga Diaspora dhe mundësitë e investimeve në komunë për bizneset e Diasporës.

AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE

NJËSIA E KUVENDIT

RAPORT I PUNËS I NJËSISË SË KUVENDIT PËR JANAR- DHJETOR 2017

Bazuar në Planin e punës, Janar-Dhjetor 2017 janë mbajtur takimet e Kuvendit, Komiteteve dhe Komisioneve tjera të KK-së, si në tabelën në vijim:

N.ren.	Kuvendi dhe trupat punuese	Numri I takimeve	Vendimet	Rekomandimet	Kërkesat
1	Kuvendi i Komunës	9-rreg. 1-jasht. 3-sol.	75		
2	Kom. për Politikë dhe Financa	8		65	
3	Komiteti për Shëndetësi dhe MS	8		3	
4	Komiteti për Komunitete	7			
5	Komiteti për Planifikim Urban	2		5	
6	Komiteti për Shërbime Publike	4			
7	Komiteti për Arsim	9		1	

8	Kom për Pron,Kadastër,Banim	3		3	
9	Komiteti për KRS	6		2	
10	Komiteti për Zhvillim Ekonomik	3		3	
11	Komiteti për Barazi Gjinore	6		2	
11	Komiteti për Bashk. ndërkufitarë	5		1	
12	Komitetit Kons.i Eksperteve				
13	KKSB	6			
14	GPP	1			
15	Komisioni për emërimin e rrugëve	3			
16	Këshilli për vlerësimin e meritave	4			
17	Debate për Rregullore	3			
18	Debate për Buxhet	1			

Për të gjitha këto takime të mbajtura gjatë periudhës gjashtë mujore Janar-Dhjetor 2017, është bërë përgatitja profesionale dhe teknike e materialeve, lekturimi, shumëzimi dhe ekspedimi me kohë i tyre, si dhe janë përcjell dhe janë mbajtur procesverbalet dhe është ofruar ndihma në mbarëvajtjen e punës së Kuvendit, Komiteteve dhe komisioneve të tjera.

Në Zyrën e përkthimit janë përkthyer të gjitha materialet e Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera, procesverbalet e komisioneve, , Komisioneve tjera të KK-së si dhe të gjitha aktet dhe shkresat tjera të organeve komunale.

Zyrtarët ligjor dhe administrativ kanë përcjell takimet e punës të Kuvendit, komiteteve, komisioneve e takimet e tjera.

Njësia e Kuvendit edhe gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 ka mbajtur kontakte dhe bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe me organet dhe institucionet tjera të KK-së, dhe ka dërguar Raport në MAPL për aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës si dhe aktet e miratuara nga Kryetari i Komunës.

Në vijim të këtij Raporti po ju sjellim gjitha vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në periudhën Janar-Dhjetor 2017:

Nr.	Nr. i vendimit	Emri i vendimit	Dt. e mirat.	Vërejtje
1	01.Nr.1255	Vendim për shpalljen “Qytetar Nderi” të Komunës së Gjilanit, të ambasadorit William g. Walker	16.01.2017	
2	01.Nr.6302	Vendim -Raportet e punës të Komiteteve të KK-Gjilan për periudhën Janar-Dhjetor 2016	30.01.2017	
3	01.Nr.6305	Vendim-Planet e punës të Komiteteve të KK-Gjilan për vitin 2017	30.01.2017	

4	01.Nr.6309	Vendim-Raporti i suksesit në fund të gjysmë vjetorit të parë, për nivelet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	30.01.2017	
5	01.Nr.6312	Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve në NPL “Tregu	30.01.2017	
6	01.Nr.16998	Deklaratë e KK-Gjilan kundër ndalimit të z.Ramush Haradinaj nga autoritetet franceze	27.02.2017	
7	01.Nr.17005	Vendim për miratimin e Raportit të punës i Kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2016	27.02.2017	
8	01.Nr.17008	Rregullorja për Fondin e Ekselencës	27.02.2017	
9	01.Nr.17012	Rregullore për punën e arkivit dhe dokumentacionit arkivor të administratës së komunës	27.02.2017	
10	01.Nr.17017	Vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (rishikim sipas kërkesës së MMPH	27.02.2017	
11	01.Nr.17021	Vendimi për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm “Qendra” 1 në Gjilan (rishikim sipas kërkesës së MMPH)	27.02.2017	
12	01.Nr.17025	Vendim -Raporti njëvjeçar i aktivitetit të KKSB-ës për vitin 2016	27.02.2017	
13	01.Nr.17027	Vendim-Plani i punës i KKSB për vitin 2017	27.02.2017	
14	01.Nr.50/2017	Vendimi për largimin nga seanca e III të Sergjan Mitroviq	30.03.2017	
15	01.Nr.31859	Raporti financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2016	30.03.2017	
16	01.Nr.31862	Vendimi për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizimit të të hyrave vetanake të planifikuara në vitin 2016	30.03.2017	

17	01.Nr.31866	Vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara të vitit fiskal 2015 dhe 2016, në vitin fiskal 2017	30.03.2017	
18	01.Nr.31873	Vendimi për miratimin e Strategjisë për zhvillim socio ekonomik lokal 2017-202	30.03.2017	
19	01.Nr.31877	Vendim-Fjalësi i emrave të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare por edhe më gjerë	30.03.2017	
20	01.Nr.31882	Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e angazhimit të stafit teknik dhe aktiviteteve socio kulturore, komunale në Teatrin e Qytetit të Gjilanit,	30.03.2017	
21	01.Nr.43316	Vendim-Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2017	28.04.2017	
22	01.Nr.43321	Vendimi për emërtimet dhe riemërtimet e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Gjilanit	28.04.2017	
23	01.Nr.43328	Vendim-Ndarja e lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjilani (Raporti i Komisionit të DUMM)	28.04.2017	
24	01.Nr.43332	Vendim-Ndarja e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Qendrës për kujdesin ditor “Pema	28.04.2017	
25	01.Nr.43336	Vendim-Ndarja e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve	28.04.2017	
26	01.Nr.43338	Vendim-Ndarja e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës “Handikos” në Gjilan	28.04.2017	

27	01.Nr.43342	Vendim-Ndarja e mjeteve financiare për subvencionim të aktiviteteve të Qendrës për Mbrojtjen dhe rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” Gjilan	28.04.2017	
28	01.Nr.43343	Vendim për rialokimin e mjeteve financiare,	28.04.2017	
29	01.Nr.43344	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Olimpiadës së matematikanëve	28.04.2017	
30	01.Nr.43347	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Komisionit të ankesave	28.04.2017	
31	01.Nr.43352	Vendim për marrjen e iniciativës për shpalljen qytetarë Nderi të Presidentit të Shqipërisë, z.Bujar Nishani	28.04.2017	
32	01.Nr.43358	Vendim-Raporti Financiar dhe i organizimit të Manifestimit Kulturorë “Flaka e Janarit” 2017	28.04.2017	
33	01.Nr.43363	Vendim-Miratimi i projektit për financimin e Teatrit të Qytetit të Gjilanit	28.04.2017	
34		Vendim për shpalljen Qytetarë Nderi të Presidentit të Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani	12.05.2017	
35		Vendimi për rishikimin e Buxhetit 2017 të Komunës së Gjilanit	24.05.2017	
36	01.Nr.60827	Vendimi për ndarjen e titullit “Nderi Qytetit” Agim Latifi	15.06.2017	
37	01.Nr.60852	Vendimi për ndarjen e titullit “Nderi Qytetit” Muharrem Sahiti	15.06.2017	
38	01.Nr.60856	Vendimi për ndarjen e titullit “Nderi Qytetit” Flutura Ibrahim	15.06.2017	
39	01.Nr.60862	Vendimi për ndarjen e titullit “Nderi Qytetit” Ismet Haziri	15.06.2017	
40	01.Nr.64718	Vendim për miratimin e Raportit të Komisionit komunal për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane	29.06.2017	
41	01.Nr.64137	Vendim për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore-KAB 2019-2020	29.06.2017	

42	01.Nr.64724	Vendim-Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2018	29.06.2017	
43.	01.Nr.64728	Vendim-Strategjia për gratë ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për periudhën 2017-2021	29.06.2017	
44	01.Nr.64733	Vendimi për korrigjimin e vendimit 01.nr.016-39501 i datës 27.04.2016 për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të Rugës Qarkore sipas PRRU “Fidanishte”-Gjilan	29.06.2017	
45	01.Nr.64740	Vendimi për korrigjimin e vendimit 01.nr.016-117674 i datës 29.11.2016 për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të Rreth rrotullimit tek Lagja “Iliria” (projekti i rrugës “Jugu I, faza e II-të) -Gjilan	29.06.2017	
46	01.Nr.64743	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të: KF “Gjilani	29.06.2017	
47	01.Nr.64764746	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të KF “Drita”,	29.06.2017	
48	01.Nr.64748	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të KV “Drita”,	29.06.2017	
49	01.Nr.64750	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të KB “Drita” (M),	29.06.2017	
50	01.Nr.64751	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të KH “Drita” (M), në Gjilan	29.06.2017	
51	01.Nr.64756	Vendimet për subvencionimin e aktiviteteve të KH “Zhegra” në Zhegër	29.06.2017	
52	01.Nr.64758	Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës,	29.06.2017	
53	01.Nr.64761	Vendim-zgjatja e orarit të punës bizneseve të vogla dhe të mesme gjatë sezonës së verës (për një orë)	29.06.2017	
54	01.Nr.64763	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit (listës) për emërimin e rrugëve.	29.06.2017	
55	01.Nr.78725	Vendim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit	03.08.2017	

56	01.Nr.84810	Vendim-Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Qershor 2017	16.08.2017	
57	01.Nr.84813	Vendim-Raporti financiar Janar-Qershor 2017	16.08.2017	
58	01.Nr.84816	Vendimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Vitisë në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët	16.08.2017	
59	01.Nr.84821	Vendimi për autorizimin e kryetarit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndër-komunal me komunën e Vitisë në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët	16.08.2017	
60	01.Nr.84823	Vendim-Programi trevjeçar për banim 2018-2020	16.08.2017	
61	01.Nr.84829	Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin dhe vendosjen e Trafo stacionit 10(20)0.4 kv	16.08.2017	
62	01.Nr.84831	Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të; Qendrës për Fëmijët e Braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtje të nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpia për të Moshuarit” në Gjilan	16.08.2017	
63	01.Nr.84833	Vendimi për caktimin e lokacionit për nevoja të “Groposjes së kafshëve të ngordhura	16.08.2017	
64	01.Nr.84837	Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në një pjesë të parcelave kadastrale nr. 2558-0, 2561-0 dhe 2562-0, në kuadër të PZHU “Qyteti i Gjilanit”, në Gjilan	16.08.2017	
65	01.Nr.84841	Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në parcelat kadastrale nr. 2029-1, 2029-3, 2029-5, 2029-6, 2029-7, 2029-8, 2029-9, 2029-10, 2029-11, 2029-12, 2029-13, 2029-14, 2030-0 dhe 2031-0, në kuadër të PRRU “Fidanishte”, në Gjilan	16.08.2017	

66	01.Nr.84845	Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në një pjesë të parcelës kadastrale nr. 2504-1, në kuadër të PRRU “Livadhet e Arapit”, në Gjilan	16.08.2017	
67	01.Nr.84848	Vendimi për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit Komunale të Aksionarëve në NLP “Tregu” SHA Gjilan	16.08.2017	
68	01.Nr.97314	Vendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2018 dhe vlerësimet e hershme për vitin 2019-2020	18.09.2017	
69	01.Nr.97316	Vendim për miratimin e Planit zhvillimor i Arsimit i Komunës së Gjilanit 2017-2021	18.09.2017	
70	01.Nr.97319	Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në parcelat kadastrale Nr. 5206-0, në kuadër të Planit Rregullues Urban “Livadhet e Arapit”, në Gjilan	18.09.2017	
71	01.Nr.97322	Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në parcelat kadastrale Nr. 2283-0, 2285-1, 2284-3, 2275-25, 5414-0 dhe 5423-4, në kuadër të Planit Rregullues Urban “Livadhet e Arapit”, në Gjilan	18.09.2017	
72	01.Nr.97326	Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozim Planit Rregullues të Hollësishëm “Lagjja e Spitalit” në Gjilan.	18.09.2017	
73	01.Nr.97328	Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozim Planit Rregullues të Hollësishëm “Qendra 2” në Gjilan	18.09.2017	
74	01.Nr.973032	Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozim Planit	18.09.2017	

		Rregullues të Hollësishëm “Qendra 3” në Gjilan		
75	01.Nr.97334	Vendimi për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Gjilanit.	18.09.2017	

NJËSIA PËR PERSONEL

Raporti i punës përfshin përmbledhjen e aktiviteteve punuese në Njësinë e Personelit për periudhën janar – dhjetor 2017.

Njësia e personelit merret kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore të cilët janë pasuria kryesore e një organizate buxhetore.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i cili tejkalon kufijtë e njësive buxhetore dhe përbëhet nga disa komponentë edhe atë:

Planifikimi, punësimi, menaxhimi i performancës, trajnimi dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë.

Po ashtu Njësia e personelit bënë mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, kryesisht nga marrëdhënia e punës dhe procedura administrative, duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet e saj me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë përkatëse lidhur me zbatimin e përgjegjësi të Komunës të cilat rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore nga sfera e marrëdhënies së punës dhe pagave të SHC.

Andaj Njësia e personelit në kuadër të planit të saj punues këtë vit ka kryer aktivitetet punuese si në vijim:

Akt emërimi 39, Kontrata në vepër dhe kontrata tjera 368, Deklarata 3, ka shpallur 45 konkurse, hartimit i 498 vendimeve të ndryshme, 18 takime pune, 98 vërtetime të ndryshme, 119 pushime mjekësore, ka hartuar 14 raporte dhe procesverbale, janë mbajtur 5 seanca të komisioneve, ka hartuar shkresa, njoftime, përgjigje, ftesa, kërkesa të ndryshme 265, plotësimi i formularëve për MAP 149, 125 konsultime me zyrtarë dhe të tjerë, aktivitete të ndryshme 504, janë përpunuar, skenuar dhe regjistruar në SIMBNJ 305 dosje, marrëveshje për shërbime të veçanta 48, janë skenuar dhe kopjuar 764 dokumente, si dhe 565 shërbime dhe këshilla të ndryshme.

Aktivitetet shitesë:

- Mbajtja e përhershme e evidencës së punëtorëve të Komunës përmes sistemit elektronik;
- Menaxhimi me lista të pagave së Shërbyesve Civil;
- Menaxhimi me stafin në aspektin e mbajtjes së trajnimeve të ndryshme;
- Raportimi nivelit qendror; MAPL dhe MAP për numrin e punëtorëve sipas gjinisë, kualifikimit, etnitetit etj;
- Përgatitja e formularëve: për punëtorë të ri, ndryshime, të larguar, retroaktive dhe dërgimi i tyre në Ministrinë e Administratës Publike - Divizioni i pagesave, Prishtinë;

- Ofrimi i të dhënave për auditorin e brendshëm, jashtëm dhe KPMSHCK;
- Përpunimi dhe azhurimi i listës së SHCK;
- Nxjerrja e të dhënave financiare të SHCK për buxhetin 2017;
- Pjesëmarrja në hartimin e buxhetit 2018
- Bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë komunale sa i përket aspektit të nëpunësit civil;
- Përgatitja e konkurseve, publikimi i tyre dhe zhvillimi i procedurave rekrutuese konform konkurseve;
- Organizimi i punëve të Komisionit disiplinor dhe Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Komunës.
- Shpallja e konkurseve dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNJ
- Shfrytëzimi i pushimeve vjetore, mjekësore, vdekjes, lehonisë, etj. përmes SIMBNJ
- Përpunimi i dosjeve të nëpunësve civil dhe futja e dosjeve në SIMBNJ
- Pjesëmarrja në trajnime rreth SIMBNJ, monitorimit të performancës etj.

Vështirësitë të cilat na kanë përcjellë gjatë vitit 2017 e të cilat kanë ndikuar në punën e personelit, janë:

- Mungesa e aparatit fotokopjues, kur dihet se Njësitë të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit nuk kanë aparat fotokopjues.
- Mungesa e një skaneri më të përsosur
- Kompjuterët e vjetër që datojnë nga vitit 2005, e të cilët nuk e përballojnë punën në softwere të ndryshme me të cilat punon Njësia e personelit.

Andaj, Njësia e personelit duhet të pajiset me teknologji të re informative, ngase SIMBNJ është duke u zhvilluar me hapa të shpejte dhe vështirë se do ta përballojmë me këtë teknologji të cilën e posedojmë.

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Raporti pasqyron përmbledhjen e punëve të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut për periudhën **Janar- Dhjetor 2017**.

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe të cilat i trajton NJDNJ.

Si mekanizëm përgjegjës NJDNJ promovon dhe mbron të drejtat e njeriut në nivelin komunal.

Monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të Drejtat e Njeriut në këto

Fusha: Mundësi të Barabarta, Mbrojtje nga Diskriminimi, Barazi Gjinore, të Drejtat e Fëmijëve, Personat me Nevoja të Veçanta, të Drejtat e Komuniteteve, Përdorimi i Gjuhëve dhe kundër trafikim me qenie njerëzore e të tjera.

Janë monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takime të tjera të komunës.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së të mbajtur në muajin Shkurt në punëtorinë të organizuar nga OSBE për masat specifike në arritjen e Barazisë gjinore në Komunën e Gjilanit.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së në vizitat në objektet fetare më 6 mars 2017 të organizuar nga OSBE-Departamenti për të Drejtat e Njeriut ku u vizituan: Kisha Protestante – Evangjeliste, Kisha Ortodokse serbe “Sfeti Nikolla”, qendra kulturore “Don Bosko’ dhe Xhamia e Madhe në Gjilan u diskutua lidhur me fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet grave të cilat përfaqësojnë komunitetet e ndryshme fetare.

Trajnimi tre ditor i ZBGJ i mbajtur nga FAO më 28 shkurt, 9 dhe 14 mars 2017 me temë: **Vetëdijesimi & integrimi gjinorë në sektorin e pylltarisë.**

Pjesëmarrja e ZBGJ në disa takime të mbajtura nga KCBS e financuar nga zyra e Bashkimit evropian për Hartimin e Strategjisë për gratë ndërmarrëse në Komunën e Gjilanit për periudhën 2017-2021.

Njësia për të drejtat e njeriut dhe zyrtarët e tjerë komunal shënuan **“8 Marsin” -Ditën Ndërkombëtare të Gruas** ku pikërisht në këtë ditë Kryetari i Komunës pas rekomandimeve që dolën nga komiteti për Barazi Gjinore në bashkëpunim me ZBGJ dhe drejtoritë përkatëse, nxori Vendimin ku parashihen masa lehtësuese për avancimin pozitës së gruas siç parashihet edhe me LBGJ te masat e veçanta që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve të cilat masa pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat për të cilat janë krijuar.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së në trajnimin për projektin, “Të Drejtat Sociale për grupet vulnerabel/ të marginalizuara-Sori” më 12.04.2017 në Hotel “Sharri” Prevallë, pjesëmarrës anëtarët e Grupeve Punuese nga komunat: Gjilan, Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe Glllogoc/Drenas si dhe përfaqësuesit nga MAPL.

Më 15 Maj nga NJDNJ u shënuar **15 Maji Dita Ndërkombëtare e Familjes** ku u bë vendosja e Panos para teatrit të qytetit me titull: **”Barazia fillon në Familje” dhe u realizua vizita në Qendrën për rehabilitimin e Gruas dhe Fëmijës “Liria” në Gjilan.**

Sa i përket të drejtave të fëmijëve NJDNJ ka promovuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Zyrtarët e NJDNJ-së kemi marrë pjese në punëtorinë dy ditore të organizuar nga Demokracypus në kuadër të projektit Avancojmë Kosovën së bashku të USAID-it me titull “Mbështetja e grave dhe komunitetit jo-shumicë në avancimin e karrierës në sektorin publik lokal”. Punësoria dy ditore është mbajtur më 9-10 shkurt 2017 në hotelin Magra-Austria në Bogë-Rugovë. Pjesëmarrës ishin zyrtarë nga zyra evropiane, zyra për komunitete dhe kthim, NJDNJ-ja, zyra e personelit nga këto komuna: Gjilan, Shtërpçë, Klllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug dhe Graçanicë.

Për nder të **Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve “1 Qershor”** NJDNJ organizoi aktivitete të ndryshme me nxënësit e shkollave dhe çerdheve të Komunës së Gjilanit ku pjesëmarrës ishin Asambleja e Fëmijëve, fëmijët me Aftësi të Kufizuara si dhe fëmijë e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Gjilanit. Për nder të kësaj feste kemi realizuar një **Pano** me titull: **“Më shumë dashuri për Fëmijët” dhe u bë shpërndarja e maicave me moton: “Bota s’ka**

ardhmëri nëse nuk ka fëmijë” (të realizuara nga, OJQ-“Syri i Vizionit” dhe “Save the Children” gjithashtu në- sallën e Kuvendit Komunal u mbajt Konferencë për shënimin e 1 Qershorit ku u bë prezantimi i eventit punës, funksionimit dhe aktiviteteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, gjithashtu në respekt të fëmijëve me Nevoja të Veçanta u bë mbjellja e fidanes me titull: “Pema e Shpresës”.

Gjatë tërë vitit 2017 janë organizuar aktivitete nga NJDNJ me qëllim të fuqizimit të **Asamblesë së Fëmijëve**.

Sipas memorandumit të mirëkuptimit në mes të GIZ- projekti për të **Drejtat Sociale** për grupet vunerabël-SOR-i- Prishtinë dhe Komuna e Gjilanit të nënshkruar nga GIZ-znj. Brigitte Koller Keller dhe Kryetari i Komunës z.Lutfi Haziri me qëllim që të identifikoj rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë në implementimin e projektit të GIZ-it, SOR-i ku gjatë këtij viti kemi mbajtur takime të shpeshta të cilat vazhdojnë ende.

Në kuadër të këtij projekti zyrtarët e NJDNJ-së si anëtarë të grupeve punuese gjatë muajve gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor kanë realizuar 25 vizita në familje me qëllim të vetëdijesimit të tyre për të përfituar nga shërbimet sociale që i ofron komuna në bazë të dy komponentëve të riadhesimit dhe familjeve të cilat përfitojnë nga skema sociale.

GIZ-i organizoi një trajnim prej datë 15-18 Maj 2017 në **Durrës të Republikës së Shqipërisë** me grupet punuese të 5 komunave ku kishim edhe vizita shkëmbyese në Bashkinë e Elbasanit.

Pastaj gjatë këtij viti kemi pasur takime pune me **Qendrën për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria”** në Gjilan.

Takime dhe bashkëpunim me Policinë e Kosovës- **Njësia për Komunitete**, tema të ndryshme aktuale si: **“Trajtimi i fëmijëve lëmshë kërkues në Komunën e Gjilanit”, dhe fëmijët që merren me punë të rënda.**

Takime të rregullta vjetore me Asamblenë e Fëmijëve dhe OJQ-“Syri i Vizionit” nga Peja me tema të ndryshme “Aktivitetet e Asamblesë së Fëmijëve për muajt e ardhshëm”.

Zyrtarët e NJDNJ-së gjatë tërë vitit kanë realizuar vizita të herëpashershme në shkollat e mesme të ulta, çerdhe dhe institucione tjera të komunës së Gjilanit me qëllimi të bashkëpunimit të ndërsjellë institucional. Në bashkëpunim me OJQ-ne Gruaja Hyjnore kemi realizuar vizite në Kooperativën e grave fermere “Krusha” në Krushë të madhe ku morën pjesë 23 gra nga Komuna e Gjilanit. Gjithashtu janë realizuar edhe vizita në tregun e gjelbërt- fëmijëve që merren me punë të rënda dhe fëmijëve lëmshë kërkues (trajtimi i tyre).

NJDNJ-ZDF here pas here vizitohet nga nxënës të shkollave fillore dhe të mesme për t’u njohur më afër për të drejtat e fëmijëve.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së në tryezën e organizuar më 19 shtator nga DZHE-KCBS në kuadër të projektit “ Fuqizimi Ekonomik i Gruas- Avancim i Shoqërisë Kosovare” me qëllim të zbatimit praktik të strategjisë së miratuar.

Gjatë muajit tetor 2017 janë mbajtur takime me gratë e komuniteteve fetare të Komunës së Gjilanit në bashkëpunim me OSBE-ne me temë: “Ruajtja e raporteve dhe fuqizimi i tyre ndërmjet komuniteteve fetare”.

Gjithashtu gjatë muajit tetor zyrtarët e NJDNJ-së morën pjesë në trajnimet dy ditore të organizuar nga IKAP-GIZ me 7-8 tetor me temë: “Çështjet gjinore, Politikat dhe Praktikët Bashkëkohore” dhe trajnimi me 26-27 tetor i organizuar nga MAPL-GIZ me temë “ Të drejtat dhe Shërbimet Sociale në Kosovë”.

Me qëllim të implementimit të strategjisë komunale kundër dhunës në familje, Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje ka mbajtur 4 takime gjatë këtij vitit të organizuar nga zyrtarët e NJDNJ-së ku pjesëmarrës janë të gjithë akterët institucional që merren me trajtimin e dhunës në familje.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së më 2 nëntor në tryezën për shënimin e javës për të drejtat e viktimave me moton: “ Kompensimi i viktimave- e drejtë, satisfaksion dhe hap drejt rehabilitimit” organizuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së tryezën e mbajtur më 3 nëntor 2017 me temë: “Promovimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale që ofron komuna” të organizuar nga OJQ-INPO të mbështetur nga GIZ-i.

Zyrtarët e NJDNJ-së- Asambleja e Fëmijëve me 11 nëntor realizuan vizitën Bashkisë së Tiranës- kryetarit Erion Veliaj ku u njoh me më shumë detaje rreth mënyrës së funksionimit AKF-së Gjilan ku edhe përfaqësuesit e komunës së Gjilanit u njohën më shumë me punën dhe aktivitetet e asamblesë së Bashkisë të Fëmijëve-Tiranë.

NJDNJ- ZDF dhe AF shënuan 20 Nëntorin Ditën Ndërkombëtare të Konventës për të Drejtat e fëmijëve ku shënuan aktivitete në shkolla, përmes vizatimeve nxënësit paraqitën kërkesat për realizimin e të drejtave të tyre si dhe u realizua vizita e asamblistëve të fëmijëve në Parlamentin e Kosovës.

Për nder të 16 ditëve të aktivizimit kundër Dhunës ndaj grave dhe vajzave u realizuan vizita në shkolla nga zyrtarët e NJDNJ-së dhe asamblistët e fëmijëve për të pa nëse po identifikohet dhuna nga mësimdhënësit përmes nxënësve ashtu siç parashihet me procedurat standarde të veprimit.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së në shënimin e 3 dhjetorit “Dita Ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara- mundësi të barabarta” ku u organizua marshi i cili defiloj nga objekti i Hendikosit deri te Teatri i Qytetit me qëllim sensibilizimi të opinionit për njohjen sa më të drejtë të të drejtave të tyre.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së në takimin e Lobit për Barazi Gjinore të mbajtur më 24-26 nëntor në Durrës- Shqipëri, organizuar nga RRGK-ADA.

Pjesëmarrja e ZBGJ në trajnimin e organizuar nga MAPL- Helvetas më 4-6 dhjetor me temë: “ Ngritja e performancës komunale” të mbajtur në Durrës- Shqipëri.

Pjesëmarrja e zyrtareve të NJDNI-së më 29 nëntor në debatin me gratë me temë: Ngritja e vetëdijes së qytetarëve mbi të drejtën e grave në pronë dhe trashëgimi” implementuar nga OJQ-Gruaja Hyjnore, Gjilan.

Pjesëmarrja e ZBGJ në trajnimin 3 ditor të mbajtur në Ohër të Republikës së Maqedonisë, Konferencë e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje”

Pjesëmarrja e zyrtarëve dhe asamblistëve të fëmijëve më 11 dhjetor në takimin e organizuar nga Syri i Vizionit- Save dhe Children ku u bë prezantimi i raportit hulumtues “Analiza mbi mekanizmat e përdorur për identifikimin dhe raportimin e dhunës në shkollë”.

NJËSIA PËR KULTURË

1. Flaka e Janarit 2017 11-31.01.2017 Teatri i Qytetit

Gjilan Manifestimi “FLAKA E JANARIT”2017 është tradicional tashme dhe numëron edicionin e tij të 24. Objektivi i tij është që të ruajë dhe rrisë vlerat e artit të mirëfillte shqiptar. Të mbledhë artistë nga të gjitha trojet shqipfolëse dhe të begatojë bagazhin e tyre artistik.

Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri, Organizimi bëhet nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,

2. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtoje dhe shënojë njëkohësisht festën Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe të ngrisë lartë të vlerave tona shtetërore. Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri, Organizimi bëhet nga NJKRS, në bashkëpunim me komunitetin kulturor të qytetit. Shkolla e Muzikës, Kori i Fëmijëve etj.

3. Dita e Dëshmorëve 5-6.03.2017 Kodra e Dëshmorëve qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtojë dhe të respektojë veprën e të rënëve për lirinë e vendit.

Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit, Shoqata e OVL te UCK-se Organizimi bëhet nga Shoqata e OVL dhe UÇK-se nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z. Lutfi Haziri.

4. Beteja e Zhegocit 15.04.2017 Zhegoc qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtoje dhe të respektojë veprën e të rënëve të kësaj zone në Luftën për Liri. Përgjegjës

teknik të organizimit janë: Këshilli i Fshatit Zhegoc. NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit Organizimi bëhet nga Këshilli i Fshatit Zhegoc, nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z Lutfi Haziri

5. Ditët e Agimit 1-3.05.2017 Zhegër qëllimi i këtij aktiviteti të parvjetshëm është të rikujtojë veprën e jashtëzakonshme të dëshmorit Agim Ramadani në çlirimin e Kosovës.

Përgjegjës teknik të organizimit janë: Këshilli i Fshatit Zhegër. NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit Organizimi bëhet nga Këshilli i Fshatit Zhegër, nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z. Lutfi Haziri

6. LYRA FEST’ 01.06.2017 qëllimi i këtij aktiviteti është të shënojë ditën ndërkombëtare të fëmijëve. Përgjegjës teknik të organizimit janë stafi i “Lyra Fest” organizimi bëhet nga “Lyra Fest”, nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri

7. Çmimi Letrar “BEQIR MUSLIU” 11.06.2017 salla e Kuvendit qëllimi i këtij aktiviteti është të shpërblejë autorët për veprat e tyre jetësore. Përgjegjës teknik të organizimit janë: Ars Club “BEQIR MUSLIU” NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit, organizimi bëhet nga Ars Clubi ‘BEQIR MUSLIU’ nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri

8. Trekëndëshi poetik i Paqes 13.06.2017 Zhegër përgjegjës teknik të organizimit janë: Ars Club “BEQIR MUSLIU” NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit, organizimi bëhet nga Ars Clubi ‘BEQIR MUSLIU’ nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri

9. Dita e Çlirimit të Gjilanit 15.06.2017 sheshi para Teatrit qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtojë dhe shënojë njëkohësisht festën e çlirimit të qytetit nga pushtuesi, dhe të ngrisë lartë vlerat tona kombëtare. Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit organizimi bëhet nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,

10. Takim me të dalluarit e vitit 20.06.2017 salla e teatrit qëllimi i këtij aktiviteti është të promovojë të arriturat gjatë tërë vitit nga të rinjtë, artistët dhe sportistët e qytetit tonë. Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, zyra e Kryetarit L.Haziri, Organizimi bëhet nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri në bashkëpunim me të rinjtë, komunitetin artistik, sportiv të qytetit,

11. DITT E DIASPORËS 05.07.2017 sheshi para teatrit qëllimi i këtij aktiviteti është që në mënyrë sa më të mirë të mundur të urojmë qëndrim të këndshëm bashkatdhetarëve tanë, nëpërmjet aktiviteteve kulturore e sportive. Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri, organizimi bëhet nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,

12. Vjeshta Letrare 11.10.2017 salla e kuvendit Komunal aktivitet i përvitshëm i Ars Club “BEQIR MUSLIU” në bashkëpunim me dashamirë të letrave, shkrimtarë dhe poetë. Përgjegjës teknik të organizimit janë: Ars Club “BEQIR MUSLIU” NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit, Organizimi bëhet nga Ars Clubi ‘BEQIR MUSLIU’ nën koordinimin e NJKRS dhe zyrën e Kryetarit të Komunës z. Lutfi Haziri

13. Salloni Vjeshtor 20.10.2017 Muzeu i Qytetit aktiviteti i përvitshëm i organizuar nga Arian Rexhepi, në të cilin bashkohen shumë artistë nga mbarë bota me qëllim promovimin e vlerave të mëdha të artit pamor. Përgjegjës teknik të organizimit janë Shoqata e Artit Pamor NJKRS- Gjilan, zyra e Kryetarit, organizimi bëhet nga Shoqata e Artit Pamor nën koordinimin e NJKRS dhe Zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri

14. Panairi i Librit 23.10.2017 biblioteka, sheshi para teatrit objektivi dhe qëllimi i këtij manifestimi Panairit të është afirmimi i librit, bashkëpunim me biblioteka dhe botuesit më të njohur në Kosovë Shqipëri e gjetkë, pasurimi i koleksioneve të bibliotekave. Panairi do të jetë një rast i mirë për bibliotekën “Fan S. Noli” Gjilan dhe lexuesit e saj për takimin dhe promovimin krijuesve, prezantimin e veprave më të reja, si dhe blerjen e fondeve librare.

15. Festa e Flamurit 28.11.2017 salla e teatrit qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtoje dhe shënojë njëkohësisht festën tonë kombëtare të flamurit, shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe të ngrisë lartë vlerat tona kombëtare.

16. Festivali i këngës për fëmijë “DEBORA” salla e teatrit aktiviteti i përvitshëm tashmë edicioni i IV-të i organizuar nga Besart Berisha, ka për qëllim prurje të reja nga shkrimtarë, kompozitorë dhe këngëtarë të vegjël dhe avancimin e muzikës për fëmijë.

17. Ekspozita Kolektive “Salloni i Gjilanit” galeria e qytetit aktiviteti i përvitshëm i organizuar nga Shoqata e Artit Pamor, në të cilin bashkohen shumë artistë nga mbarë trojet shqiptare me qëllim të promovimit të vlerave të mëdha të artit pamor. Përgjegjës teknik të organizimit janë Shoqata e Artit Pamor NJKRS- Gjilan, zyra e Kryetarit, organizimi bëhet nga Shoqata e Artit Pamor nën koordinimin e NJKRS dhe zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri

18. Festa e fundvitit 31.12.2017 sheshi para teatrit qëllimi i këtij aktiviteti është shënimi i ndërrimit të moteve, me anë të performimit të artisteve të qytetit. Përgjegjës teknik të organizimit janë: NJKRS- Gjilan, zyra e Kryetarit L.Haziri, organizimi bëhet nën koordinimin e NJKRS dhe zyrën e Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,

19. Subvencionimi i AKV, Shoqatave dhe Artisteve të pavarur. Këto mjete financiare do të shërbejnë në zhvillimin e aktiviteteve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre.

NJËSIA PËR RINI

Përshkrimi i shkurtër i punës.

Në periudhën Janar-Dhjetor të këtij viti Njësia e Rinisë ka punuar me përkushtim të madh në intensifikimin e aktiviteteve në sektorin e rinisë. Ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha OJQ-të lokale dhe individualisht me të gjithë të interesuarit.

Na lejoni që në vazhdim, sipas kërkesës suaj të prezantojmë raportin e punës për periudhën Janar – Dhjetor 2017.

I kemi mbajtur zgjedhjet e rregullta në KVRL, ku kemi zgjedh kryesin e re në muajin Janar.

Kemi dërgua partner të rinj në trajnimin e Komisionit Evropian në Ohër të Maqedonisë, me temën: “Power of Multimedia-Bridges of Diversity”, në muajin Shkurt

Kemi organizuar debatin “Sfidat e të rinjve pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës” me datë 17 shkurt.

Kemi arritur që të nënshkruajmë marrëveshjen për punësimin e 50 të rinjve me MPMS me afat kohor prej 3 muajve, në mars

Në bashkëpunim me KVRL-në për Ditën e Gruas është organizuar dhurimi i luleve me moton: 1000 lule për gratë dhe 1001 arsye për t’u fuqizuar në vendimmarrje, me datë 8 mars.

Kemi dërgu me partner 4 të rinj në trajnimin “Development of the eLearning skills Introduction to Moodle LMS to youth practitioners” për një periudhë 9 ditore.

Kemi organizuar debatin me studentë të Universitetit të Gjilanit me panelist ministrin Arban Abrashi me temën: Sfidat në punësim dhe Ndërmarrësi në muajin mars.

Kemi nënshkruar marrëveshjet me 5 organizata rinore për të qenë bartëse të kampanjës së vullnetarizmit në Komunën e Gjilanit, në muajin prill.

Kemi dërgu me partner 5 të rinj në trajnimin “Diversiteti kulturor përmes Multimedias” në Durrës për një periudhë 9 ditore.

Kemi mbajtur 6 trajnime në shkollat e mesme me temë: Vullnetarizmi rinor në muajin maj.

Kemi qenë bartës të kampanjës “Ta pastrojmë Gjilanin” në muajin maj.

Kemi përmbyllur trajnimin me mbi 500 të rinj të shkollave të mesme, janë certifikuar të gjithë pjesëmarrësit me 25 maj.

Së bashku me KVRL-në kemi organizua aktivitetin simbolik në Ditën kundër Duhanit në muajin maj.

Në Ditën e Çlirimit të Gjilanit kemi ndarë mirënjohje për të rinjtë në 3 kategori, Vullnetar i vitit, Organizata më aktive dhe Aktiviteti më i mirë.

Në bashkëpunim me organizatën KAND kemi prezantua rregulloren komunale për Vullnetarizëm, në muajin qershor.

Në bashkëpunim me organizatën “Rinia Studentore” kemi shfaqur filmin “Fast and Furious 8” aktivitet i cili parat e grumbulluara nga biletat janë dhënë për bamirësi. Muaji qershor.

Në bashkëpunim me organizatën KDI kemi mbajtur trajnim dy ditor me temë: Punëtori për Politikën e të Rinjve” në muajin qershor.

Kemi mbajtur aktivitetin në Shtëpinë e Rinisë me temën: Muri i kujtimeve me fotografi nga aktivitetet e të rinjve nëpër kohë, në muajin qershor.

Në bashkëpunim me të rinjtë e Kryqit të Kuq kemi mbajt Mini-maratonen X-21, të dedikuar fëmijëve me Sindromin Down.

Kemi dërgu me partner 5 të rinj në festivalin Balsika që është mbajtur në Kotor të Malit të Zi në muajin qershor.

Në bashkëpunim me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal – KVRL Gjilan, kemi marrë iniciativë për pastrimin e parkut “Dardania”, duke e mirëmbajtur gjatë muajit korrik.

Njësia për Rini në bashkëpunim me vullnetarët e Kryqit të Kuq, ka organizuar “Festival të Filmit Come and See”, ku për tri ditë rresht kemi shfaqur filma me tematik kundër dukurive negative për tinejxher, në muajin korrik.

KAND në bashkëpunim me OSCE dhe Njësine për Rini ka organizuar debat me temën “Roli i Femrës në qeverisjen lokale dhe bërjen e politikave”. Muaji korrik.

Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me pjesëmarrje të Njesisë për Rini të komunës së Gjilanit, kemi organizuar konferencën regjionale me temë: “Roli i të rinjve në zhvillim lokal”. Muaji korrik

Në bashkëpunim me organizatën KAND dhe Anibar, në lagjen Dardania kemi organizuar festivalin e filmave të animuar “Anibar”. Muaji korrik

Organizimi i dëgjimit publik për buxhetin komunal për rini në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe KPF-në. Muaji gusht

Në bashkëpunim me KVRL kemi organizuar aktivitetin humanitar për grumbullimin e mjeteve për fëmijët të cilët kanë mungesë të librave dhe gjërave shkollore. Muaji gusht

Në bashkëpunim me Vullnetarët Rinor kemi realizuar projektin filmik “Mendja ime sheh”, që kishte për qëllim sensibilizimin e opinionit publik për njerëzit me nevoja të veçanta. Muaji shtator.

Në bashkëpunim me MKRS dhe GIZ kemi organizuar trajnimin për Ndërmarrësi të rinjtë, ku pas certifikimit kanë mundësi të përfitimit të grantit në vlerë 4.000 euro. Muaji tetor.

Në bashkëpunim me KVRL kemi organizuar shfaqje humanitare të filmave të cilat kishin për qëllim grumbullimin e parave për qendrën e Kujdesit Ditor të Fëmijëve “PEMA”. Muaji tetor

Në bashkëpunim me MKRS dhe në partneritet me GIZ- Gjerman, 50 të rinj do të certifikohen në programin për hartimi të Biznes-Planit dhe fushën e ndërmarrësisë.

NJËSIA PËR SPORT

Përshkrimi i shkurtër i punës.

Njësia për sport gjatë muajit janar-dhjetor 2017, ka organizuar të gjitha aktivitetet kalendarike të cilat i kemi paraparë që t'i zhvillojmë për gjatë këtyre muajve.

Përveç aktiviteteve kalendarike, njësia për sport ka menaxhuar edhe të gjitha objektet sportive si (palestra e sporteve, stadiumi i qytetit si dhe stadiumi ndihmës) si dhe është përgjegjës klubeve sportive për çfarëdo nevojë të cilat me anë të kërkesës e kanë drejtuar tek ne.

Në muajin shkurt, njësia për sport ka organizuar një turnir në futboll për nder të kupës së pavarësisë në palestrën e sporteve “Bashkim Selishta Petriti”, në mes të artistëve gjilanas si dhe veteraneve të futbollit në Gjilan.

Më datë 12 mars 2017, në bashkëpunim me Shoqatën e pedagogëve të sportit shkollorë, kemi organizuar manifestimin ndërkombëtar në Atletikë “Vrapimi i qytetit Gjilani 2017”. Këtë vit ky aktivitet që mbahet për nder të pranverës studentore të vitit 1981 kemi formuar një këshill me të gjithë profesorët e edukatës fizike të cilët u kujdesen që të gjithë nxënësit e klasave fillore dhe te mesme të jenë prezent në këtë eveniment sportiv.

Në muajin mars, nën përkujdesjen e Kryetarit z.Lutfi Haziri organizuam pritjen e kampionit të botës në kategorinë WBF Erzen Rustemi. Shumë qytetar e priten me shumë gëzim kampionin para platosë së teatrit të qytetit. Komuna e Gjilanit para një viti shpalli Erzen Rustemin nderi i qytetit të Gjilanit.

Më datë 6 dhe 7 maj, njësia për sport në bashkëpunim me klubin e basketbollit me karroca DRITA organizuam turneun ndërkombëtar memorial ‘Halit Ferizi’

Në këtë turne tashmë tradicional përveç 6 ekipeve të basketbollit në karroca të Kosovës, këtë vit ishte pjesëmarrës edhe një ekip nga Sllovenia dhe një nga Shqipëria.

Ekipet pjesëmarrëse në këtë turne të basketbollit me karroca ishin :

–	KBK	“Maribori”	–	Slloveni
–	KBK	“ADP Albania”	–	Shqipëri
–	KBK	“Drita”	–	Gjilan
–	KBK	“Prishtina”	–	Prishtinë
–	KBK	“Vëllaznimi”	–	Gjakovë
–	KBK	“Ferizaj”	–	Ferizaj
–	KBK	“Trepça”	–	Mitrovicë
–	KBK “Marsi” – Prizren			

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit z.Lutfi Haziri, organizuam turneun memorial në boks ‘Agim Rashiti’

Ky turne që u mbajt në kujtim të veprës dhe jetës së Agim Rashitit, i rënë në ballafaqim me forcat serbe të policisë, mblodhi boksier të talentuar ku u vlerësua shumë nga të gjithë.

Ndryshe, tekniku më i mirë në këtë turne është shpallur, Milovan Sekulic nga Mali i Zi, meqë me luftarak ishte ai në mes të Albin Sejdiut dhe Denis Muqajt, boksieri më me perspektiv u shpall Drilon Thaqi, kurse bokseri më i mirë i turneut Violant Sylejmani.

Më datë 3 qershor, njësia për sport në bashkëpunim me Shoqatën e të Shurdhërve në Gjilan organizojë një turnir në futboll nga gjithsej 15 ekipe pjesëmarrëse nga e gjithë Kosova. Ne si njësi u përkujdesem për të gjithë rrjedhën e këtij turniri duke siguruar medaljet, kupat si dhe referat për ndeshjet e zhvilluar.

Me qëllim të avancimit të vlerave të mirëfillta sportive, njësia për sport, duke përvijuar tashmë një traditë vjetore edhe sivjet do të shpallë sportistët dhe klubet me të suksesshme për periudhën 2016/17

Juria profesionale ishte në përbërje: Malazog Hoxha, kryesues, Arben Maliqi, Rifat Shabani, Agim Latifi, Veton Xhemajli, Selami Haziri dhe Afërdita Balaj anëtarë për përzgjedhjen e laureatëve për periudhën qershor 2016/17.

Sportisti i vitit nga Komuna e Gjilanit në kategorinë e meshkujve është shpallur Elhami Shabani, karateist dhe nga kategoria e femrave, Fortesa Orana, për të vazhduar me shpërndarjen e çmimeve Nderi i Qytetit të Gjilanit, për Muharrem Sahitin, Agim Latifin dhe Ismet Haziri.

Gjithashtu janë shpërblyer edhe shumë sportistë dhe punëtor sportiv të cilët gjatë kësaj periudhe dhanë më të mirën në klubet e tyre.

Njësia për sport më datë 24 qershor ka bërë hapjen e Murit të Kujtimeve me fotografi të klubeve të ndryshme, të lojtarëve në stadiumin ndihmës si dhe në palestrën e sporteve “Bashkim Selishta-Petriri” Gjilan.

Në këtë ngjarje prezent ishin shumë veteran të të gjitha kategorive të sportistëve ku u shprehen të kënaqur për këtë ekspozitë. Më anë të këtyre fotografive i kujtuam edhe ata që nuk janë më në mesin tonë. Gjatë ditëve në vazhdim, i kemi bërë thirrje të gjithë sportistëve të cilët posedojnë fotografi të vjetra të sportit, t’i sjellin ato në njësinë tonë në mënyrë që ta pasurojmë edhe më shumë këtë ekspozitë.

Njësia për sport më datë 30.07.2017 ka përgatitur shumë aktivitete për muajin e bashkatdhetarëve ku janë hyrë edhe në kalendarin e aktiviteteve komunale.

Aktiviteti më atraktiv i cili ngjalli shumë kureshtjen e Qytetarëve edhe nga diaspora ishte ai më Klubin “Alpin” ku vizituam malet e Karadakut që janë të pasura me bukuritë malore. Njëzëri janë pajtuar që të gjithë pjesëmarrësit se në këtë anë, potenciali i madh i turizmit është i mundur të zhvillohet, sepse, sipas të pranishmëve, këto bukuri natyrore rrallë kush i ka.

Ndryshe aktivitetet tjera të diasporës i vazhduam më 04 gusht me shumë aktivitete tjera para platos së Teatrit ku u zhvilluan garat në shah, gjimnastikë si dhe pingpong.

Më datë 10 shtator në mbështetje të Kryetarit të Komunës është mbajtur kampionati ndërkombëtar në fitnes “Men’s Classic” dhe ne bodybouldingut dhe fitnesit të Kosovës, ku pjesëmarrës ishin garues të shumtë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Në këtë kampionat Betim Krasniqi nga Gjilani është shpallur kampion absolut i Kosovës dhe kampion mbarëkombëtarë.

Njësia për sport me datë 14 shtator ka organizuar Panairin e Sportit, në të cilin me sukseset dhe vlerat e tyre janë paraqitur të gjitha klubet e Gjilanit nga disiplina të ndryshme sportive, duke përfshirë dhe klubin sportiv të personave më aftësi të kufizuara.

Besim Hasani, kryetar i komitetit Olimpik të Kosovës, ka vlerësuar lartë këtë organizim të kësaj ngjarje e cila tregon për mbështetjen e madhe që Komuna e Gjilanit jep për sportin në përgjithësi.

Ndryshe, pos tjerash, sukseset e Gjilanit shiheshin nga trofetë e shumta që kishin marrë klubet sportive në gara të ndryshme komunale, shtetërore, mbarëkombëtare dhe ndërshtetërore.

Më datë 15.10.2017 në bashkëpunim me Federatën e Automobilizmit të Kosovës si dhe klubin e Automobilizmit “Auto Klub Gjilani” kemi organizuar një garë në Auto Sallon në rrugën me katër korsi në rrugën e Bujanocit.

Pjesëmarrës në këtë garë ishin shumë garues nga qytetet e ndryshme të Kosovës ku me atraksionet e tyre ngjallën kureshtje ku shumë qytetarë përcjellën nga afër këtë garë.

Pra, ne vazhdimisht jemi duke punuar që të respektohen rregulloret për shfrytëzimin e hapësirave sportive, rritjen e gjenerimit të mjeteve, ngritja dhe intensifikimi i komunikimit me të gjitha klubet sportive të komunës si dhe rregullimin e hapësirave në këto objekte sportive.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Raporti i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon në bazë të kornizës ligjore të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kornizës profesionale të vendosur nga Ministria e Financave dhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), që mbështet vlerat kryesore të ligjshmërisë, integritetit, objektivitetit, besueshmërisë, kompetencave dhe pavarësisë.

Misioni i Auditimit të Brendshëm është që në pajtim me qëllimet e Institucioneve dhe organeve komunale:

Të shtoj vlerën për performancën e veprimeve të Komunës duke siguruar cilësi dhe duke kryer auditime dhe shërbime këshillimore me kosto të reduktuara.

Të sjellë përfitime në efikasitetin operacional, kontrole të brendshme dhe politika të përmirësuara.

Qëllimet e Auditimit të Brendshëm janë:

Të jap siguri objektive, të pavarur dhe aktivitete këshillimore, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e Institucioneve dhe Organeve Komunale.

Të asistoi të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësi të tyre me anë të vlerësimeve të pavarura, këshillimeve dhe rekomandimeve.

Te raportoi tek menaxhmenti i lartë lidhur me veprimet korrigjuese të ndërmarra nga të gjitha nivelet e menaxhimit.

Objektiva e Auditimit të Brendshëm:

Objektivi primar është të asistoi në menaxhimin e drejt të buxhetit, në zbatueshmërinë e plotë ligjore, në realizimin efektiv të përgjegjësi të tyre (personelit përgjegjës për ato veprime). Në këtë mënyrë i furnizon ata me analiza, rekomandime, këshilla dhe informacione lidhur me aktivitetet e shqyrtuara.

2. Të Arriturat:

NJAB-ja në vitin 2017 ka funksionuar me tre auditor. Brenda kësaj periudhe njëvjeçare NJAB-ja ka arritur ta realizoi Planin Vjetor plotësisht. Pra brenda kësaj periudhe ka kryer 12 auditime, aq sa edhe kanë qenë të planifikuara.

Me kërkesë të Njesisë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm dhe me aprovim të Kryetarit të Komunës, në tremujorin e dytë kemi ndryshuar temën e një auditimi, për t'i mundësuar një kandidati të kryej pjesën praktike për Certifikim Kombëtar për Auditim të Brendshëm. Pra është kryer auditimi në Shërbimin e Autoparkut (*i cili auditim ka qenë i planifikuar të kryhet në vitin 2018*), ndërsa është lënë për vitin tjetër auditimi në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Në kontest të avancimit dhe të kuptuarit e drejtë të rolit të NJAB-së janë mbajtur tri punëtori në kuadër të projektit pesë vjeçar (TEAM) me USAID-in, ku Komuna e Gjilanit është e përzgjedhur në mesin e pesë komunave të Kosovës.

3. Sfidat:

Një ndër sfidat kryesore të NJAB-së ka qenë realizimi i tërësishëm i Planit Vjetor për vitin 2017, duke i realizuar objektivat kryesore të auditimit e që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës menaxhmenteve të drejtorive komunale për ngritjen dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme në sistemet dhe proceset e tyre ku ata janë përgjegjës.

Kemi arritur që të gjitha objektivat e planifikuara për auditim t'i realizojmë plotësisht, përkundër asaj se kanë pasur një fushëveprim mjaftë të gjerë dhe kompleks. E sidomos kur i shtohet angazhimi shtesë i drejtorit të NJAB-së nga Ministria e Financave në cilësinë e Mentorit për përcjelljen e katër auditimeve të kryera nga dy kandidat, të cilët kanë qenë në proces të Certifikimit Kombëtar për auditim të brendshëm.

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të Drejtorisë së audituar i janë dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra është arritur të krijohet një bashkëpunim produktiv në mesë NJAB-së dhe menaxhmenteve komunale.

Por edhe më tutje sfida e pa realizueshme mbetet mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve të dhëna, e që mund të kenë ndikime financiare, por edhe ndikime reputative për Komunën.

Andaj kërkohet në vazhdimësi një angazhim më konkret i menaxhmenteve të drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës lidhur me implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga Auditori i Zyrës Kombëtare ashtu edhe nga Auditori i Brendshëm.

4. Punët Kryesore në vazhdim:

Në pjesën e parë të janarit 2018 do të vazhdohet me verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në të gjitha auditimet e kryera gjatë vitit 2017 (auditim ky i paraparë

sipas Planit Vjetor të NJAB-së për vitin 2017), ku të gjeturat do të paraqiten në Raportin e NJAB-së për tremujorin e IV-të (deri me 15.01.2018) dhe në Raportin Vjetor (deri me 31.01.2018).

5. Shtojca

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten auditimet e kryera brenda vitit 2017 sipas Planit Vjetor të NJAB-së dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë

Nr.	Llojet e detyrave të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara brenda periudhës 01.01.2017 – 31.12.2017	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimeve
1	Auditimi në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë</i>	Rrezik i lartë
2	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa: <i>Procesi i shpenzimeve për të gjitha drejtoritë Komunale (me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë)</i>	Rrezik i lartë
3	Auditimi në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë</i>	Rrezik i mesëm
4	Auditimi në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë</i>	Rrezik i mesëm
5	Auditimi në Shërbimin e Autoparkut: <i>Vlerësimi i zbatueshmërisë ligjore gjatë menaxhimit me automjetet e Komunës</i>	Rrezik i mesëm
6	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, gjegjësisht në Sektorin e Tatimit në Pronë: <i>Vlerësimi i bazueshmërisë ligjore të procesit për të hyrat nga tatimi në pronë.</i>	Rrezik i lartë
7	Auditimi në Njësinë për Kulturë, Rini dhe Sport: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i Njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Rrezik i mesëm
8	Auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë</i>	Rrezik i mesëm
9	Auditimi në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik: <i>Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë</i>	Rrezik i mesëm
10	Auditimi në tërë Administratën Komunale lidhur me menaxhimin e pasurisë Komunale	Rrezik i lartë
11	Auditimi në Departamentin e Prokurimit: <i>Procesi dhe Procedurat e Prokurimit</i>	Rrezik i lartë
12	Auditimi për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm dhe auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit	

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2017 – 2019, planë ky i aprovuar po ashtu nga Kryetari i Komunës dhe nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

ZYRA LIGJORE

Po ju ofrojmë raportin statistikor të punës së **Zyrës Ligjore** për (12) mujorin e vitit **2017**.
Aktivitetet: (Janar-dhjetor 2017)

Aktivitetet:	Gjithsej:
Arsyetime të akteve	1
Autorizime/letër mbështetëse/deklarata etj Procesverbale/konkluzione/pyetësor, aplikacion etj.	27
Debate/Dëgjime publike për akte	2
Hartimi, ndryshimi, plotësimi dhe pastrimi i tekstit të akteve	31
Kërkesa/përgjigje në kërkesa/njoftime/bartje të lëndëve	125
Projekt-kontratë/marrëveshje mirëkuptimi	110
Qarkore, Opinione ligjore/Konsultime/këshilla ligjore-juridike	86
Seanca e KK-së dhe KPF-së	0
Takim pune me drejtor/zyrtar brenda dhe institucioneve	23
Urdhëresa	1
Vendime/plotësime/ndryshime	201
Gjithsej aktivitete:	607

Aktivitetet me organe tjera:

Aktivitetet e kryera	Gjithsej
Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme	416
Përgjigje në padi	128
Ankesa	70
Prapësime	9
Revizione	6
Përgjigje në revizion	3
Përgjigje në ankesë	23
Kundërshtime	3
Propozim për kundër-përmbarrim	3
Parashtresa	208
Fjala përfundimtare	17
Ndërprerje e procedurës	1
Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë	3

Gjithsej aktivite:	890
Gjithsej aktivite (1+2)	1497

Detyrimet Kontingjente:

Viti	Vlera e lëndëve (kërkesave) në shkallë I	Vlera e lëndëve (kërkesave) në shkallë II	Shpenzime Procedurale (barrë e komunës)	Gjithsejtë:
2017	5,746,505.85	2,290,141.10	30,392.60	8,067,039.55

Dokumente të lekturuara: Në kuadër të zyrës ligjore janë kontrolluar **241** dokumente të ndryshme gjegjësisht **807** faqe.

Sfidat:

Sfidat për vitin 2017 si në vijim;

Numri i madh i lëndëve gjyqësore në raport me komunën.

Problem mbetet edhe më tutje zgjidhja e çështjes së shpronësimeve që kanë ndodhur para lufte dhe pas lufte. Hapja e rrugëve të ndryshme, nuk duhet të ndodh pa përfunduar shpronësimet dhe pa u bërë bartja e tyre në emër të komunës. Përpos kompensimeve për shpronësime, palët në gjykatë po kërkojnë edhe kamatën ligjore dhe kompensimet për avokatë. Të gjitha këto e rëndojnë buxhetin e komunës.

Problem i vazhdueshëm mbeten lëndët e ndryshme nga çështja e arsimit (mos pagesave e pagave për angazhimet në punë në të kaluarën, mos pagesa e pagave me rastin e pensionimit dhe kompensimet tjera etj.

Problem në vete në vazhdim paraqiten në gjykatë edhe kërkesat sa i përket kompensimeve për dëmin e pretenduar se ju është shkaktuar palëve të ndryshme kontraktuese në raport me komunën si autoritet publik, për mos zbatim të kontratave apo zbatim të pjesshëm të tyre. Në këtë çështje problem në vete mbetet menaxhimi i dobët i kontratave të lidhura.

ZYRA PËR INFORMIM PUBLIK

Zyra për Informim Publik (ZIP) ka komunikuar me qytetarët përmes formave të ndryshme në më shumë se 940 raste në periudhën janar - dhjetor 2017, edhe atë përmes komunikatave për media, ftesave për aktivitete publike, njoftime etj., të cilat janë publikuar në afat rekord dhe në mënyrë profesionale në web faqen zyrtare të Komunës dhe në faqen tjetër në rrjetin social Facebook. (mesatarisht 3.18 komunikata për media për ditë pune).

Në shkurt 2017, ZIP ka nxjerrë për botim edhe Buletinin informativ për 6-mujorin e dytë të vitit 2016, për punën e ekzekutivit dhe legjislativit, që është mjaft voluminoz me informata gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore.

Edhe kësaj radhe, Buletinin nuk e kemi nxjerrë në letër, por e kemi publikuar në version elektronik në web faqe të Komunës, për shkak të 'dietës' së vendosur nga kryetari Lutfi Haziri në shpenzime.

Përgjatë vitit 2017, Zyra për Informim Publik ka vazhduar implementimin e projektin shumë të rëndësishëm për avancimin e transparencës, "Livestream", ku seancat e Kuvendit Komunal të Gjilanit janë transmetuar drejtpërdrejt në kanalën zyrtar të Komunës në Youtube, derisa videot e plota janë publikuar në web faqe.

Ky është projekti i parë i kësaj natyre i realizuar në nivel vendi, i cili ka nisur në shkurt 2016 dhe është realizuar me një shumë simbolike.

Gjatë vitit 2017, ZIP ka organizuar edhe 41 konferenca për media, për t'i adresuar para gazetarëve çështjet që janë me rëndësi për publikun.

Edhe në aspektin e qasjes në dokumente publike, Zyra për Informim Publik ka bërë punë jashtëzakonisht të rëndësishme, ku për këtë periudhë kanë ardhur 41 kërkesa dhe të gjitha janë kthyer me kohë. Kërkesat kanë ardhur kryesisht nga ana e qytetarëve, shoqëria civile, mediat dhe partitë politike.

Zyra për Informim, po ashtu, ka bërë publikimin në web faqe të të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare, sikurse edhe vendimet, procesverbalet, njoftimet e konkurset etj., duke ndikuar kështu në avancimin e transparencës së Komunës së Gjilanit.

Gjithashtu, Zyra për Informim ka përgatitur e dizajnuar pjesën më të madhe të të gjitha llojeve të ftesave, mirënjohjeve, e çmimeve, duke vendosur brend të ri që tashmë identifikohet Komuna e Gjilanit.

Bashkëpunimi i mirë i Zyrës për Informim Publik e Komunës së Gjilanit me mediat, ka bërë që të gjitha aktivitetet e ekzekutivit dhe legjislativit të mbulohen në mënyrën më të mirë, edhe atë në portale, gazeta, televizione dhe radiot lokale e nacionale, për çka shprehim falënderim të veçantë.

E gjithë kjo punë e zyrës sonë është bërë me mbështetjen e fuqishme të kryetarit Haziri, i cili na i ka lënë duart e lira për të punuar e vepruar në mënyrë profesionale.

Objektivat

Komunikimi i përditshëm me publikun me anë të kumtesave e deklarimeve për media, vazhdimi i transmetimit të drejtpërdrejt të seancave të Kuvendit Komunal, përgatitja e konferencave për media, organizimi i takimeve me shoqërinë civile etj., janë vetëm disa nga objektivat e Zyrës për

Informim në gjashtëmujorin e parë të punës së vitit 2018, në të cilat përfshihen ekzekutivi dhe legjislativi.

Qeverisja e mirë nënkupton pjesëmarrje qytetare dhe vendimmarrje transparente. Komuna e Gjilanit, përmes Zyrës për Informim, kujdeset maksimalisht që të përmbushë këto standarde, e vetëdijshme se vendimmarrja transparente e rritë besueshmërinë e publikut te qeverisja lokale.

ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Misioni i Zyrës për integrime evropiane është që “Në bashkëpunim me instancat përkatëse lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e standardeve evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian si dhe të koordinojë të gjitha çështjet lokale të procesit të integrimit evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga BE-ja.”

Zyra për integrime evropiane gjatë këtij viti ka zhvilluar një varg aktiviteteve që dalin nga obligimet dhe përgjegjësitë e saja.

Zyra ka përcjellë punën dhe aktivitetet e Komunës;

1. Koordinimin e procesit të integrimit evropian;
2. Pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale dhe zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave nga ana e drejtorive sektoriale, me qëllim të reflektimit të obligimeve përkatëse në lidhje me integrimin evropian në kuadër të secilit sektor;
3. Monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale të Kryetari i Komunës dhe autoritetet qendrore, përmes Ministrisë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale;
4. Koordinimin dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të Komunave për të kryer më sukses të gjitha reformat e nevojshme, përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të tyre;
5. Ofrimin e mbështetjes të gjitha strukturave komunale në përmirësimin e konsultimeve dhe dialogun civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në nivelin komunal.
6. Ngritjen e vetëdijes së administratës komunale, shoqërisë civile, mediave, komunitetit të biznesit, si dhe të publikut të gjerë mbi procesin e integrimit evropian dhe promovimin e vlerave dhe standardeve evropiane.
7. Përveç obligimeve dhe përgjegjësi të parapara ZKI ka organizuar Javën e Evropës, duke organizuar debate, konferenca dhe aktivitete tjera me qëllim të informimit me strukturat dhe kriteret e BE.
9. ZKIE ka raportuar në mënyrë permanente në MAPL dhe MI.

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Raportin vjetor mbi aktivitetin e prokurimit publik në Komunën e Gjilanit për periudhën janar – dhjetor 2017.

Ky raport paraqet në mënyrë analitike të dhënat për kontratat publike, ndarjen e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdorura nga autoriteti kontraktues, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës brenda tregut publik si dhe indikator tjerë të rëndësishëm për matjen e performancës së prokurimit në Komunën e Gjilanit.

Aktivitetet e kryera gjatë periudhës janar- dhjetor 2017

Konform Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës më 21.01.2017 është dorëzuar në KRPP Raporti Vjetor për Kontratat e nënshkruara gjatë vitit fiskal 2017

Gjithashtu në muajin janar më dt. 11.01.2017 është dorëzuar në AQP Planifikimi Final i Prokurimit Publik për vitin 2017, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik i cili parasheh që brenda 15 ditëve pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal, duhet të dorëzohet me shkrim Planifikimi Final i Prokurimit në AQP.

2.1 Zhvillimi i procedurave të prokurimit

Gjatë vitit 2017 të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar bazuar në Ligjin e Planifikimin Final të Prokurimit duke respektuar hapat në vijim sipas Udhëzuesit Operativ për prokurim publik:

Pranimi i kërkesës për inicim dhe Deklaratën e Nevojave
Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i kontratës
Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit
Përgatitja e Dosjes së Tenderit
Publikimi në web faqe të KRPP
Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve
Njoftimi për Dhënie të kontratës
Nënshkrimi i Kontratës
Menaxhimi i Kontratës

2.2 Njoftimet e Publikuara

Departamenti i Prokurimit si përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të Autoritetit Kontraktues –Komunës së Gjilanit, sistematikisht është angazhuar për të procesuar të gjitha kërkesat e pranura nga Njësitë e kërkesës duke i zhvilluar aktivitetet sipas llojit dhe procedurave përkatëse të prokurimit. Edhe pse në mungesë të stafit gjatë periudhës 2017 si problemet që i kemi pasur me platformën të prokurimit elektronik. Mungesa e stafit, mungesa e trajnimeve të anëtareve të vlerësimit të ofertave, edhe pse me të gjitha këto vështirësi ne si Departament i Prokurimit kemi arritur të i realizojmë të gjitha objektivat dhe kërkesat nga njësit kërkuese.

Në periudhën janar-dhjetor 2017 janë udhëhequr 77 aktivitete të prokurimit, të cilat edhe janë publikuar në web faqe e – prokurimit si dhe të KRPP:

Procedurë e hapur 46

Konkurs projektimi 4

Ftesa për kuotim 10

Vlera minimale 13

Ankande publike 3

3. Procedurat tenderuese për këto aktivitete të prokurimit

Departamenti i Prokurimit ka filluar procedurat tenderuese, për të gjitha aktivitetet e prokurimit me pranimin e kërkesës për Inicim nga Njësia e Kërkesës, e cila është inicuese e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha aktivitetet e prokurimit për të cilat kanë filluar procedurat e tenderimit në periudhën janar-dhjetor 2017 si dhe fazat e tenderimit se deri ku kanë arritur me procedura tenderuese:

Nr. ren.	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Faza e tenderimit
1	Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet dhe fshatra GL 651 17 001 111	Kontraktuar
2	Punë publike-në infrastrukturë GL 651 17 002 521	Kontraktuar
3	Furnizim me farë misri GL 651 17 003 121	Kontraktuar
4	Furnizim me foli plastike të verdhë GL 651 17 004 121	Kontraktuar
5	Shërbime telefonisë mobile për zyrtarët Komunal GL 651 17 006 221	ANULIM
6	Furnizim me rafta metalike për nevojat të arkivit të integruar të administratës komunale GL 651 17 07 326	Kontraktuar
8	Furnizim me artikuj ushqimor për institucionet parashkollore konviktin e nxënësve dhe për nevoja të njësive tjera shpenzuese GL 651 17 08 121	Kontraktuar
9	Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Llashticë GL 651 17 09 521	Kontraktuar
10	Rregullimi i tri segmenteve të rrjetit të kanalizimit fekal për gjatë rrugës Zhegër-Lladovë, faza e dytë GL 651 17 10 521	Kontraktuar
10 a	Vazhdim i kontratës - Furnizim me artikuj ushqimor për institucionet parashkollore konviktin e nxënësve dhe për nevoja të njësive tjera shpenzuese GL 651 17 10A 326	Kontraktuar
11	Hartimi i projektit ideor për objektin tregtar “Tregu i gjelbër” në qytetin e Gjilanit- Ri tenderim GL 651 17 11 411	OSHP
12	Rregullimi i kanalizimit fekal Gjilan-Velekincë GL 651 17 12 521	Kontraktuar
13	Shërbime të transmetimit të drejtpërdrejtë në mbledhjeve të KK,	ANULIM

	<i>takimeve të bordit të drejtorive, shpalljeve si dhe emisioneve tjera sipas porosisë GL 651 17 13 236</i>	
14	<i>Rrafshimi dhe lëvrimi i thellë 50 ari të tokës për mbledhjen e vishnjave të shkollë mesme “Arbëria” GL 651 17 014 521</i>	<i>Vlerë minimale</i>
15	<i>Ndërtimi shkollës fillore në fshatin Haxhaj GL 651 17 015 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
16	<i>Shitja e Lopëve dhe e viçave - ANKAND PUBLIK GL 651 17 01</i>	
17	<i>Blerja e shërbimeve administrative dhe profesionale për nevoja të Komunës së Gjilanit GL 651 17 017 121</i>	<i>ANULIM</i>
18	<i>Furnizim me pesticide dhe repromateriale tjera për nevoja të sh,m.r Arbëri GL 651 17 018 236</i>	<i>Kontraktuar- kuotim i çmimit</i>
19	<i>Punimi i modelit të figurës së “Idriz Seferit” GL 651 17 019 411</i>	<i>Kontraktuar</i>
21	<i>Furnizim me material për zyre GL 651 17 021 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
22	<i>Furnizim me material riparues teknik GL 651 17 022 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
23	<i>Rregullimi i hapësirës së lirë të objekti i Sahat Kullës GL 651 17 023 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
24	<i>Hartimi i planit zhvillimor Komunal-Gjilan GL 651 17 024 411</i>	<i>Vlerësim- OSHP</i>
25	<i>Punimi i busteve - “Reshat Ymeri, Halim Orana, Hesat Berisha, Xhavit Ahmeti” GL 651 17 025 411</i>	<i>Kontraktuar</i>
26	<i>Rregullimi i varrezave të martirëve në fshatin Llashticë GL 651 17 026 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
27	<i>Furnizim me parafango (shofer-shajmë)për automjete GL 651 17 027 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
28	<i>Furnizim me bataniye, çarçaf dhe këllëf për jastëk GL 651 17 028 236</i>	<i>Kontraktuar-kuotim i çmimit</i>
29	<i>Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra në Komunën e Gjilanit GL 651 17 029 521</i>	<i>OSHP</i>
30	<i>Rregullimi i sheshit mbi Lumin Mirusha GL 651 17 030 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
31	<i>ANKAND PUBLIK GL 651 17 002</i>	<i>OSHP</i>
32	<i>Furnizim me sistem të ujitjes pikë- pikë për programin e Vishnjeve GL 651 17 032 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
33	<i>Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve të TI GL 651 17 033 121</i>	<i>ANULIM</i>
34	<i>Rregullimi i rrugëve në lagjen e Zabelit GL 651 17 034 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
35	<i>Digjitalizimi i arkives së Administratës Komuna në Gjilan GL 651 17 035 221</i>	<i>Kontraktuar</i>
36	<i>Furnizim me centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit GL 651 17 036 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
37	<i>Ndërtimi i trotuarit në lagjen Dardania GL 651 17 037 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
38	<i>Furnizim me rrjet kabllovik, pajisje, instalim dhe mirëmbajtje e</i>	

	<i>pajisjeve GL 651 17 038 236</i>	
39	<i>Rekonstruimi i stadiumit të Qytetit GL 651 17 039 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
40	<i>Furnizim me libra për nevoja të Bibliotekës të Komunës së Gjilanit GL 651 17 040 236</i>	<i>Kontraktuar</i>
42	<i>Furnizim me vajra për Mirëmbajtjen e automjeteve për NJPZSH GL 651 17042 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
43.	<i>Furnizim me kabinete të Kimisë dhe Biologjisë për Gjimnazin natyror dhe të mjekësisë GL 651 17 043 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
44.	<i>Rregullimi i rrugëve ne lagjen Fehmi AGANI GL 651 17 044 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
45.	<i>Furnizim me tablete për nevoja te sektorit të tatimit në pronë GL 651 17 045 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
46.	<i>Furnizim me dru për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës GL 651 17 046 111</i>	<i>Kontraktuar</i>
47	<i>Zhvendosja e kaldajës në shkollën Rexhep Elmazi GL 651 17 047 247</i>	<i>Vlerë minimale</i>
48	<i>Mirëmbajtja e ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Gjilanit GL 651 17 048 221</i>	<i>Kontraktuar</i>
49	<i>Asfaltimi i disa rrugëve në qytetin e Gjilanit GL 651 17049 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
50	<i>Ndërtimi i shtëpisë së familjes Ramadani GL 651 17 050 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
51	<i>Furnizim me farë gruri për nevoja të fermerëve të Komunës se Gjilanit GL 651 17 051 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
52	<i>Furnizim me uniforma veshmbathje për nevoja te QKMF GL 651 17 052 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
53	<i>Furnizim me serra për nevoja të fermerëve GL 651 17 053 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
54	<i>Furnizim me inventar për çerdhen në lagjen Arbëria GL 651 17 054 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
55	<i>Asfaltim i rrugëve në fshatrat e komunës se Gjilanit ndarja LOTO GL 651 17 055 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
56	<i>Mirëmbajtja dimërore e rrugëve GL 651 17 056 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
57	<i>Furnizim me naftë për ngrohje GL 651 17 057 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
58	<i>Sigurimi i automjeteve në Komunën e Gjilanit GL 651 17 058 121</i>	
59	<i>Furnizim me mekanizëm përcjellës për Bujqësi GL 651 17 059 121</i>	
60	<i>Furnizim dhe montimi i nxehjes qendrore në sh.f. Esat Berisha ”në Llashticë GL 651 17 060 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
61	<i>Furnizim me inventar për të gjitha njësit kërkuese në Komunës GL 651 17 061 121</i>	
62	<i>Furnizim me tonerë GL 651 17 062 121</i>	<i>Anuluar</i>
63	<i>Furnizim dhe montimi i nxehjes qendrore në sallën e edukatës</i>	

	<i>Fizike ne sh.f. Musa Zajmi GL 651 17 063 121</i>	
64	<i>Furnizim me material higjieniko – sanitar GL 651 17 064 121</i>	<i>Kontraktuar</i>
65	<i>Shtrimi i rrugëve të arave me zhavorr GL 651 17 066 521</i>	<i>Kontraktuar</i>
66	<i>Furnizim me skener(Detektor) dhe pajisje tjera për sallën e Kuvendit –GL 651 17 067 147</i>	<i>Kontraktuar</i>
67	<i>Furnizim me një stufë për (kaldajë për nxemje ne QKMF) Dheu i bardh-GL 651 17 068 147</i>	<i>Vlere minimale</i>
68	<i>Furnizim me një ftohës motori për automjetin e zjarrfikëseve BMC dhe automjetin kryesor te frenave (ajrit) GL 651 17 069 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
69	<i>Furnizim me shirita traka për glykometer (Diavue) – GL 651 17 070 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
70	<i>Furnizim me një pompa uji për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –GL 651 071 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
71	<i>Renovimi i sallës së shtëpisë së kulturës në fsh Llashticë GL 651 17 072 521</i>	
72	<i>Renovimi i sallës së shtëpisë së kulturës në fsh Zheger GL 651 17 073 521</i>	
73	<i>Furnizim me një projektor për nevoja të Prokurimit GL 651 17 074 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
74	<i>Organizimi i manifestimeve për festat e fund vitit GL 651 17 075 236</i>	<i>Kuotim i çmimit</i>
75	<i>Furnizim me një printer(skener dhe fotokopje) dhe dy Lloptopë GL 651 17 076 147</i>	<i>Vlerë minimale</i>
76	<i>Furnizim me foli plastike (najlon) për dy serra në sh.f. Arbëria” GL 651 17 078 147</i>	
77	<i>Furnizim me derivate për vetura dhe gjenerator GL 651 17 079 136</i>	<i>Kuotim i çmimit</i>

3.1 Menaxhimi i kontratave

Bazuar në Udhëzuesin Operativ, Departamenti i Prokurimit ka menaxhuar të gjitha kontratat e nënshkruara në këtë periudhë vjetore, gjithashtu dhe kontratat e nënshkruara për projektet e filluara gjatë vitit 2016 e që janë realizuar në këtë vit.

Në fillim të sezonës pranverore kemi bërë inspektimin e projekteve në realizim për të cilat janë dhënë vlerësime dhe vërejtje lidhur me zhvillimin e punimeve në terren dhe kemi bërë kërkesë me shkrim te të gjithë operatorët për fillimin e punimeve për të gjitha projektet e mbetura nga vitet paraprake.

Është bërë edhe menaxhimi financiar i projekteve të realizuara në bashkëfinancim me Ministrin e Infrastrukturës dhe Ministrin e Pushtetit Lokal duke përgatitur raportet mbi gjendjen dhe rrjedhjen e projekteve(anën Financiare dhe anën ekzekutive të projekteve).

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer aktivitetet e prokurimit dhe janë duke u investuar në qytet dhe gati të gjitha fshatrat e Komunës së Gjilanit në infrastrukturën rrugore ujësjellës, kanalizim si ne Bresalc, Cërrnicë, Dobërzan, Muhaxhirët e Dobërzanit, Përlepnice, Shilovë, Trotuari Arbëri – Velekincë, Capar, Malishevë e Epërme, Malisheva e Ulët, Pogragjë, Lagja Arbëri, Lagja e Vishnjeve, Përlepnice, Velekincë, Llashticë, Livoq i Ulët, Kmetocë, Lladovë, Zhegër, Pidiç, Selishtë, Çelik dhe disa rrugë të qytetit.

Vlen të ceket projekti me PPP Campusi i shkollave të mesme një projekt kapital ku është kryer faza e parë e investimeve priten të realizohen edhe dy fazat tjera, po ashtu Projekti QMF vlera e projektit 1.195.438.67€ Ndërtimi i Palestrës sportive po ashtu edhe ky projekt kap vlerën mbi 1.108.857,74 € Si dhe ndërtimi i stadiumit të qytetit 3.121.346.07.

Asfaltimi i disa rrugëve në qytetin e Gjilanit që pritet të fillojnë punët në vitin 2018, asfaltimi i rrugëve në fshatrat e komunës së Gjilanit ndarja në lote.

Për herë të parë këtë vit në Komunën e Gjilanit Investimet kapitale tejkalojnë vlerat e buxhetit të përgjithshëm dhe lirishte munde të thuhet se ky është viti i investime me të mëdha për Gjilanin. Ne si Departamenti i Prokurimit me te gjitha vështirësitë që kemi në realizim e këtyre projekteve po vazhdojmë me aktivitetet e filluara gjatë këtij viti dhe priten të realizohen edhe gjatë vitit 2018 për projektet të cilat janë lidhur kontratat në fund të vitit 2017.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Në këtë raport janë përfshirë këto sfera:

- Procesi i Riatdhesimit
- Procesi i kthimit të qëndrueshëm dhe
- Çështjet e komuniteteve

Duhet theksuar se për periudhën raportuese, evidenca me të cilën disponon zyra, janë evidentuar 198 lëndë ose kërkesa:

- Procesi i Riatdhesimit -----	70	
- Kthimi i qëndrueshëm -----	9	
- Çështje të komuniteteve -----	28	
- Lëndë të tjera të arkivuara -----	91	(si pushime vjetore, pushime mjekësore, furnizime me material për Zyre etj)

➤ Kthimi i Qëndrueshëm:

- Për çështje të kthimit të Qëndrueshëm, duhet theksuar që projekti EU-RRK-IV -IOM, i cili ka filluar me realizimin e tij nga fillimi i vitit 2015 dhe ka përfunduar zyrtarisht në mes të vitit 2017, për periudhën e realizimit të këtij projekti janë përpunuar 143 kërkesa kurse janë realizuar 22 kërkesa.
- Për çështje të kthimit të Qëndrueshëm , sipas evidencës së ZKKK janë evidentuar 9 (nëntë) kërkesa. Kërkesat janë evidentuar në bazën e të dhënave dhe janë shqyrtuar për aktivitetin e mëtejshëm.
- Përveç të dhënave të mëparshme për qëndrueshmërinë e kthimit, puna e zyrave bazohet në koordinimin e përbashkët dhe në bashkëpunimin me akterët kryesorë në këtë drejtim, si Ministria për Komunitete dhe Kthim si dhe UNHCR. Me bashkëpunim dhe angazhim të përbashkët kemi pasur këto aktivitete:
- Shtatë (7) familje të kthyer (komunitetit Rom) me mbështetjen e UNHCR-së përmes projektit ERP.
- Komisionit qendror të i MKK ju është propozuar nga ZKKK lista me 38 (tridhjetë e tetë) përfitues potencial (familjarë) për ofrimin e mbështetjes në kthim. Me vendim të komisionit janë identifikuar dhe miratuar gjashtë (6) familje, (3 rome dhe 3 serbë) si prioritet në ofrimin e përkrahjes së kthimit.
- Janë ndihmuar me pako ushqimore, orendi dhe higjienë (11) familje, nga të cilat shtatë (7) rome dhe katër (4) familje serbe..
- Nëntë (9) raste lidhur me çështjen e statusit civil (dokument personal) janë identifikuar dhe përkrahur nga organizata CRP / K.
- Pesë (5) raste lidhur me dokumentacionin e pronës janë identifikuar nga zyrtarët e ZKKK-se dhe akterve tjerë me punë të përbashkët me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi janë ndihmuar të gjitha rastet-5.
- Një vizitë (1) “Shko-shiko “është realizuar, kjo vizitë është realizuar në mbështetje nga DRC (Këshilli danez për refugjatë). Pjesë e vizitës kanë qenë 8 familje rome të cilat edhe ma tutje janë të zhvendosura. Gjatë vizitës, familjet kanë vizituar pronën e tyre dhe të afërmit e tyre. Ditën e dytë është mbajtur një takim në hapësirat e komunës në të cilat ishin të pranishëm të gjitha 8 familjet e komunitit Rom si i dhe aktorët kyç në këtë proces si MKK, IOM, UNHCR-AT, kryesuesi i komitetit për komunitete dhe Policia e Kosovës.
- Gjatë kësaj periudhe, ne kemi pasur më shumë vizita në terren (monitorim) me përfaqësuesit e UNHCR-AT. Monitorimi ka të bëjë për familjet që janë regjistruar dhe ndihmuar në vitet e fundit.
- Përveç këtyre aktiviteteve në zyre, në e udhëheqim data bazën e të dhënave për familjet e kthyer. Të dhënat nga data baza çdo ditë korrigjohen.

- Në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNHCR-AT, si dhe me përfaqësuesit e Ministrisë, kemi mbajtur dy punëtori rajonale në të cilat Komuna e Gjilanit ka qenë organizator dhe këto punëtori po ashtu janë mbajtur në Gjilan. Me temë "shkëmbimi i informatave dhe përvojave në punë".

➤ **Procesi i Riatdhesimit (persona të kthyer nga vendet e treta)**

- Për menaxhimin e programeve, procedurat dhe kriteret e përdorura, si dhe integrimin e personave të riatdhesuar është zbatuar Rregullorja (8/2015 dhe 04/2016) kurse nga muaji shtator është në fuqi rregullorja **13/2017** dhe Vendimi i Kryetarit për formimin e komisionit për personat e riatdhesuar. ZKKK ka kryer këto aktivitete në periudhën raportuese:
- Periudha prej 01.01.2017 deri më 31.12.2017 sipas evidencës së MPB-së dhe data Baza e të dhënave me të cilën disponojmë janë riatdhesuar sipas sistemi të ri integritit nëntëdhjetë e nëntë (99) familje ose individë.
- Sipas evidencës së ZKKK-së evidentohen shtatëdhjetë (70) kërkesa të të riatdhesuarve
- Përveç kësaj, në zyrën e ZKKK-së personalisht janë trajtuar (93) përfitues potencialë, për çështje të ndryshme dhe kërkesa (informacion mbi procesin e riatdhesimit, plotësimin e dokumenteve, evidentimin në sistemin elektronik, etj).
- Komisioni komunal për ri integrim ka mbajtur shtatë (7) takime për shqyrtimin e nëntë (9) kërkesave:
- Vazhdim i akomodimit për gjashtë muaj janë aprovuar katër (4) kërkesa
- Kërkesa për akomodim për 12 muaj janë aprovuar dy (2) kërkesa
- Kërkesë për orendi një- dhe është refuzuar .
- Kërkesa për lëndë djegëse 2 dhe janë aprovuar.
- Zyrtarët e ZKKK-së janë në kontakt të përditshëm me koordinatorin rajonal të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me procesin e riatdhesimit.
- Për periudhën e caktuar me koordinimin rajonal, ne kemi pasur nëntë vizita ne terren për 27 përfitues potencial sipas kërkesave.
- Duhet theksuar se 25 lëndë të kompletuara për plan biznesi i kemi dërguar në komisionin qendror për ri integrim (KQR) në MPB. Lëndët pas disa muajve janë kthyer në zyrën tonë nga koordinatori rajonal për ri integrim të pa shqyrtuara, për shkak të ndryshimit të rregullores për të riatdhesuar dhe ndryshimit të kompetencave dhe të njëjtat do t'i barten zyrës së punësimit. Përveç të asaj që e thamë më lartë në arkivin tonë të ZKKK-së kemi edhe 9 lëndë të kompletuara dhe të pashqyrtuara, arsyet janë po ashtu ndryshimi i rregullores në fjalë dhe kalimi i përgjegjësi

Ministrive dhe drejtorive tjera. Sipas rregullores së re të njëjtit duhet aplikuar përmes Zyrës për Punësim bazuar në shpalljet publike që do të pasojnë nga kjo Zyre.

- Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur (3) seminare dhe dy (2) trajnime apo punëtori për këtë fushë në drejtim të zbatimit të rregullores 13/2017 për ri integrimin e personave të riatdhesuar.
- Një nga më të rëndësishmet seminare dhe punëtori është njohja me rregulloren e re (13/2017) për të persona apo familje të riatdhesuar ku organizator ishte (MPB dhe OSBE).

➤ **Çështje të komuniteteve**

- Për Çështje të komunitetit janë evidentuar njëzet e tetë (28) kërkesa nga ana e qytetarëve me nevoja të ndryshme (ndihmë në ndërtimin e materialit për raste sociale, konfirmimi i përkatësisë kombëtare).

Pjesëmarrja në seminare dhe punëtori

-USAID projekti "ta avancojmë" Kosovën bashkërisht", në temën "Mbështetja e gruas nga komunitetet jo shumicë që të avancojnë karrierën në sektorin publik në nivel lokal" në organizim të Demokracisë Plus.

- Tema e OSBE-së: E drejta dhe punësimi i komuniteteve jo shumicë në institucionet shtetërore .

- Tema e OSBE-së: Statusi dhe qasja e barabartë e komunitetit RAE në shoqërinë kosovare

- OSBE tema: Respekti dhe ofrimi i përfaqësuesve fetar

- Tema e OSBE-së: Përfaqësimi i komuniteteve në sektorin publik të Kosovës.

- TERE DE HOMMES Tema: forcimi i rrjeteve për mbrojtje të fëmijëve

- MPL dhe GIZ tema: E drejta për shërbime sociale

- INPO tema: Promovimi dhe forcimi i shërbimit social në komunë.

-Personeli i ZKKK-së ka marr pjesë në katër takime të Komitetit për Siguri në Bashkësi

Po ashtu ka marrë pjesë në gjashtë takime në komitetin për komunitete.

Përveç këtyre veprimeve, ne kemi marrë pjesë në mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve në Shën Nikollë të Gjilanit, si dhe në punët e rreth rregullimit të varrezave (ortodoksëve dhe myslimanëve) në Gjilan.

Me përfaqësuesin e IOM-it kemi vizituar klientët që në vitet e mëparshme kanë marrë projekte për të fituar biznesin familjar dhe qëndrueshmërinë në komunitet, Projektet janë financuar nga IOM-i.

Për sa i përket situatës së sigurisë për komunitetet jo shumicë në komunën e Gjilanit, për periudhën Janar –Dhjetor 2017, duke marrë parasysh raportet e policisë si dhe gjendjen faktike në terren, mund të themi lirshëm se gjendja e sigurisë është e kënaqshme në Gjilan dhe fshatrat për rreth.

ZYRA PËR PRESHEVË, MEDVEGJË DHE BUJANOC

Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjilanit, në bazë të kompetencave të saj po mundohet intenzivisht të jap kontributin më të madh për të u dal në ndihmë të gjithë qytetarëve të cilët janë dëbuar nga Lugina e Preshevës pas luftës së vitit 1999 për në Kosovë, qytetarë këta të cilët edhe pse mbi 18 vite qëndrimi në Republikën e Kosovës, akoma nuk gëzojnë asnjë atribut të qytetarit në këtë shtet.

Problemet që më së shumti zyra ka marr për bazë kanë të bëjnë: pajisja me dokumentacion të Republikës së Kosovës, refuzimi i shtetësisë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, e pastaj gjitha problemet e tjera që dalin nga këto probleme bazë siç janë: shkollimi, punësimi, pensionimi etj.

Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë do të mundohet të jep alternativën më të mirë për zgjidhjen e këtyre problemeve në kohën sa më të shpejt të mundshme.

Brenda kompetencave, Zyra brenda këtij 6 muaji (korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor), si dhe deri në fund të vitit ka kryer dhe do të mundohet të kryej këto veprimtari të cilat lidhen ekskluzivisht me të drejtat e qytetarëve të cilën janë dëbuar, shpërngulur nga Bujanoci, Presheva dhe Medvegja, pas luftës së vitit 1999 e 2001 e të cilët jetojnë në Gjilan e më gjerë.

Gjatë këtij muaji zyrën e kanë vizituar personalitete të njohura me ndikim të cilët i kanë dhënë përkrahje të plotë zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në arritjen e qëllimeve të saj drejtë zgjidhjes sa më të shpejtë të problemeve të qytetarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes.

Rrjedha e takimeve dhe vizitave nga zyrtari i Zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë:

I ftuar nga Kryetari i Komunës së Bujanocit, z. Shaip Kamberi.

Konkludimi nga ky takim:

Me kryetarin Kamberi u dakorduar që të kemi një investim në mbjelljen e vishnjeve në malësinë e Bujanocit me ndihmën e Usaid-t në bashkëpunim me drejtorin e Bujqësisë Ramiz Ramadani dhe

kryesuesin e KBNK Kushtrim Kadriu implementuar nga “Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Ky projekt nuk u implementua shkak i ndryshimit të qëndrimit të USAID-it.

Takim në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Prishtinë - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, zyra për të huaj, takim me koordinatorin e kësaj zyre z.Besim Jonuzaj.

Nga ky takim mund të nxjerr këto konkluzione:

1. Bashkëpunim i ngushtë zyra e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion;
2. Sjellja korrekte me qytetarët potencial me rastin e aplikimit në DSHAM;
3. Koordinim i punëve administrative ZPBM dhe DSHAM.

Të gjitha këto për ndihmë të qytetarëve, me qëllim të lehtësimit të punëve dhe udhëzimit sa më të drejtë të tyre drejt organeve kompetente.

STATISTIKAT E QYTETARËVE TË CILËT JANË REGJISTRUR NË ZPBM

Gjatë muajit korrik si qytetarë të cilët kanë pas nevojë për udhëzim dhe adresim në destinacionin kompetent e të cilët janë udhëzuar nga ZPBM, zyra ka regjistruar 18 qytetarë.

(10) qytetarë janë udhëzuar në ndjekje të procedurës për fitim të shtetësisë së Republikën e Kosovës, pasi që të tre (3) kanë plotësuar kushtet ligjore për fitim të shtetësisë. Pesë (5) qytetarët të tjerë të regjistruar në zyre janë udhëzuar për plotësim të dokumentacionit me qëllim të marrjes së lejes së përkohshme në Kosovë (për arsye të bashkimit familjar me shtetas të Republikës së Kosovës, punësim, arsimim, OJQ-ve etj).

Vizitë bizneseve të Luginës të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës-Komunën e Gjilanit. Vizita u bë në ndërmarrjen “Gzimi Komerc” në Gjilan

Nga vizita u pa që në këtë ndërmarrje më tepër se 90 % e punëtorëve janë nga Lugina e Preshevës, kryesisht Malësisë së Bujanocit. Zyra u ofroi mbështetje ndërmarrjes në fjalë pasi që shtimi i numrit të punëtorëve të rregullt në këtë ndërmarrje ulë edhe koston e problemeve të qytetarëve me prejardhje nga Kosova Lindore.

Kam zhvilluar vizitë zyrtare në Bujanoc ku jam takuar me deputetin në Parlamentin e Serbisë z.Fatmir Hasani.

STATISTIKAT E QYTETARËVE TË CILËT JANË REGJISTRUR NË ZPBM

Gjatë muajit shkurt në Zyrën për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për regjistrim dhe udhëzim kanë ardhur 30 persona.

Nga këta 30 persona, 10 nga ta janë udhëzuar për rregullim të dokumenteve për marrjen e leje qëndrimit të përkohshëm të Republikës së Kosovës, ndërsa 5 nga ta janë udhëzuar për rregullim të dokumenteve për Shtetësi të Republikës së Kosovës dhe 15 persona të tjerë janë udhëzuar që pas rregullimit të dokumenteve të prindërve të tyre ata të aplikojnë për kategorinë përkatëse. Numri i qytetarëve të ardhur në ZPBM

Takime të shumta me ministrin e punëve të brendshme z.Flamur Sefajn, ku kemi dorëzuar dhe listën e qytetarëve të evidentuar që nuk kanë shtetësi të Kosovës që janë evidentuar në Gjilan.

Gjithashtu kam marrë pjesë aktive në formulimin e propozimit për ndryshimin e ligjit për shtetësi.

Zyrën për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë e kanë vizituar 37 qytetarë që kanë probleme me dokumente identifikimi.

Zyrën e kanë vizituar 41 persona të cilët janë ankuar se ju është pasivizuar shtetësia në Serbi.

Takim me përfaqësuesit e fshatit Priboc, Ramanabučë, Suharrën, Qarr, Novosellë.

Arsyeja e takimit është implementimi i projektit të rregullimit të 39 km rrugë që lidhë “Malësinë e Bujanocit”.

Ku gjatë këtyre takimeve kam afruar urën e komunikimit në mes të përfaqësuesve të fshatrave dhe Komunës së Bujanocit, ku këta banorë janë të dëbuar dhe jetojnë në Gjilan.

Në këtë takim kemi hasur në mirëkuptim nga qytetarët dhe mbështetje morale ofruar ZPMB-së nga qytetarët.

Nga e gjithë kjo del ky konkluzion i punës gjashtë (6) mujore të Zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë :

Nga të gjithë personat të cilët janë udhëzuar nga Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë pas aplikimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës në Departamentin përkatës (Shtetësi, Azil dhe Migracion), pas respektimit të afatit ligjor kanë arritur të pajisen me leje qëndrim të përkohshëm një numër i jo i madh i këtyre personave.

Ju faleminderit